

MINISTERO DEL LAVORO
E DELLE POLITICHE SOCIALI

Direzione Generale dell'Immigrazione
e delle Politiche di Integrazione

Imigracioni
Si, ku, kur

Udhëzues për integrim

1 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS ITALIANE (ART. 1-54)..... 4

2 HYRJA..... 15

2.1 Kufiri..... 15
2.2 Vizat..... 15

3 QËNDRIMI NË ITALI..... 25

3.1 Lejeqëndrimet..... 25
3.2 Marrëveshja për integrim..... 31
3.3 Lejeqëndrimi BE për residentët afatgjatë..... 34
3.4 Zona Schengen..... 39

4 PUNA..... 40

4.1 Puna në Itali..... 40
4.1.1 Puna e vartur..... 40
4.1.2 Puna pjesërisht e vartur..... 47
4.1.3 Puna e pavartur..... 48
4.1.4 Kushtet për pranimin në punë të minorenëve..... 49
4.2 Hyrja në tregun e punës në Itali..... 52
4.3 Themelimi dhe ndërprerja e mardhënies së punës..... 61
4.4 Shërbimet për punësim..... 64

5 GJENDJA CIVILE..... 66

5.1 Kërkesa për regjistrim..... 68
5.2 Shërbimet e gjendjes civile..... 70

6 STREHIMI..... 73

6.1 Banesë me qera..... 74
6.2 Blerja e banesës..... 75
6.3 Qëndrat e pritjes..... 76

7 SHËNDETSIA..... 778

7.1 Regjistrimi në Shërbimin Shëndetsor Kombëtar (SSN)..... 78
7.2 Libreza shëndetsore..... 80
7.3 Shërbimet shëndetsore..... 80
7.4 I huaji përkohesisht në territorin italian (STP)..... 85

8 ARSIMI..... 86

8.1 Çerdhja..... 86
8.2 Kopshti..... 86
8.3 Cikli i parë..... 87
8.4 Cikli i dytë..... 88
8.5 Universiteti..... 889
8.6 Shkollimi dhe formimi teknik i lartë..... 91
8.7 Njohja e titujve të studimeve..... 91
8.8 Njohja e titujve profesionalë..... 92

9 MBROJTJA E TË DREJTAVE DHE DISKRIMINIMI..... 93

9.1 Mbrojtja e të drejtave..... 93
9.2 Diskriminimi..... 94

10 BANKA.....95

11 SHOQATAT 97

11.1 Themelimi i një shoqate……..97
11.2 Forma të ndryshme shoqatash……....99
11.3 Rregistri i shoqatave dhe i enteve që veprojne në favor të emigrantëve……...100

Version i azhiornuar në Janar 2014

1 KUSHTETUTA E REPUBLIKËS ITALIANE (Neni 1- 54)

KRYETARI I PËRKOHSHËM I SHTETIT

Duke konsideruar vendimin e Asemblesë Kushtetuese që në mbledhjen e 22 dhjetorit 1947 aprovoi Kushtetuten e Republikes Italiane;
Duke konsideruar vendimim e XVIII përfundimtar të Kushtetutes;

FIRMOS

Kushtetutën e Republikës Italiane me tekstin e mëposhtëm:

PARIMET THEMELORE

Neni 1.

Italia është Republikë demokratike e bazuar në punën.
Sovraniteti i takon popullit, që e ushtron në formën dhe brenda kufijve të Kushtetutës.

Neni 2.

Republika njeh dhe garanton të drejtat e padhunueshme të njeriut, qoftë si individ, qoftë në grupime sociale ku zhvillohet personaliteti i tij dhe kërkon përmbushjen e detyrave të domosdoshme të solidaritetit politik, ekonomik dhe social.

Neni 3.

Të gjithë qytetarët kanë të njëjtin dinjitet social dhe janë të barabartë para ligjit, pa dallim race, gjuhe, feje, opinioni publik, të kushteve personale e sociale. Është detyrë e Republikës të shmangë pengesat e tipit ekonomik dhe social, që,duke kufizuar në fakt lirinë dhe barazinë e qytetarëve, pengojnë zhvillimin e plotë të njeriut dhe pjesmarrjen efektive të të gjithë punonjësve në organizimet politike, ekonomike e sociale të vendit.

Neni 4.

Republika i njeh të gjithë qytetarëve të drejtën për punë dhe krijon kushtet që bëjnë efektive këtë të drejtë. Çdo qytetar ka detyrë të kryejë, sipas mundësive dhe zgjedhjes personale, një aktivitet ose një funksion që ndihmon në progresin material ose shpirtëror të shoqërisë.

Neni 5.

Republika, është një dhe e pandashme, njeh dhe inkurajon autonomitë lokale; zbaton në shërbimet që varen nga Shteti, decentralizimin më të gjërë ekonomik; ia përshtat parimet dhe metodat e legjislacionit të tij, kërkesave të autonomisë dhe të decentralizimit.

Neni 6.

Republika tutelon me norma të veçanta pakicat gjuhësore.

Neni 7.

Shteti dhe Kisha katolike, secili në urdhërin e vet, janë të pavartur dhe sovranë. Raportet midis tyre rregullohen nga Paktet Lateranense. Modifikimet e Pakteve, të pranuara nga të dyja palët, nuk kërkojnë një proçedurë të rishikimit të Kushtetutës.

Neni 8.

Të gjithë besimet fetare janë njëlloj të lira para ligjit.

Besimet fetare, të ndryshme nga ajo katolike, kanë të drejtë të organizohen sipas statuteve të tyre, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me Sistemin juridik italian.

Raportet e tyre me shtetin janë të vendosura me ligj në bazë të marrëveshjeve të bëra me përfaqësitë përkatëse.

Neni 9.

Republika inkurajon zhvillimin e kulturës dhe të punës kërkimore shkencore e teknike. Tutelon ambjentin dhe pasurinë historike e artistike të Kombit.

Neni 10.

Sistemi juridik italian i përmbahet normave të së drejtës ndërkombëtare të aprovuara në linja të përgjithshme.

Pozita juridike e të huajve është vendosur nga ligji, në përputhje me normat dhe traktatet internacionale.

I huaji, të cilit i është ndaluar të ushtrojë në vëndin e tij liritë demokratike të garantuara nga Kushtetuta italiane, ka të drejtën e azilit në territorin e Republikës, sipas kushteve të përcaktuara nga ligji.

Nuk lejohet ekstradimi i të huajve për krime politike.

Neni 11.

Italia mohon luftën si një instrument të fyerjes së ushtrimit të lirisë të popujve të tjerë dhe si mjet të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve internazionale; lejon, në kushte barazie me Shtetet e tjera, duke ju përmbajtur kufizimeve të sovranitetit të nevojshme për një sistem që siguron paqen dhe drejtësinë midis Kombeve; inkurajon dhe favorizon organizatat ndërkombëtare që kanë këtë qëllim.

Neni. 12

Flamuri i Republikës është trengjyrëshi italian: jeshil, i bardhë dhe i kuq, me tre rripa vertikalë me përmasa të barabarta.

PJESA E PARE

TË DREJTAT DHE DETYRAT E QYTETARËVE

TITULLI I

M A R DH E N I E T C I V I L E

Neni 13.

Liria personale është e padhunueshme.

Nuk është e lejueshme asnjë formë e burgimit, e inspektimit apo e kontrollit personal, dhe asnjë formë e kufizimit të lirisë personale, me përjashtim të akteve të motivuara nga autoritetet gjygjësore dhe vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji.

Në raste të veçanta të nevojës dhe të urgjencës, të parashikuara në mënyrë rigorose nga ligji, autoriteti i sigurimit publik mund të aprovojë vendime të përkohëshme,që duhet t'i komunikohen brënda dyzet e tetë orëve autorite- teve gjygjësore dhe, në qoftë se ky nuk i miraton brënda 48 orëve në vazhdim, konsiderohen të anulluara dhe mbesin pa asnjë efekt.

Ndëshkohet çdo dhunë fizike e morale mbi personat që i nënshtrohenheqjes së lirisë. Ligji përcakton kufijtë maksimalë të burgimit paraprak.

Neni 14.

Banesa është e padhunueshme.

Nuk mund të kryhen inspektime, kontrolle apo sekuestrime, me përjashtim të rasteve dhe të mënyrave të parashikuara për tutelën dhe lirinë personale.

Kontrollet dhe inspektimet për motive shëndetësore dhë të sigurisë shoqërore ose me qëllime ekonomike dhe fiskale, janë të drejtuara nga ligje speciale.

Neni 15.

Liria dhe fshehtësia e letërkëmbimeve dhe e çdo forme tjetër të komunikimit janë të padhunueshme.

Kufizimi i tyre mund të ndodhë vetëm nëpërmjet një akti te motivuar te autoriteteve gjyqesore me garancite e percaktuara ligji.

Neni 16.

Çdo qytetar mund të qarkullojë dhe të banojë lirisht në çdo pjesë të territorit kombëtar, me përjashtim të kufizimeve që ligji përcakton në vija të përgjithshme për motive shëndetësore ose të sigurisë.

Asnjë kufizim nuk mund të përcaktohet nga arësye politike.

Çdo qytetar është i lirë të dalë nga territori i Republikës dhë të rihyjë, në përputhje me detyrimet e ligjit.

Neni 17.

Qytetarët kanë të drejtë të bashkohen në mënyrë paqësore dhe pa armë.

Për mbledhjet, edhe në vende te hapura publike, nuk kërkohet paralajmërim.

Përmbledhjet në vende publike duhet të paralajmërohen autoritetet, që mund t'i ndalojnë vetëm për motive të justifikuara të sigurisë shoqërore.

Neni 18.

Qytetarët kanë të drejtë të organizohen lirisht, pa autorizim, për qëllime që nuk u ndalohen personave nga ligji penal.

Janë të ndaluara shoqatat sekrete dhe ato që ndjekin, edhe indirekt, qëllime politike nëpërmjet organizimeve të karakterit ushtarak.

Neni 19.

Të gjithë kanë të drejtë të shpallin lirisht besimin e vet fetar në çdo formë,personale apo të organizuar, të bëjnë propagandë dhe të ushtrojnë privatisht apo në publik besimin, me kusht që të mos jenë rite në kundërshtim me moralin qytetar.

Neni 20.

Karakteri ekleziastik dhe qëllimi fetar apo besimtar i një shoqate apo instiucioni, nuk mund të jenë shkaku i kufizimeve speciale ligjësore, dhe as i tatimeve speciale fiskale për kostituimin e tij, kapacitetin juridik dhe për çdo formë aktiviteti.

Neni 21.

Të gjithë kanë të drejtë të shprehin lirisht mendimin personal me fjalë, me shkrim apo me çdo mjet tjetër të komunikimit.

Shtypi nuk mund të jetë objekt i autorizimeve apo i çensurimeve.

Mund të ndërmerret sekuestrimi vetëm për aktet e motivuara nga autoritetet gjygjësore në raste krimesh, përtë cilët ligji mbi shtypin shprehet në mënyrë të veçantë, ose në raste të shkeljes së normave për të cilat vetë ligji parashikonte identifikimin e përgjegjësve.

Në këto raste, kur ekziston urgjenza absolute dhe nuk është e mundur dërhyrja e shpejtë e autoritetit gjygjësor, sekuestrimi i shtypit periodik mundtë kryhet nga oficerë të policisë gjygjësore, që duhet menjëherë, dhe asnjëhere pas 24 orësh, të denoncojnë autoritetet gjygjësore. N.q.s. kjo nuk e miraton në 24 orët në vazhdim, sekuestrimi konsiderohet i shfuqizuar dhe pa asnjë efekt.

Ligji mund të përcaktojë, me norma të karakterit të përgjithshëm, që të bëhen të ditur të gjitha mjetet e financimit të shtypit periodik.

Janë të ndaluara publikimet në shtyp, shfaqjet dhe të gjitha manifestimet të tjera në kundërshtim me moralin. Ligji përcakton vendime të përshtatshme për të parashikuar dhe shtypur shkeljet.

Neni 22.

Askujt nuk mund t'i mohohet për motive politike, të aftësisë juridike apo të shtetësisë, emri.

Neni 23.

Asnjë veprim personal apo mbi pasurinë nuk mund të imponohet, n.q.s. nuk është në përputhje me ligjin.

Neni 24.

Të gjithë mund të veprojnë me vetëdije për të tuteluar të drejtat dhe interesat e veta dhe të drejtat e ligjshme.

Mbrojtja është e drejtë e padhunueshme në çdo stad dhe gradë të proçedurave.

I sigurohen të varfërve me vendime të posaçme, mjetet për të vepruar dhe për t'u mbrojtur përpara çdo juridiksioni.

Ligji përcakton kushtet dhe mënyrat për korrigjimin e gabimeve gjygjësore.

Neni 25.

Askush nuk mund të privohet nga gjykatësi natyral i përcaktuar me ligj.

Askush nuk mund të ndëshkohet në mungesë të një ligji që ka hyrë në fuqi përpara fajit të kryer.

Askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurisë, vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 26.

Ekstradimi i qytetarëve mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht nga konventat dërkombëtare.

Nuk mundet në asnjë rast të aplikohet për faje politike.

Art. 27.

Përgjegjësia penale është personale.

I padituri nuk konsiderohet fajtor deri në dënimin përfundimtar.

Dënimet nuk mund të konsistojnë në trajtime në kundërshtim me sensin njerëzor dhe duhet të tentojnë riedukimin e të dënuarit.

Nuk është i lejuar dënimi me vdekje.

Art. 28.

Funksionarët dhe nëpunësit e shtetit dhe të enteve publike janë direkt të përgjegjshëm, sipas ligjeve penale, civile dhe administrative, të akteve të kryera në shkelje të të drejtave. Në të tilla raste, përgjegjësia civile shtrihet edhe ndaj shtetit dhe enteve publike.

TITULLI II

MARDHËNIET ETIKE-SOCIALE

Neni 29.

Republika njeh të drejtat e familjes si shoqëri e natyrshme e bazuar në martesën.

Martesa është e vendosur mbi barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, me kufij të përcaktuar nga ligji për të garantuar unitetin familiar.

Neni 30.

Është detyrë dhe e drejtë e prindërve të mbajnë, arsimojnë dhe edukojnë fëmijët, edhe n.q.s. kanë lindur jasht martesës.

Në rast të paaftësisë së prindërve, ligji parashikon që të përmbushen detyrat e tyre.

Ligji i siguron fëmijëve të lindur jasht martese çdo tutelë juridike dhe sociale, në përputhje me të drejtat e familjes së ligjshme.

Ligji dikton normat dhe kufijtë për të kërkuar atësinë.

Neni 31.

Republika lehtëson me masa ekonomike dhe me ndihma të tjera formimin e familjes dhe përmbushjen e detyrave respektive, me përparësi të veçantë familjeve me shumë pjesëtarë.

Ruan mëmësine, fëmijërinë dhe rininë, duke favorizuar institutet e nevojshme për këtë qëllim.

Neni 32.

Republika tutelon shëndetin si e drejtë themelore e individit dhe e interesit të kolektivit dhe u garanton kura falas të varfërve.

Askush nuk mund të detyrohet të kryejë një trajtim të përcaktuar shëndetësor, me përjashtim të vendimeve me ligj. Ligji nuk mundet në asnjë rast të shkelë kufizimet e imponuara të respektit të personit.

Neni 33.

Arti dhe shkenca janë të lira dhe e lirë është mësimdhëia.

Republika dikton norma të përgjithshme mbi arësimin dhe krijon shkolla shtetërore për të gjitha urdhërat dhe nivelet.

Entet private kanë të drejtë të krijojnë shkolla dhe institute arësimi, pa detyrime për shtetin.

Ligji, duke fiksuar të drejtat dhe detyrimet për shkollat jo shtetërore që kërkojnë barazi, duhet t'u sigurojë atyre liri të plotë dhe nxënësve të tyre një trajtim shkollor të barabartë me ato të nxënësve të shkollave shtetërore.

Eshtë parashikuar një provim Shteti për pranimin në urdhërat dhe nivelet e ndryshme të shkollave ose për përfundimin e tyre dhe për aftësimin për ushtrimin e profesionit.

Institucionet e kulturës së lartë, universitetet dhe akademitë, kanë të drejtë të kenë një rregullore autonome brënda kufijve të përcaktuara nga ligjet e Shtetit.

Neni 34.

Shkolla është e hapur për të gjithë.

Shkolla fillore, e përbërë nga të paktën 8 vjet, është e detyrueshme dhe falas.Të aftët dhe ata që e meritojnë, edhe pse pa mjete ekonomike, kanë të drejtë të arrijnënivelet më të larta të studimit.

Republika e bën të mundur këtë të drejtë me bursa studimi, çek familjeve dhe ndihma të tjera që duhet të jepen me konkurim.

TITULLI III

MARDHËNIET EKONOMIKE

Neni 35.

Republika tutelon punën në të gjitha format dhe aplikimet e saj.

Përkujdeset për përgatitjen dhe ngritjen profesionale të punonjësve.

Nxit dhe favorizon akordet dhe organizmat ndërkombëtare që kanë për qëllim të shpallin dhe të hartojnë të drejtat e punës. Njeh të drejtën e emigrimit, mepërjashtim të detyrimeve të përcaktuara nga ligji në interesin e përgjithshëm dhe mbron punën e italianëve jasht shtetit.

Neni 36

Punonjësi ka të drejtë për një pagesë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së tij dhe, në çdo rast, të mjaftueshme për të siguruar për vetveten dhe për familjen një ekzistencë të lirë dhe dinjitoze.

Zgjatja maksimale e ditës së punës është e përcaktuar me ligj. Punonjësi ka të drejtën e pushimit javor dhe vjetor të paguar, dhe nuk mund të heqë dorë.

Neni 37.

Gruaja punonjëse ka të njejtat të drejta dhe për punë të barabartë, të njejtën pagesë që i takojnë punonjësve. Kushtet e punës duhet të lejojnë përmbushjen e funksionit të saj kryesor në familje dhe t'i sigurojnë nënës dhe fëmijës një mbrojtje speciale të përshtatshme.

Ligji përcakton kufijtë minimale të moshës për punën e paguar.

Republika tutelon punën e të miturve me norma speciale dhe i garanton atyre, për punë të barabartë, të drejtën për pagesë të barabartë.

Neni 38.

Çdo qytetar i paaftë për punë dhe i zhveshur nga mjetet e nevojshme për të jetuar, ka të drejtë për ndihmë dhe mbështetje sociale.

Punonjësit kanë të drejtë që t'u jenë parashikuar dhe siguruar mjetet e nevojshme për nevojat e tyre të jetës në rast aksidenti, sëmundjeje, invalidateti, pleqëri e papunësi e padëshirueshme.

Të paaftët dhe të gjymtuarit kanë të drejtë për arësim dhe futje në punë. Me detyrat e parashikuara në këtë nen, merren organet dhe institutet e ngritura apo të integruara nga shteti. Asistenca private është e lirë.

Neni 39.

Organizimi sindakalist është i lirë.

Sindakatave nuk mund t'u vihen detyrime të tjera përveç regjistrimit të tyre pranë zyrave lokale ose qëndrore, sipas normave të ligjit.

Është kusht për regjistrimin që statutet e sindakatave të sanksionojnë një rregull të brëndshëm me bazë demokratike.

Sindakatat e regjistruara janë person juridik. Mundet që, po të jenë të përfaqsuar bashkërisht në proporcion me të regjistruarit e tyre, të nënshkruajnë kontrata kolektive pune me përfitim të detyrueshëm për të gjithë ata që i përkasin kategorive të cilave i referohet kontrata.

Neni. 40.

E drejta per greve ushtrohet brenda ligjeve qe e parashikojne.

Neni 41.

Iniciativa ekonomike private është e lirë.

Nuk mund të kryhet në kundërshtim me dobishmërinë sociale ose në ndonjë mënyrë që i shkakton dëme sigurisë, lirisë dhe dinjitetit njerëzor.

Ligji përcakton programet dhe kontrollet e nevojshme që aktiviteti ekonomik, publik dhe privat të mund të drejtohet dhe të koordinohet për qëllime sociale.

Neni 42.

Prona është shoqërore ose private. Të mirat ekonomike i përkasin Shtetit, enteve apo privatëve.

Prona private njihet dhe garantohet nga ligji, i cili përcakton mënyrat e blerjes, të shfrytëzimit dhe kufijtë me qëllim që të sigurojë funksionin social dhe për t'ia bërë të lejuar të gjithëve.

Prona private mundet që, në rastet e parashikuara nga ligji, dhe duke u dëmshpërblyer, të shpronësohet për motive të interesit të përgjithshëm. Ligji përcakton normat dhe kufizimet e vazhdimësisë së ligjshme dhe me testament të të drejtave të Shtetit mbi trashëgiminë.

Neni 43.

Duke mbajtur parasysh interesin e përgjithshëm, ligji mund të rezervojë në origjinë ose të trasferojë, nëpërmjet shpronësimit dhe pasi të jetë dëmshpërblyer, Shtetit, enteve publike ose komuniteteve të punonjësve ose të konsumatorëve, sipërmarrje të përcaktuara ose kategori ndërmarrjesh, që i referohen shërbimeve publike thelbësore ose burimeve të energjisë ose situatave të monopolit dhe që kanë karakter të spikatur për interesin e përgjithshem.

Neni 44.

Me qëllim që të realizojë një shfrytëzim racional të truallit dhe që të vendosë raporte të barabarta sociale, ligji i imponon detyrime dhe kufizime pronës private mbi tokën, fikson kufijtë e shtrirjes së saj sipas rajoneve dhe zonave bujqësore, nxit dhe imponon bonifikimin e tokave, trasformimin e tokave bujqësore dhe rindërtimin e njësive prodhuese; ndihmon pronën e vogël dhe të mesme.

Ligji merr vendime në favor të zonave malore.

Neni 45.

Republika njeh funksionin social të kooperimit me karakter kreditor dhe pa qëllime të spekullimit privat. Ligji nxit dhe favorizon zgjerimin e tij me mjetet më të përshtatshme dhe siguron, me kontrollet e nevojshme, karakterin dhe qëllimin.

Ligji parashikon tutelën dhe zhvillimin e artizanatit.

Neni 46.

Me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe social të punës dhe në harmoni me kërkesat e prodhimit, Republika i njeh të drejtën punonjësit për të bashkëpunuar me mënyrat dhe kufijtë e përcaktuara nga ligji, në drejtimin e ndërmarrjeve.

Neni 47.

Republika inkurajon dhe tutelon kursimin në të gjitha format e tij, disiplinon, koordinon dhe kontrollon ushtrimin e kredisë.

Favorizon përdorimin e kursimeve popullore për blerjen e banesës, të pronës direkte me qëllim kultivimi dhe investimi direkt dhe indirekt me aksione në komplekset e mëdha prodhuese të vëndit.

TITULLI IV

MARDHËNIET POLITIKE

Neni 48.

Janë zgjedhës të gjithë qytetarët, burra e gra, që kanë mbushur moshën 18 vjeç.

Vota është personale dhe e barabartë, e lirë dhe sekrete. Ushtrimi i saj është e drejtë qytetare.

Ligji përcakton kushtet dhe mënyrat për ushtrimin e së drejtës së votës për qytetarët që banojnë jasht shtetit dhe siguron efektivitetin. Për këtë qëllim është krijuar një zonë zgjedhore për banorët jasht shtetit për zgjedhjen e Komisioneve Parlamentare, së cilës i janë dhënë një numër vendesh në Parlament të vendosur nga norma kushtetuese e sipas kritereve të përcaktuara nga ligji.

E drejta e votës nuk mund të kufizohet, vetëm për paaftësi civile ose për efekt të vendimeve penale të prera ose në rastet e padenjësisë morale të përcaktuara nga ligji.

Neni 49.

Të gjithë qytetarët kanë të drejtë të organizohen lirisht në parti për të kontribuar me metoda demokratike në përcaktimin e politikës kombëtare.

Neni 50.

Të gjithë qytetarët mund t’i drejtojnë peticion Parlamentit për të kërkuar vendime legjislative ose për të paraqitur nevoja të përbashkëta.

Neni 51.

Të gjithë qytetarët, të një gjinie apo një tjetër,mund të raportojnë me zyrat publike dhe me autoritetet e zgjedhura në kushte të barabarta, sipas kërkesave të përcaktuara nga ligji.

Ligji mundet që përsa i përket raportimit me zyrat publike apo me autoritetet e zgjedhura të barazojë me qytetarët, italianët të cilët nuk i përkasin Republikës.

Ai që thirret në funksionet publike të zgjedhura, ka të drejtë të disponojë të gjithë kohën e nevojshme për përmbushjen e tyre dhe të ruajë vendin e tij të punës.

Neni 52.

Mbrojtja e Atdheut është detyrë e shenjtë e qytetarit.

Shërbimi ushtarak është i detyrueshëm në kufijtë dhe mënyrat e përcaktuara nga ligji. Përmbushja e tyre nuk paragjykon pozitën e punës së qytetarit dhe as ushtrimin e të drejtave politike.

Urdhëri i Forcave Ushtarake informohet me shpirtin demokratik te Republikës.

Neni 53.

Të gjithë janë të detyruar të kontribojnë në shpenzimet shoqërore në përpjestim me aftësinë e tyre kontributive. Sistemi i taksave ndërtohet me kritere progresiviteti.

Neni 54.

Të gjithë qytetarët kanë për detyrë t'i jenë besnikë Republikës dhe të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet.

Qytetarët, të cilëve u janë besuar funksione shoqërore, kanë detyrë t'i përmbushin me disiplinë dhe ndershmëri, duke u etuar në rastet e parashikuara nga ligji.

2 Hyrja

Kush është shtetas i huaj?
Konsiderohet i huaj shtetasi i një vendi të tretë, domethënë i një Shteti që nuk bën pjesë në Bashkimin europian ose që është pa shtetësi, domethënë një person që asnjë Shtet nuk e konsideron si shtetas të vet. Normat që disiplinojnë hyrjen, qëndrimin dhe, në përgjithsi, statusin jigjor të të huajve në Itali përmbahen Tekstin e Vetëm mbi emigracionin (Dekreti Legjislativ nr. 286/98 e modifikimet e mëtejshme). Rregullat që përmbahen Ne Tekstin e vetëm mbi emigracionin nuk u aplikohen shtetasve të Shteteve anëtar të Bashkimit Europian.

2.1 Kufiri

1. Çfarë ndodh në kufirin italian?
Në kufi, të huajt, i nënshtrohen kontrolleve doganore. Pasi kalohet kufiri, auoritetet doganore vulosin pashaportën ku përcaktohet data dhe vëndi i kalimit.

2. Kush nuk pranohet të hyjë në Itali?
Të huaj të cilët paraqiten në kufi dhe nuk plotësojnë kushtet për hyrje në Itali dëbohen nga policia.
Të huaj të cilët kanë hyrë në Itali pa ju nënshtruar kontrolleve kufitare por janë ndaluar në hyrje ose menjëherë mbas, si edhe ata që janë pranuar përkohësisht në Itali për ndihmë, dëbohen me shoqërim në kufi.

3. Kush nuk debohet në kufi?
Nuk mund të dëbohen, edhe se nuk kanë dokumenta apo nuk plotësojnë kushtet për të hyrë në Itali, të huajt të cilët:

- kërkojnë strehim politik;
- gëzojnë statusin e refugjatit;
- janë të mitur nën moshën 18-vjeç, me përjashtim të rasteve kur duhet të ndjekin prindërit ose personin që i shoqëron në rast dëbimi;
- mbrohen përkohësisht për motive humanitare;
- gratë shtatëzënë;

Debimi i personave me aftësi të kufizuar, i të moshuarve, i minorenve, i komponentave të familjeve me një prind të vetëm me fëmijë minoren, ose i viktimave të dhunës së rëndë psikologjike, fisike apo seksuale, duhet bërë në çdo rast në mënyrë të pajtueshme me secilën prej situatave personale dhe vetëm pasi të jënë bërë verifikimet e nevojshme.

2.2 Vizat

4. Çfarë është viza e hyrjes?
Viza është autorizimi i lëshuar nga Konsullata apo nga Përfaqësia Diplomatike kompetente që i lejon të huajt të hyjë në Hapsirën Shengen apo në territorin italian; vihet në pashaportë apo në një dokument tjetër të barasvlefshëm me të.

5. Kush ka nevojë për vizë?

Të gjithë qytetarët të cilët konsiderohen të huaj:

- qytetarët e vendeve jokomunitare;
- personat pakombësi apo paatdhe.

6. Kush nuk ka nevojë për vizë?

Nuk kanë nevojë për vizë për të hyrë në Itali:

- qytetarët e të gjitha Vëndeve të Bashkimit Europian dhe të hapsirës Ekonomike Europiane: Austrisë, Belgjikës, Bullgarise, Kroacisë, Qipros, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Irlandës, Islandës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Lihteshtejnit, Luksemburgut, Maltës, Norvegjisë, Hollandës, Polonisë, Republikës Çeke, Rumanisë, Portugalisë, Anglisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë, Hungarisë, Rumanisë dhe Bullgarisë;
- qytetarët e San Marinos, Selisë së Shenjtë dhe Svicrës;
- të huajt që kur dalin nga Italia, kanë me vete përveç pashaportës, lejeqëndrimi të vlefshme dhe/ose lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë;
- të huajt që zotërojnë lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë, të dhënë nga një Shtet anëtar dhe familjaret e tyre me lejeqëndrimi, lëshuar poashtu nga Shteti anëtar i prejardhjes.
- të huaj që kanë lejeqëndrimi për studim, të lëshuar nga një Shtet tjetër anëtar (duke përjashtuar Anglinë, Irlandën dhe Danimarkën), nëse janë të regjistruar në një kurs universitar ose në një institut studimi superior, që me kushte të caktuara, trasferohet në Itali për të vazhduar studimet e filluara në një Shtet tjetër anëtar ose për t'u përfshirë në një program studimi që lidhet me to.

Të huajt, rezidentë në një Shtet të zonës Shengen, që zotërojnë leje qëndrimi, nuk kanë nevojë per vizë për qëndrime jo më të gjata se 90 ditë, me kusht që hyrja në Itali të mos jetë per motive pune të vartur, autonome ose studimi/shtazhi – studimi/formimi.
Poashtu, nuk është e nevojshme viza për qëndrim me kohë të shkurtër (qëndrim maksimal prej 90 ditësh për turizëm, mision, tregti, ftesa, gara sportive e studim), për qytetarët e disa Shteteve që nuk bëjë pjesë në BE. Në faqen web të Ministrisë së Punëve të Jashtme (http://www.esteri.it/visti) mund të konsultohet lista e Shteteve për të qytetaret e cilëve nuk nevoitet vizë.

Vini re: **<u>Për qëndrimin me kohë të gjatë (më shumë se 90 ditë), të gjithë të huajt duhet të pajisen gjithmonë me vizë.</u>**

7. Kujt nuk i jepet viza?

Viza e hyrjes mund ti mohohet:

- të huajve që janë dëbur nga Italia (përjashtuar ata që kanë një autorizim special për rihyrje ose atëherë kur ka kaluar afati kohor për ndalim hyrje) ose nga një prej Shteteve të BE-së;
- të huajve të cilët përbëjnë kërcënim për rendin publik dhe për sigurinë e Italisë dhe të vendeve të tjera të Bashkimit Europian në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

- të huajve kundër te cileve jane dhene denime, edhe në rast marreveshje mi fajsinë, per krimet e përmendura në **nenin 380 Koma 1 e 2 , c.p.p.**, ose për krime që kanë të bëjnë me lëndë narkotike, liri seksuale, favorizim të imigracionit të paligjshëm, reklutim minorenësh per ti punësuar në aktivitete të paligjshme ose personash për shfrytëzim prostituzioni.

Në rast hyrje për bashkim familiar viza mund të mohohet vetëm në rastin kur i huaji përbën një kërcënim konkret e aktual për qetesinë publike të Shtetit ose një prej shteteve me të cilët Italija ka nënshkruar marrëveshje për heqjen e kontrolleve në kufijte e brëndshëm për qarkullimin e lirë të personave.
Mohimi i vizës nuk motivohet (përjashtuar kërkesat për vizë punë, bashkim familjar, kurim e studim) e i komunikohet në një gjuhë të kuptueshme të interesuarit, në mungesë duhet bërë në anglisht, frëngjisht, spanjisht ose arabisht.

8. Çfarë mund të bëhët në rast së viza e hyrjes mohohet?

Kundër vendimit që mohon vizën mund të bëhët apel pranë Gjykatës Administrative Rajonale (T.A.R.) të Lazio-s, mbrënda 60 ditësh nga data e komunikimit zyrtar të vendimit.
Vetëm në rast mohim të vizës për bashkim familjar ose *"familiare al seguito"* apeli mund të prezantohet pranë Gjykatës kompetente pa limit kohor.

9. Për çfarë motivesh mund të bëj kërkesë për vizë?

Në **dekretin ndërministerial të 11 Majit 2011** elenkohen llojet e ndryshme të vizave, si dhe kërkesat dhe kushtet për marrjen e tyre.
Të njëzet e një llojet e vizave të parashikuara, që u korrespondojnë motiveve të ndryshme për hyrje janë: tregti, kurim, motive diplomatike, motive familjare, gara sportive, ftesë, vetë-punësimi, punësim, mision, motive fetare, rihyrje, *residenza elettorale*, kërkime shkencore, studim, tranzit aeroportual, tranzit, transportin, turizmin, pushimet e punës dhe vullnetarizëm.

10. Si duhet të veproj për të marrë vizën?

Duhet të paraqesësh kërkesën pranë Konsullatës apo Ambasadës italiane në vendin tënd të rezidencës. Në kërkesë duhet të përcaktosh:

- të dhënat e tua personale (emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendbanimin, shtetësinë) dhe ato të familjarëve të tu;
- të dhënat e pashaportës apo të një dokumenti tjetër të barasvlefshëm me të;
- motivin e udhëtimit;
- mjetet e trasportit që do të përdorësh;
- vendin ku do të qëndrosh;
- mjetet financiare për udhëtimin dhe qëndrimin.

Për dokumentat që duhet të paraqesësh së bashku me kërkesën sipas llojit të vizës mund të konsultosh faqen web të Ministrisë së Jashtme www.esteri.it/visti, ku mund të gjesh edhe një model të formularit me të cilin mund të bësh kërkesë për vizë.

Vini re: në rast se deklaron dëshmi ose paraqet dokumenta të rreme, ndëshkohesh me përgjegjësi penale e kërkesa jote nuk do të pranohet.

11. Sa kohë zgjat praktika e marrjes së vizës?
Viza mund të lëshohet apo mohohet brenda 90 ditësh nga paraqitja e kërkesës; për punë të vartur duhen 30 ditë dhe për punë të pavartur 120 ditë.

12. Kur nuk duhet viza për rihyrje?
Viza e rihyrjes lëshohet nga përfaqësia diplomatike apo konsullore italiane në vendin e origjinës. Ajo te lejon të rikthehesh në Itali në këto raste.

- kur ke një dokument lejeqëndrimi me kohëzgjatje prëj një ose dy vjetësh, të skaduar prej më shumë se 60 ditësh, me kusht që të paraqesësh edhe dokumentin e skaduar në rast se mund të provosh një gjendjë të rëndë shëndetsore të qytetarit te huaj, të familjarve të shkallës së parë, të bashkëshortit/es, mjafton që lejeqëndrimi të ketë skadur nga jo më shumë se gjashtë muaj;
- kur nuk e ke më dokumentin e qëndrimit, sepse e ke humbur apo ta kanë vjedhur, me kusht që paraqesësh kopjen e denoncimit të vjedhjes apo të humbjes.

13. Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për turizëm?

- Viza për turizëm lejon hyrjen për një qëndrim afat shkurtër (maksimumi 90 ditë) në Itali e në Shtetet e tjera te hapesirës Schengen, e qytetarit të huaj që dëshiron të udhetojë për motive turizmi.

  Kushtet për marrjen e vizave janë:
- dokumentacion që dëshmon se keni mjetet finanziare të nevojshme për qëndrim në Itali (kartë kredie, fideiusione bankare, kontratë sigurimi, etj.);
- bileta vajtje-ardhje ose prenotim i saj;
- dokumenti që dëshmon disponueshmërinë e një vendbanimi (prenotim i një hoteli, deklaratë nga dikush që të garanton vendbanimin, etj.);
- sigurim mjekësor.

14. Çfarë kërkesash duhet të plotësoj për të marrë vizën për motive studimi?
Kushtet dhe kërkesat për të marrë vizën janë:

- garanci të dokumentuar rreth kursit të studimeve, kursit të formimit profesional ose kursit të financiuar nga qeveria italjane që dëshironi të ndjekni ose aktivitet kërkimor që dëshironi të zhvilloni.
- garanci reth kushteve ekonomike. Për të plotësuar këto kushte nevoiten 442.30 € në muaj (5.750,00 në vit), për çdo muaj të vitit akademik. Në Itali disponibiliteti i mjeteve ekonomike duhet të provohet me anë të garancisë personale ose me anë të një garancie nga istitucionet ose entet italjane ose të huaja (nuk mund të garantohet me anë të një fidejusioni bankar ose të një *"polizza fideiussoria"*)
- siguracion shëndetsor për kura mjeksore e shtrime në spital kur nuk keni të drejtë për asistencë shëndetsore në Itali në bazë të marrëveshjeves në fuqi me vendin tënd.
- disponibilitet strehimi: prenotim në hotel ose deklarata mikpritje, dhëne nga një qytetar italjan ose i huaj rezident regullisht në Itali.

Viza e hyrjes për të marrë pjesë në aktivitete studimi ose kurse formimi profesional rreth argumentash mjeksore që parashikojnë ushtrimin e profesionit, përveç përmbushjes se të gjitha kushteve të parashikuara nga normativa, parashikon edhe njohjen paraprake të titullit të studimit nga ana e Ministrisë së Shëndetsise. Në rastet në të cilat nuk parashikohet ushtrimi i aktiviteve në fushën e mjeksisë, përgjegjësi ligjior i strukturës shëndetsore ku do kryhet aktiviteti i studimit duhët të lëshojë një deklaratë specifike Zyrave te Konsullatës.

15. **Kujt mund ti lëshohet viza për studime?**

Viza për studim lejon të huajin të hyjë në Itali, për qëndrim kohegjatë, por të determinuar, për të ndjekur kurse universitare.

Viza për studime, për një kohe të gjatë ose të shkurter, ju lëshohet të huajve:

- mbi 18-vjeç që dëshirojne të ndjekin studimet e larta në basë të studimeve të mëparshme, për të cilat duhet te deshmojnë mbrojtjen në vendin e originës;
- maxhorenët e pranuar për të frequentuar kurse të shkollimit dytësor superior (gjimnaz) dhe kurse të shkollimit dhe formimit teknik superior;
- të miturit nën katërmbedhjetë vjec që marrin pjesë në projektet e shkëmbimit ose inciativa kulturore të aprovuara nga Ministria e Arsimit, Universitetit dhe Punës Kërkimore-shkencore ose nga Ministria për Pasuritë dhe Aktivitet Kulturore;
- të huajt që marrin pjesë në aktivitete të parashikuara në kuadrin e programeve të asistencës e të kooperimit italian;
- të huajt që duan të hyjne për të marrë pjesë në aktivitete kërkimore të avancuara ose kulturore të larta, qe nuk perfshihen ne kategorite e parashikuara nga neni nr. 27 të Teksitit të Vetëm për Imigracionin 286/98.
- personat që janë pranuar për të frekuentuar kurse formimi profesional dhe praktika profesionale, të përfshirë në kuotat vjetore të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe e Politikave Sociale.

16. Ku mund të kërkoj vizë për motive studimi?

Mun të kërkosh personalisht vizë pranë përfaqësisë diplomatike apo konsullore në vendin tënd të rezidencës. Në rastin e fundit, duhet të tregosh lejeqëndrimin në vendin ku kërkon vizë**.**

17. Si të veproj për të hyrë në Itali me një vizë për motive studimi?

Viza për studim mund të jetë dy llojesh:

- vizë Shengen me afat të shkurtër, më pak se 90 ditë, brenda një semestri; në këtë rast duhet të deklarosh praninë tënde në territor autoriteteve të kufirit,ose Kuestorit të provincës në të cilën ndodhesh brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali;
- vizë kombëtare me afat të gjatë, për qëndrime që i kalojnë 90 ditët, por megjithatë me afat të përcaktuar; në këtë rast duhet të kërkosh lejeqëndrimi për studim, gjithnjë brenda 8 ditësh pune nga hyrja juaj në Itali.

18. Kam gjetur një kurs universitar që deshiroj të frekuentoj në Itali, si mund të rregistrohem?

Në Itali, çdo vit akademik, të gjitha univeristet, istitutet e larta të formimit artistik, musikor e koreografik reservojne një numër të caktuar vëndesh për çdo program, për studentët e huaj, residentë jashte shteti. Në faqen web http://www.studiare-in-italia.it/studentistranieri/ mund të konsultoni numrin e vendëve të rezervuara për vitin akademik për studentët e huaj.
Kur gjeni një kurs studimi për të cilin jeni të interesuar, mund të paraqisni, mbrënda kohës se duhur, kërkesën për para-regjistrim në Universitetin Italian që keni zgjedhur, kërkesë që duhet dorëzuar në përfaqësimin diplomatik konsullor italian në vendin tuaj. Aplikimi duhet bërë në kopje origjinale dhe duhen bërë dy kopie për Modelin "A"/Form "A" në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit dhe Universitetit. Kërkesa duhet të shoqërohet nga një sërë dokumentesh, të përkthyera zyrtarisht në italisht, të cilat gjenden në të njëjtin model.
Përfaqsia konsullore pasi ka marre aplikimi për para-regjistrimin procedon **me dhënien e vizës për hyrje**, në mënyrë që t' ju lejojnë të beni provimin për pranim dhe të regjistroheni në Universitet.
Nëse nuk jeni përjashtuar për shkak se jeni në zotërim të një çertifikate të vlefshme të gjuhës italiane, duhet mbështesni një prove të gjuhës, e cila mbahet në selinë e Universitetit të zgjedhur nga ju, sipas orarit të publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit.

19. Kam lejeqëndrimi në një vënd tjëtër të Bashkimit Europian. Duhet të kërkoj vizë për të vazhduar studimet e mia në Itali ose për të frekuentuar një kurs që i përshtatet studimeve të mia?
Jo, me kusht që ti të plotësosh kushtet e kërkuara nga ligji italian, nësë merr pjesë në një projekt shkëmbimesh komunitare ose bilaterale me Shtetin e origjinës ose je i autorizuar për të banuar në një vend tjetër të Bashkimit Europian për të paktën dy vjet dhe i bashkangjit kërkesës për lejeqëndrimi dokumentat e lëshuara nga autoritetet akademike të vendeve të BE-së ku ke kryer studimet, nga ku rezulton që programi i studimeve që duhet të vazhosh në Itali është plotësues i atyre që ke kryer. Në rast së qëndrimi në Itali i kalon tre muaj në ç'do rast është e nevojshme kërkesa për lejeqëndrim.

20. Mund të marr vizë për motive studimi pa njohur gjuhën italiane?
Jo, kërkohet njohja fillestare e gjuhës italiane, e cila testohet gjatë bisedës pranë Universiteti që keni zgjedhur, sipas një kalendari të publikuar në faqen web të Ministrise se Arsimit. **Prova për njohjen e gjuhës italjane nuk nevoitet në rast se kursi i studimeve zvidhohet esklusivizht në gjuhe të huaj, në kete rast çdo Universitet në basë të autonomisë që disponon, mund të kërkojë një çertifikatë specifike.** Nuk pranohen në provat e tjera të aftësive ata që nuk kanë kaluar provën e gjuhës italiane.

21. Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizë për kura mjeksore?
Viza mjeksore lejoh hyrjen për një periudhë të shkurtër ose të gjatë, por gjithmone për një periudhe të përcaktuar, të huajit që ka nevoje ti nënshtrohet trajtimeve mjeksore pranë istitucioneve mjeksore italiane. Qytetari i huaj që bën kërkesë për vizë mjeksore duhet të ketë:

- **dokumentacion shëndetsor që përfshin**:
  - dokumentacion mjeksor të lëshuar në Shtetin e rezidencës që dëshmon sëmundjen aktuale;

- deklaratë të strukturës shëndetsore italiane publike ose private (kjo e fundit duhet të jetë e njohur nga Shërbimi Shëndetsor Kombëtar) që tregon se për çfarë sëmundjeje behet fjalë, datën e fillimit, kohëzgjatjen e vlerësimin e kostos;
- deklaratë të spitalit që konfirmon depozimin e të paktën 30% të vlerës totale të shpenzimeve për kurim;

- **dokumenta që provojnë burime ekonomike të mjaftueshme** për pagesën e pjesës tjetër të shpenzimeve shëndetsore e të qendrimit jashtë strukturës shëndetsore, e për rikthimin e të sëmurit e të ndonjë shoqëruesi. Viza për kura mjeksore mund ti lëshohet edhe personit që shoqëron te sëmurin. Shoqëruesi duhet të ketë siguracion shëndetsor, që mbulon minimalisht 30.000 €.

Për kurat mjeksore që u përkasin progameve humanitare të rajonit, viza lëshohet vetëm me vërtetim specifik e të emëruar, të lëshuar nga autoriteti kompetent rajonal, që dëshmon eksistencën e një rezolutë të veçantë për alokimin e fondeve për programet e mirëqënies, dhe mbulimin ekonomik të ndërhyrjes shëndetësore.

22. Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për motive fetare?

Mund të marrin këtë lloj vize besimtarët që marrin pjesë në manifestime fetare apo që ushtrojnë funksione fetare, pastorale ose kishtare.

Kushtet që duhet të plotësojë janë:

- dokumenta që dëshmojnë gjëndjen tënde si besimtar;
- garanci të dokumentuara rreth karakterit fetar të manifestimit ku do të marrësh pjesë;
- bileta e udhëtimit;
- mjete të jetesës ose, në rast se shpenzimet e qëndrimit janë në ngarkim të një enti fetar, një deklaratë nga ky ent;
- **sigurimi shëndetsor me mbulesë minimale prej 30.000 € për mbulimin e shpenzimeve të një shtrimi në spital urgent apo edhe të shpenzimeve për rikthimin në atdhe.**

Në rast ftese nga ana e një shoqate fetare që vepron në Itali e cila nuk i referohet asnjë prej kulteve që kanë marrëveshje me Shtetin italian ose kulte që nuk njihen nga ligji, viza lëshohet vetëm pas verifikimit nga ana e Ministrise së Brëndeshme rreth natyrës së përshtatshmërisë së statusit të ketij kulti me principet e Shtetit italian.

23. Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për motive pune?

Varet nga lloji i punës. Në Itali raporti i punës mund të jetë dy llojesh:

- punë e vartur me kohë të caktuar, të pacaktuar ose sezonale;
- punë e pavartur.

(Për më shumë hollësi shiko kapitullin “Puna”)

24. Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizë për bashkim familjar me bashkëshortin/ten jashtë shtetit?

Për të marrë vizë për bashkim familiar pranë bashkëshortit/es jashtë shteti është e nevojshme të kesh lejeqëndrimi të rregullt me afat minimal prej një viti të lëshuar për motive pune, asili, studimesh, fetare ose familiare. Për të marrë një vize hyrjeje i huaji, rregullisht resident në Itali, duhet të prezantojë kërkesë për autorizim *(nulla osta)* për bashkim familjar pranë Sportelit të Vetem për Imigracion, me anë të procedurës së informatizuar që gjëndet në faqen web të Ministrisë së Punëve të Brëndëshme. Udhëzimet në detaj rreth dokumentave që nevojiten për bashkimin familjar ndodhen në një nga modelet online (modeli S). Sporteli i Vetëm për Imigracion pasi shqyrton kërkesën thërret pranë zyrave kompetente të huajin, pasi kanë vendosur paraprakisht një datë takimi, për t'u presantuar dhe firmosur dokumentat e nevojshëm që dëshmojne rreth të ardhurave dhe banesës.

I huaji resident në Itali duhet të vërtetojë se ka:

- **një banesë** të përshtatshme që plotëson kushtet higjenike e shëndetsore sipas çertifikatës së lëshuar nga zyra kompetente e bashkisë. Përshtatshmëria e banesës nuk mund te vetëçertifikohet por duhet *(në original plus fotokopie) e duhet kërkuar në zyrën teknike të bashkisë kompetente për residencën.* Në rast se i huaji që bën kërkesë është mysafir, duhet ti bashkangjisë kërkesës një deklaratë (modeli S2) të kompiluar nga i Zoti i banesës që deklaron se është dakort për të mikpritur edhe bashkeshortin/en e të huajit. Duhet të prezantoje pranë Sportelit të Vetëm edhe një kopje të kontratës ose pronesisë së banesës me kohëzgjatje jo më të shkurtër se gjashtë muaj.
- **Të ardhurat vjetore**, me prejardhje të ligjshme, duhet të jenë të paktën sa ½ e shumës vjetore të ndimës sociale për çdo familjar që bashkohet. Për bashkimin me bashkëshortin/ten është e nevojshme të vërtetoni se të ardhurat vjetore, për vitin 2013, janë të paktën të barabarta me 8,624.85 €. Pragu minimal i të ardhurave mund të arrihet edhe duke marrë parasysh të ardhurat totale vjetore të anëtarëve të tjerë të familjes që mund të jetojnë me aplikuesin.

Vini Re: paramentrat e të ardhurave ndryshojnë nga viti në vit. Kërkesa per të ardhurat rritet në varësi të numrit të anëtarëve të familjarëve me të cilët do të ribashkoheni.
Shuma vjetore e ndimës sociale rritet 1/2 për çdo anëtar të familjes me të cilin ribashkoheni. Për shembull, për tu ribashkuar me bashkëshortin dhe me një fëmijë më te madh se 14 vjeç, për vitin 2014, duhen 11.637,86 € (dmth. € 5.818,93 + 2.909,46 + 2.909,46).
Për bashkim e dy ose më shumë fëmijëve të moshës nën 14 vjeç, ose dy ose më shumë anëtarë të familjes së atyre që kane statusin e mbrojtjes së përkoshme, do të jetë gjithmonë e nevojshme të kenë të ardhura prej jo më pak se dyfishi i ndimës sociale vjetore.

Dokumentat që duhen prezantuar për të dëshmuar të ardhurat ndodhen në udhëzimet e bashkangjitura në formularet. Për shembull:

- **Punetorët e vartur** duhet të presantojnë deklaratën e fundit të të ardhurave, kopje të dokumentit të fundit të rrogës dhe dëshmi të punëdhënësit (modeli S3) nga e cila rezulton që raporti i punës është akoma i vlefshem, nëse ky raport nuk ka arritur akoma periudhen një vjeçare e nuk është bërë akoma deklarata e të ardhurave, atëherë duhen dorëzuar të ardhurat e parashikuara të punëtorit.
- **Punetoret shtëpiake** duhet të presantojnë deklaratën e fundit të të ardhurave ose në rast se një dokument i tillë mungon, duhet komuniki i punësimit pranë Inps-it dhe dokumenti që dëshmon pagimin e kontributeve për tre muajt e mëparshëm të personit që bën kërkesën, dhe vetëdëshmia e punëdhënësit nga e cila rezulton se raporti i punës është akoma i vlefshëm.

- **Punetorët e pavartur** duhet të prezantojnë *"modello Unico"* të të ardhurave dhe *ricevutën* që dëshmon prezantimin e tij (në rast se aktiviteti është hapur prej më shumë se një viti) ose një raportim të kontabilitetit të bërë nga konsulenti i biznesit për periudhën e aktivitetit.

Vini re: autorizimi *(nulla osta)* nuk është i nevojshem për familjarët e huaj të shtetasve italianë, qytetarët e Bashkimit Europian ose te një shteti palë të Marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Europiane (Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia).
Nëse aplikanti është refugjat nuk duhet të demonstrojnë që i përmbush kushtet për sa u përkët të ardhurave dhe strehimit.

25. I huaji, i cili ndodhet në Itali, për cilët familjarë mund të kërkojë vizë?

- Bashkëshortin/ten, mbi 18 vjeç dhe jo të ndarë me ligj;
- të miturit, edhe ata të bashkëshortit ose të lindur jashtë martësës, të pamartuar me kusht që prindi tjetër, në rast se jeton, të ketë dhënë pëlqimin e tij. Fëmija duhet të jetë me i vogël se 18 vjeç në momentin e prezantimit të kërkesës;
- fëmijët në moshë madhore të pa martuar qe i ka në ngarkim, në rast se ata vetë nuk mund të përkujdesen për nevojat e tyre të domosdoshme të jetësës për motive shëndetsore (invaliditet i plotë);
- prindërit në ngarkim, me kusht që të mos kenë femije të tjerë në vëndin e originës ose të prejardhjes, ose prindër mbi 65 vjeç, me kusht që femijët e tjerë të mos kenë mundësi ti mbajnë, për motive të rënda shëndetsore, të dokumentuara.

Nuk lejohet bashkimi familjar nëse i huaji rezulton i martuar me një person tjetër resident në Itali.

Lejohet hyrja për bashkim familjar me femijën në moshë **të mitur**, që banon rregullisht me **prindin tjetër**. Kerkesa për autorizim mund të presantohet **për të miturin** nga **prindi** rregullisht **rezident**. Për sa u përkët plotësimit të kushteve të të ardhurave ekonomike dhe të banesës do të konsiderohen ato të prindit tjetër.

26. Sa kohë duhet për të marrë autorizimin *(nulla osta)* për bashkim familjar?

Autorizimi për bashkim familjar duhet të lëshohet brënda 180 ditëve të kërkesës. Autorizimi transmetohet nga Sporteli i Vetem elektronikisht direkt në zyrat konsullore. Është i vlefshëm për të bërë kërkesë për bashkim familjar brënda 6 muajsh nga data e lëshimit.

27. Çfarë dokumentash duhen për të marrë vizën për bashkim familjar?

Pasi merret autorizimi për bashkim famijar, brënda gjashtë muajsh nga lëshimi, familjari akoma rezident jashtë shteti duhet të prezantojë te përfaqsia diplomatike konsullore e vendit të vet kërkesën për vizë duke bashkangjitur:

- Autorizimin për bashkim familjar;
- Një dokument udhëtimi të vlefshëm ose me skandencë të pakten mbi 3 muaj përtej datës së vizës qe kërkohet;
- Aktet e gjëndjes civile që dëshmojne lidhjen familjare, e atëherë kur kërkohet, dokumenta të vlefshëm që provojne se bëhët fjalë për një familjar në ngarkim, që provojnë gjëndjen shëndetsore e mungesën e një mbështetje familjare të përshtatshme.

Në rast se është i pamund mbulimi i kërkesave dhe kushteve të parashikuara me anë të çertifikatave ose dokumenta të tjerë të lëshuar nga autoritet përgjegjëse të huaja, ose për faktin se mungon një autoritet i johur, ose atëhere kur ekzistojneë dushime mbi vërtetësine e dokumentit, përfaqsia diplomatike e konsullor mund të lëshoje çertikata në basë të ekzaminimit te DNA-së e të verifikimeve të tjera të konsideruara të nevojshme. Këto shpenzime duhen mbuluar nga i huaji që bën kërkesë.

Autoriteti konsullor organizon përkthimin dhe legalizimin e dokumenteve të prodhuara në vend.
Legalizimi nuk është e nevojshme nëse ka marrëveshje dypalëshe ose ndërkombëtare mbi heqjen e legalizimit për dokumentet publike të huaja (Konventa e Hagës, 1967 "Apostillë").
Viza lëshohet ose mohohet brënda 30 ditëve nga data e kërkesës. Nëse ribashkim kërkohet nga mbajtësi i statusit të mbrojtjes ndërkombëtare, aplikimit nuk mund të motivohet vetëm nga mungesa e dokumenteve që dëshmojnë ekzistencën e lidhjeve familjare (ose nga posedimi i kërkesave të tjera nga ana e familjes).

28. Çfarë është viza e hyrjes për *"familiare a seguito"*? Si mund të merret?
Viza e hyrjes për *"familiare a seguito"* promovon kohezionin e familjes, nëpërmjet mundësisë për anëtarët e familjes së një të huaji që ka vizë për punë të vartur me një kontratë me kohëzgjatje jo më pak se një vit, ose për vetëpunësim nuk, ose për studim, ose për arsye fetare, të hyjnë në Itali direkt sëbashku me familjarin.
Mund të ndjekun familjarin vetëm anëtarët e familjes me të cilët i huaji ka mundesi të për të zbatuar ribashkimin (shih më lart) dhe me kusht që të përmbushë kërkesat e mësipërme në lidhje me disponueshmërinë e strehimit dhe të ardhurave.
Procedura për dhënien e ketij autorizimi është ngjashme me procedurën për lëshimin e autorizimit për bashkimi familjar. Kërkesa duhet të përcillet elektronikisht në Sportelin e Vetem për Imigracionin duke përdorur formularin T *(modulo T)* në këtë faqe web https://nullaostalavoro.interno.it/
Në këtë rast, aplikanti i huaj, duke qënë akoma jashtë vendit, mund të përdorë, për të paraqitur kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, një prokuror të posaçëm. Në këtë rast, në Sportelin e Vetem, përveç dokumentacionit të parashikuar për bashkim familjar, duhet dorëzuar edhe:
• fotokopje të dokumentit personal të delegatit;
• **delegim në favor të një qytetari italian ose të huaj me banim të ligjshëm në Itali, për të paraqitur kërkesë për autorizim për *"familiare a seguito"*, të hartuara nga i huaji i cili ka marrë tashmë një vizë të përkthyer dhe të legalizuar nga ana diplomatike konsullore italiane jashtë vendit.**

3 QËNDRIMI NË ITALI

3.1 Lejeqëndrimet

29. Çfarë është lejeqëndrimi?
Është një autorizim që lëshohet nga Kuestori dhe lejon qëndrimin e të huajit në territorin e Shtetit. Mund të jetë me kohë të caktuar apo të pacaktuar.

30. Kur dhe ku mund ta kërkoj?
Lejeqëndrimi duhet të kërkohet detyrimisht brënda 8 ditëve pune nga hyrja në Italia.
Vonesa justifikohet vetëm për raste të rënda.
Lejeqëndrimi nuk kërkohet në rastet e hyrjes dhe qëndrimit në Itali për vizita, biznes, turizëm dhe studim, për periudha që nuk i kalojnë tre muaj, për të cilat është e mjaftueshme të raportoni praninë e tuaj në kufi ose në policinë e provincës ku ndodheni. I huaji që vjen nga Shtete që nuk zbatojnë Marrëveshjen e Shengenit detyrimin e deklaratës së prezencës e kryhen me anë të vulës të uniformuar Shengen mbi dokumentin e udhëtimit në momentin e kontrollit në kufi.
I huaj që vjen nga Shtete që zbatojnë Marrëveshjen e Shengenit duhet të paraqesin një deklaratë të pranisë, brenda tetë ditëvesh shefit të provincës në të cilën dodhen. Për ata që qëndrojnë në hotele do të përbëjë deklaratë kopja e pranis pranë hotelit e nënshkruar nga të huaji. Një kopje e këtyre deklaratave i dorëzohet të huajit që duhet paraqitur sa herë që kërkohet nga zyrtarët dhe agjentët e sigurisë publike.
Kërkesat për një numër të ndryshëm lejeqëndrimesh duhet të paraqiten nga personi në zyrat e postës, duke përdorur formularin në dispozicion në të gjitha zyrat postare, pranë sindikatatave dhe komunave ku sherbimi është aktivizuar.
Në veçanti, duhet të dorëzohen në zyrën postare të kualifikuar për pranimin e aplikacioneve (zyrat postare me Sportelin Mik), aplikacionet për lejeqëndrimi për keto motive:

- në pritje punësimi;
- në pritje të nënshtetesisë;
- asil politik (ripërtritje);
- trasformim të lejeqëndrimit;
- familjar;
- punë të pavartur;
- punë të vartur;
- punë raste të veçanta;
- punësim i vartur sezonal;
- mision;
- motive fetare;
- *“residenza elettiva”*;
- pa nënshtetisi (ripërtritje);
- studime (lejeqëndrimi me kohë te gjatë);
- stazh për formim profesional.
- karta blu BE

Kërkesa për lëshimin e dokumentit duhet të dorëzohet direkt në stacionin e policisë në rastet e lejes për:;
- politik;

- kura mjeksore;
- gara sportive;
- drejtsi;
- integrim i të miturit;
- ftesë;
- minoren;
- familje (në rastin e lejes së lëshuar për një të huaj që të mos jetë përjashtuar në pajtim me nenin nr. 19 të Tekstit të Vetem për Imigracion);
- humanitare;
- pa nënshtetesi;
- puna pushime, dhe jo në të gjitha rastet e tjera të përmendura në mënyrë të qartë.

Leje e qëndrimit dhe leje qëndrimi i përhershëm për anëtarët e familjarve të shtetasve të BE-së mund të kërkohen pranë zyrave të postës, duke përdorur kitin e posatshëm, ose në stacionin e policisë.
Aplikacioni, pasi të kompilohet ne kopje të shtypur nga ana e shtetasit të huaj, duhet të dorëzohet në zarf të hapur në oraret e caktuara në varësi të llojit të lejes, në zyrën postare.
Në alternativë shtetasi i huaj mund ti drejtohet një komunë apo patronazhi te sindikatava për përpilimin elektronik të kërkeseës (kopje e formularit të plotësuar elektronikisht në çdo rast do t'i dorëzohet Zyrës së postës).
Nëse shtetasi i huaj jo-BE ka autorizimin dhe është duke kërkuar leshimin e lejes së parë të qëndrimit për arsye pune apo bashkimi familjar, qytetari duhet të shkojë në Zyrën e Imigracionit (SUI) të Prefekturës pergjegjëse. Pranë zyrës do ti dorëzohet kërkesa për lëshimin në zarf të hapur që duhet dorëzuar në zyrën postare.
Në Sportelit e Vetëm duhet paraqitur kërkesa për trasformimin e lejeqëndrimit për të studiuar në lejeqëndrim për qëllime punësimi, si dhe trasformimi i lejeqëndrimit për punë sezonale për punë të vartur.

31. Çfarë dokumentash duhet të paraqes për të marrë lejeqëndrimin?
Për të marrë ose rinovuar lejeqëndrimin duhet të dorëzoni:
- formularin e aplikimit;
- pashaportën ose një dokument tjetër udhëtimi, të vlefshëm, me vizën e hyrjes, nëse kërkohet;
- një fotokopje të të njëjtit dokument që zotëron;
- nr. 4 fotografi fortmat pashaporte, të jenë të kohëve të fundit dhe identike;
- *contrassegno telematico* 16 €;
- dokumentacionin i nevojshëm për llojin e lejes së qëndrimit;
- deshmi pagese së një kontributi prej 80 € deri 200 € në varësi të llojit të lejeqendrimit të kërkuar.
- pagesa e një kontributi prej 27,50 € për koston e lejes në formë elektronike.

Policia mban një kopje të të gjitha dokumentave. Një kopje tjetër do t'ju dorëzohet e duhet të përmbaje vulën e zyrës në të cilën kërkesa është dorëzuar, nënshkrimin e zyrtarit, datën e paraqitjes së kërkesës dhe datën e tërheqjes së lejeqëndrimit.

Vini Re: Në momentin e paraqitjes së praktikës në sportelin e zyrës së postës, të huajit do ti komunikohet data e takimit në të cilën ai duhet të paraqitet në stacionin policor, i pajisur me fotografi, për të lënë shenjat e gishtërinjve.

32. Sa kushton kërkesa për lejeqëndrim?

Kur aplikoni për lejeqëndrim, duhet:

- një "contrassegno telematico" prej 16 €;
- duhen paguar 30 € në zyrën postare për të nisur rrakomandatën;
- duhen paguar pranë zyrës postare 27,50 € me anë të një *"bollettino prestampato*" për lëshimin e lejeqëndrimit në format elektronik;
- duhen paguar përmes një *"bollettino"* në dispozicion në zyrat e postës, një kontribut prej **80 deri ne 200 €** sipas llojit dhe kohëzgjatjes së lejes së kërkuar (shiko **tabelën**),

Ky kontribut duhet paguar edhe rast të mohimit ose humbjes së lejeqëndrimit. Megjithatë, në rastin e fundit, pasi shuma e kontributit është proporcionale me periudhën e vlefshmërisë së lejeqëndrimit do të paguani vetëm shumën në lidhje me periudhën e mbetur të vlefshmërisë së lejes së re të lëshuar.

Në rast se lejeqëndrimi mohohet nuk keni të drejtë rikthimi të shumës që keni paguar. Parashikohet kthimi i kostos së lejeqëndrimit elektronik (27.50 €) vetëm në rast se i interesuari paraqet kërkesë pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Vini Re: Nuk duhet të paguajnë kontributin:

- fëmijët nën moshën 18 vjet
- fëmijët e mitur duke përfshirë edhe ata të bashkëshortit apo të lindurit jashtë martesës
- ata që kanë lejeqëndrimi për trajtim mjekësor, apo ata që hyjnë në Itali për t'ju nënshtruar trajtimeve mjekësore
- shtetasit e huaj të cilët kërkojnë lëshimin ose ripërtritjen e një kërkese për leje për azil, azil politik, mbrojtje ose për arsye humanitare
- kandidatët për trasformimin e një lejeqëndrim akoma te vlefshëm
- aplikantët që duan të azhornojnë lejeqëndrimi
- familjarët e shtetasve të BE-së që qëndrojnë në bazë të dekretit LGS. nr. 30/2007.

33. Sa kohë zgjat lejeqëndrimi?

Kohëzgjatja e lejeqëndrimit të lëshuar është e barabartë me atë të parashikuar në vizën e hyrjes, nëse kërkohet, dhe në çdo rast për:

- punësimi me kontratë të përhershme: një maksimum prej 2 vjetësh;
- punësimi me kontratë me afat të caktuar: të barabartë me kohëzgjatjen e kontrates së punës, apo të paktën 1 vit;
- vetë-punësim: maksimum prej 2 vjetësh;
- punë sezonale: deri në 9 muaj (pavarësisht nga fusha e punës);
- në pritje të punësimit: të paktën 1 vit, ose për gjithë kohëzgjatjen e dhënies së mbështetjes, me të ardhurat që mund të merrni si punonjës i huaj, në qoftë se është më e lartë(Ligji nr .92/2012);
- studim dhe trajnim: maksimumi 1 vit;
- familjar: si mbajtës te së drejtës për bashkim familjar, ose të paktën 2 vjetësh;
- punë vullnetare: normalisht 1 vit ose një maksimum prej 18 muajsh;
- hulumtimet shkencore: të barabartë me atë të programit të kërkimit (Dekreti Legjislativ 17/2008);
- *residenca elettorare*: maksimumi 2 vjet.

Vini Re - Ligji n. 128 i datës 28 nëntor 2013 ka ndryshuar kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit për studim, duke deklaruar se do të jetë shumë vjeçare, e barabartë me kohën e kursit të studimit ose trajnimit, përveç nëse një auditim të fitimit vjetor. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi sapo rregullorja për zbatimin e Teksitit të vetëm do të rregullohen me rregullat e reja.

34. Si mund të ripëtrij lejeqëndrimin?
Ripërtritja e lejeqëndrimit duhet të kërkohet (nëpërmjet postës ose në polici, në varësi të arsyeve për ripërtëritjen) së paku 60 ditë para skadimit afatit të skadencës. Ky afat është vetëm indikativ, dhe në rast se nuk respektohet nuk parashikohet ndonjë dënim i menjëhershëm. Konsiderohet i paligjshëm i huaji me lejeqëndrimi të skaduar prej më shumë se 60 ditësh, në qoftë se nuk ka bërë kërkesë per ripërtritje.

35. Cilat janë të drejtat e të huajve gjatë periudhës së lëshimit ose ripërtritjes së lejeqëndrimit?
Gjatë periudhës së lëshimit ose ripërtritjes së lejeqëndrimit, për kohëzgjatjen e nevojshme per kryerjen e procedurave, i huaji gezon legjitimitetit te plotë lejeqendrimi e punë, me kusht që:

a) kërkesa për lëshimin e lejeqëndrimit për arsye pune të jetë kryer nga punonjësi i huaj në përfundim të kontratës së qëndrimit, ose, në rastin e ripërtritjes, kërkesa të paraqitet para se të skadojë, ose brenda 60 ditëve nga skadimi i njëjtës;
b) të jetë lëshuar nga zyra kompetente dokumenti që konfirmon paraqitjen e kërkesës për lëshimin ose ripërtritjen e lejes.
c) efektet e të drejtave të ushtruara në pritje të lëshimit ose ripërtritjes së lejeqëndrimit bien poshtë vetëm në rast të moslëshimit, ripërtritje, revokim ose anulim të lejes.

Është, pra, plotësisht e ligjshme në pritje të lëshimit apo gjate ripërtritjes së lejeqëndrimit, regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar, ripërtritja e kartës se identitetit të skaduar, ndryshimi i vendbanimit, përfitimi i sigurimeve shoqërore, marrja e patentës etj.

36. Sa kohë zgjatë ripërtërja?
Lejeqëndrimi ripërtërihet për një periudhë kohe jo më të gjate se ajo fillestare.

37. Kur nuk mund të ripërtërihet lejeqëndrimi?
Lejeqëndrimi nuk mund të ripërtërihet apo të zgjatet, nëqofte se e keni ndërprerë qëndrimin në Itali, duke qëndruar jashtë vendit për një periudhë më të gjatë se 6 muaj, apo më shumë se gjysmën e periudhës së vlefshmërisë së lejeqëndrimit, përjashtuar rastet serioze (shërbimi ushtarak dhe të ngjashme).
Ripërtritja e lejeqëndrimit refuzohet edhe në mungesë të kërkesave të përcaktuara nga ligji për leshimin e tij. Ndër arsyet kryesore per te cilat refuzohet kerkesa për të ripërtritje është ndërprerja e kontrate se lejës për punësim, mungesa e një strehim të përshtatshëm si edhe te ardhurave ose per shkak të raportimit të "papranueshmërisë", nga ana e një vendi të zonës Shengen, etj.

38. A mund të trasformoj lejeqëndimin për motive studimi në lejeqëndrimi për motive pune?
Po, para skadencës dhe brënda numrave të kuotave vjetore të caktuara, mund të trasformoni lejen e lëshuar për studim në lejeqëndrimi për punësim ose vetëpunësim. Në rast punësimi duhet të paraqisni dokumentat që provojnë ekzistencën e një marrëdhënie pune;

- në rasti vetëpunësimi, duhet të deshmoni dokumentacionin për punën që do të zhvilloni dhe disponueshmërinë e fondeve të kërkuara për të ushtruar atë.

Vini re: Ata që kryejnë shkollën e lartë (trevjeçare ose specializimin), doktoraturën ose një master të nivelit të dytë në Itali, ateherë kur skadon lejeqëndrimi për qëllime studimi mund të hyjnë ne listën e personave në kërkim për punë, për një periudhë jo me të gjatë se 12 muaj.

39. Duhet të verifikoj gjithmonë ekzistencën e kuotave në dispozicion për të bërë trasformin e lejeqëndrimit për motive studimi?

Jo, janë të përjashtuar nga verifikimi i kuotave, dhe për këtë arsye mund të dërgoje në çdo kohë kërkesën për trasformim në çdo moment të vitit, këta persona:

- shtetasit e huaj me banim të ligjshëm në territorin kombëtar kur mbushin 18 vjeç;
- shtetasit e huaj që kanë kryer në Itali studimet e skollës së lartë ose specializimin, pasi kanë frekuentuar kurse studimi në Itali.

Kualifikimet, në përfundim të të cilave, mund të kërkoni trasformimin janë:

- Diplomë (3 vjet, 180 kredite);
- Diplomë/Master (300 kredite, duke përfshirë 180 krediteve të diplomës universitare ose 180 kredi për shkallën e magjistraturës);
- Diplomë pasuniversitare (minimumi 2 vjet);
- PhD (minimumi 3 vjet);
- Master universitar i Nivelit të Pare e te Dytë (minimumi 60 kredite të kolegjit);
- Dëshmi perfundimi ose perfeksionimi (kohëzgjatje vjetore, 60 kredite).

40. Nëse kam lejeqëndrimi për punë sezonale, mund ta trasformoj në lejeqëndrimi për punësim të përkohshme apo të përhershme?

Punëtori i huaj i autorizuar të hyjnë në Itali për punë stinore, mund të konvertojë (nga hyrja e parë në Itali, në bazë të regullave të 5 nëntorit 2013) lejen e qëndrimit për punë stinore në një tjetër leje qëndrimi për punësim, të përkohshme ose të përhershme, në bazë të kuotave në dispozicion (për vitin 2014 Dekreti i datës 25 nëntor 2013 ka caktuar 4,000 numra për të tilla konvertime).

Në momentin e dorëzimit të aplikimit, lejeqëndrimi për punë sezonale duhet të jetë akoma i vlefshëm.

Punëtori i huaj duhet të dërgojë në Sportelin e Vetem për Imigracionin kërkesën për trasformimin e lejes nga punësim sezonal në punësim të vartur eskluzivisht në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit – në faqen web https://nullaostalavoro.interno.it .

Në rast të disponueshmërisë së kuotave, i huaj do të thëritet pranë Sportelit të vetëm për të nënshkruar kontratën e qëndrimit dhe formularin e aplikimit për lejeqëndrim për punësim.

41. A mund të përdor lejen time të qëndrimit për punë të varur, të pavartur dhe/ose familjare për aktivitete të tjera?

Po, edhe pa trasformim ose ndryshimin, për tërë periudhën e vlefshmërisë së lejes. Në kohën e ripërtëritjes ju mund të aplikoni për një lejeqëndrimi të ri që korrespondon me aktivitetin e kryer në fakt.

Në përgjithësi, në mënyrë që të punojë në Itali, i huaji duhet të jetë në zotërim të një lejeqëndrimi që i mundëson të punojë, ose të lëshuar për njëren nga arsyet e mëposhtme: *"affidamento"* (kujdestari), pa shtetësi, azil kërkuesit, azili politik, asistenca fëmijë, aktivitete sportive, kartë leje për anëtarët e familjes së një qytetari të BE-së, kartë e qëndrimit të përhershëm për anëtarët e familjeve së shtetasve të BE-së, motive familjare, familja e minorenit, integracion të minorenëve, punë sezonale, punë artistike, vetë-punësim, punësim, punësim i vartur, punësim sezonale edhe shumëvjeçare, raste të veçanta, lejeqëndrimit BE për rezidentët afatgjatë, mbrojtje të përkohshme, hulumtime shkencore, studim, arsye humanitare dhe punë pushime.

Nuk mund të punojë në Itali, i huaj i cili ka një lejeqëndrimi për: kurime mjekësore, turizëm, motive fetare, moshë minore, biznes, drejtësi, në pritje të nënshtetësisë. Për detaje të mëtejshme shih listën e **lejeve të qëndrimit që mundësojnë punësimin** në faqen web Integrimi i Emigrantëve (http://www.integrazionemigranti.gov.it/Pagine/default.aspx).

Vini Re: Leja e qëndrimit për azil, si rregull nuk lejon punësimin në pritje njohjes së statusit, por në qoftë se vendimi për kërkesën për azil nuk është marrë brenda gjashtë muajve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe vonesa nuk është ei lidhur drejtpërdrejt me aplikuesin, personit i lëshohet një leje qëndrimi për azilkërkues prej gjashtë muajsh, që mund të rinovohet edhe për gjashtë muaj të tjerë, dhe në këtë rast, mund të punoni deri kur procedura të përfundojë.

42. Çfarë mund të bëj nëse me rrefuzojnë ose heqin lejeqendrimin?

Brënda 60 ditëve nga botimi zyrtar të dekretit, mund të apeloni tek TAR (Gjykata Administrative Rajonale) përgjegjëse për policinë qe e ka lëshuar atë, në qoftë se revokimi ose mohimi i lejes ka të bëjë me motive pune.

Nëse është mohuar ose të tërhiqet për arsye familjare, mund të paraqisni një ankim përpara gjykatës së zakonshme brenda 60 ditëve nga data e njoftimit.

43. Cilat janë të drejtat e mia nëse kam lejeqëndrimi?

- mund të regjistroheni në Qendrat për punë dhe të krijoni skedën tuaj profesionale;
- mund të rregjistroheni në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar;
- mund të rregulloni pozicionin tuaj me INPS-in (Instituti Kombëtar për Sigurimet Sociale);
- mund të rregulloni pozicionin tuaj me INAIL-in (Instituti Kombëtar i Aksidenteve në Punë);
- mund të aplikoni për regjistrim në komunën e vendbanimit;
- mund të aplikoni për hyrjen në shkollën te fëmijëve;
- mund ti bashkohesh dhe/ose mund të krijosh një shoqate;
- mund të rregistrohesh në një sindikat.

44. Cilat janë detyrimit që kam si mbajtës i lejeqëndrimit?

Keni per detyrim t'u tregoni lejqëndrimin tuaj sëbashku me pashaportën ose një dokument tjetër identifikimi në rastet e mëposhtme:

- punonjësve të administratës publike, nëse keni nevojë për licenca, autorizime, rregjistrime, etj.
- me kërkesën e oficerëve dhe zyrtarëve të sigurisë publike, në qoftë se nuk e bëni, dënoheni me burgim deri në një vit dhe me një gjobë deri në 2,000 €. Autoritetet e sigurisë publike, kur kanë një arsye të vlefshme, mund t'ju kërkojnë informacione dhe prova mbi të ardhurat tuaja (nga puna ose nga burime të tjera të ligjshme), të mjaftueshme për të mbështetur veten dhe familjen tuaj në Itali.

Ju jeni të detyruar gjithashtu të njoftoni shefin përgjegjës për territorin për ndryshimin e zakonshëm të rezidencës tuaj brënda pesëmbëdhjetë ditëve pas ndryshimit te vëndbanimit. Komunikimi mund të kryhet edhe me anë të deklaratës së mikpritjes dhe/ose shitjes së një ndërtese në rastet dhe në mënyrat e parashikuara me ligj.

45. Nëse humbas punën humbas edhe lejeqëndrimin?

Jo, kur punëtori i huaj humbet punën, punëdhënësi duhet të njoftojë Zyrën e Emigracionit dhe Qëndrën për Punësim përgjegjëse brënda pesë ditëve nga data e pushimit nga puna. Qëndra për punësim bën rregjistrimin e punëtorit pa punë ose ripërtrin statusin e tij në skedën që ka hapur paraprakisht. Punëtori mbetet i regjistruar në kete listë për periudhën e mbetur të vlefshmërisë së lejeqëndrimit dhe, gjithsesi, me përjashtim të punonjësve sezonalë, për një periudhë të përgjithshme jo më pak se 1 vit.

46. Çfarë ndodh nëse qëndroj në Itali pa lejeqëndrimi ose me lejeqëndrimi të skaduar?
Kryen një vepër penale dhe dënohesh me gjobë prej 5.000 deri 10.000 €.

3.2 Marrëveshja për integrim

47. Çfarë është marrëveshja për integrim?
Nga data 10 mars 2012, me hyrjen në fuqi të rregullores se marrëveshjes për integrim, të huajt mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç që hyjnë në Itali për herë të parë dhe paraqjesin kërkesë për lëshimin e lejeqëndrimit për jo më pak një vit duhet të nënshkruajnë një marrëveshje me Shtetin italian.
Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje, i huaji duhet të arrijë qëllime specifike të integrimit në periudhën e vlefshmërisë së lejeqëndrimit. Nga ana e tij Shteti mbështet proçesin e integrimit të të huajve nëpërmjet iniciative të përshtatshme në bashkëpunim me rajonet dhe autoritet lokale.

48. Kush duhet të nënshkruajë marrëveshjen?
Marrëveshja për integrim u drejtohet të huajve mbi moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç që hyjnë në Itali për herë të parë dhe paraqhesin kërkese për lëshimin e lejeqëndrimit me kohëzgjatje jo më të shkurtër se një vit.
Nëse marrëveshja ka si pjesë një të mitur, midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeç, atëherë duhet nënshkruar edhe nga prindërit ose personat që ushtrojnë autoritetin prindëror e që banojnë ligjërisht në territorin kombëtar.

49. Kush nuk duhet të nënshkruajë marrëveshjen?
a) Shtetasit e huaj që vuajnë nga sëmundje ose me paaftësi të tilla që kufizojnë qëndrueshmërinë ose përbëjnë vështirësi serioze në mësimin e gjuhës dhe kulturës. Ky fakt duhet të vërtetohet me anë të një çertifikate të lëshuar nga një institucion shëndetësor publik apo një mjek i njohur nga Shërbimin Shëndetësor Kombëtar.
b) të miturit e pashoqëruar, që i janë besuar, sipas nenit nr. 2 të ligjit të datës 4 maj 1983, nr. 184, e modifikime të mëvonshme, ose nën mbrojtje, për të cilët marrëveshja është zëvendësuar me përfundimin e projektit të integrimit social dhe civil të përmendur në nenin nr. 32, paragrafi 1-bis të Teksit të Vetëm;
c) viktimat e trafikimit të personave, dhunës apo shfrytëzimit, për të cilët marrëveshja është zëvendësuar me programin e asistencës sociale dhe të integrimit përmendur në nenin nr. 18 të Tekstit të Vetëm mbi Imigracionin.

50. Ku nënshkruhet marrëveshja?
Pranë Sportelit të Vetëm për Imigracioni në Prefekturë, në rastet kur i huaji hyn në territorin kombëtar për punë ose ribashkimit familjar, ose në selinë e policisë në rast hyrje për arsye të tjera.
Marrëveshja nënshkruhet në të njëjtin moment kur bëhet kërkesa për lejeqëndrim me kohëzgjatje jo më pak se një vit. Në momentin e nënshkrimit, marrëveshja hartohet në dy kopje njëra prej të cilave i dorëzohet të huajit në gjuhën e treguar nga ai. Për Shtetin, marrëveshja nënshkruhet nga Prefekti ose i deleguari i tij.

51. Sa kredite i jepen qytetarit të huaj fillimisht?

Me nënshkrimin e marrëveshjes, fillimisht jepen 16 kredi. Konfirmimi i këtyre 16 krediteve bëhët pasi i huaji ka ndjekur një sesion pa pagesë reth edukimit qytetar në lidhje me jetën në Itali që mbahet pranë Sportelit të Vetëm Imigracioni në Prefekturë. Në këtë rast mund të merrni edhe informacion mbi "iniciativat për të mbështetur proçesin e integrimit" (të tilla si kurse falas italishtje) aktive në zonën ku jetoni. Nëse nuk ndjekni këtë kurs formimi do të humbisni 15 prej 16 krediteve të përcaktuara.

52. Sa kredi duhet të mbledh dhe brënda çfarë afati?

Marrëveshja parashikon që brenda dy vitesh i huaji të mbledhë 30 kredi. Kredite mund të arrihen përmes përvetësimit të njohurive të caktuara (gjuha italiane, kultura qytetare dhe jeta qytetare në Itali) dhe pjesëmarrja në aktivite si përshëmbull:

- kurse të gjuhës italiane
- trajnime profesionale
- kualifikime
- kurse trajnimi edhe në vendin e origjinës
- regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar dhe zgjedhja e mjekut të kujdesit parësor
- realizimi i një kontrate qiraje ose çertifikate kredie për të blerë shtëpi
- kryerja e aktiviteteve ekonomike, etj. **Shih Tabelën** për listën e plotë të aktiviteteve që lejojnë perfitimin e kredive.

53. A mund të humben kreditet e fituara?

Kreditë e fituara mund të humben në rastet e mëposhtme:

a) gjykime penale dënimi;
b) aplikimi, edhe pse jo përfundimtar, i masave të sigurisë personale;
c) imponim përfundimtar i ndëshkimeve finanziare për jo më pak se 10 mijë €, në lidhje me shkeljet tatimore e administrative.

Shih **Tabelën** për një listë të të gjitha rasteve që mund të çojnë në humbjen e kredive.

54. Kur verifikohet marrëveshja?

Një muaj para skadimit të marrëveshjes, Sporteli i Vetëm fillon procedurën e verifikimit dhe ja komunikon atë shtetasit të huaj. Brenda 15 ditëve nga njoftimi duhet të dorëzohet, në qoftë se nuk eshte bërë akoma, dokumentacioni i nevojshëm për të marrë njohjen e kredive, duke përfshirë vërtetimin që dëshmon kryerjen e detyrimeve shkollore për fëmijët e mitur dhe detyrimet që lidhen me njohurinë e gjuhës italiane të paktën në nivelin A2.

Në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm, i huaji mund të mbështesë, pa pagesë, një provë verifikimi reth njohurive të gjuhës italiane, kultures qytetare dhe jetës qytetare në Itali. Testimi organizohet nga Sporteli i Vetëm.

55. Çfarë nënkuptohet me njohuri të gjuhës italiane në nivel A2? Si mund të arrihet çertifikimi?

Niveli minimal i njohurisë gjyhesorë, që kërkohet nga marrëveshja për integrimi, është niveli A2 sipas Kuadrit të përbashkët europian të referencës për njohjen e gjuhës të miratuar nga Këshilli i Evropës. **A2 – Është një nivel bazë i njohurive gjuhësore për të komunikuar në aktivitete që kërkojn**ë një shkëmbim të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të informacionit mbi çështje të njohura dhe rutinore, përshkrim me terma të thjeshta të aspekteve të jetës dhe mjedisit përreth.

Njohja e gjuhës italiane në nivel A2 mund të provohet në disa mënyra:

- Me çertifikate të nivelit A2 te lëshuar nga një prej katër organizmave të njohura nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit, Universitetit dhe Kërkimive (Universiteti për të Huajt i Perugias, Universiteti për të Huajt i Sienës, Universiteti i Studimeve Roma Tre, Shoqata Dante Alighieri);
- me posedimin e një kualifikimi të marrë në Itali (çertifikat e shkollës së mesme, diplomë mature, diplomë universitare);
- prova se frekuentoni një kurs studimi në një universitet italian, shtetërore ose privat që njihet ligjërisht, doktoraturën ose masterin;
- duke frekuentuar ose duke treguar pjesëmarrjen në një kurs italishtje në një qendër të përhershme territoriale (CTP), në fund të së cilit lëshohet një titull që vërteton njohurinë e gjuhës italiane në një nivel jo më të ulët se A2 të QCER.

Në mungesë së çertifikiates së njohjes së gjuhës italine, mund të beni provimin e gjuhës pranë një CTP.

56. Çfarë është CTP?

Qëndrat Territoriale të Përhershme për Edukim dhe Formim në moshë te rritur (CTP) janë institucione publike, në të cilat veprojnë mësuesit e shkollave te Shtetit, e sipas rastit bashkëpunojnë edhe ekspertë të jashtëm, për të ofruar aktivitete kulturore, arsimore dhe trajnim për të rriturit.

Kurset e gjuhës italiane pranë Qëndrave Territoriale italiane të Përhershme (CTP) përfshijnë edhe elemente të edukimit qytetar në lidhje me të drejtat dhe detyrat e qytetarëve.

Mund të regjistrohen në një kurs të CTP të gjithë shtetasit e huaj që kanë mbushur 16 vjeç. Në fund të kursit mund të merrni vërtetimin e njohjes së gjuhës italiane.

Kurset e organizuara nga CTP janë falas.

57. Si verifikohet marrëveshja për integrimit?

Verifikimi përfundon me dhënien e krediteve finale dhe me një prej vendimeve të mëposhtme:

a) mbi 30 kredi dhe niveli A2 të njohjes së gjuhës italiane (të folur) e njohuri të kulturës qytetare dhe jetës qytetare në Itali: ndërprerje e marrëveshjes për përmbushje të saj. Nësë kreditë janë të barabartë me ose më të larta se 40 ju njihen çmime për aktivitete të veçanta kulturore dhe arsimore.
b) kredi finale mbi zero por më pak se 30 (nëse nuk janë përmbushur detyrimet rreth gjuhës italiane të folur, kulturës e jetës qytetare në Itali), atëhere deklarohet zgjatja e marrëveshjes për një vit me të njëjtat kushte. Verifikimi do të bëhet një muaj para mbarimit të vitit. Nëse marrëveshja nuk është përmbushur akoma, Prefekti dekreton mosrealizimin e pjesshem e autoritetet kompetente mbajnë në konsiderate këtë vendim për të marrë masa diskrecionale mbi imigracionin.
c) kredi finale të barabarta ose më pak se zero, dekretohet zgjidhja e marrëveshjes për mospërmbushje, me tërheqjen e lejeqëndrimit, ose refuzimin e ripërtritjes ose ekspulsionin e të huajit nga territori kombëtar. Nëse i huaji nuk mund të dëbohet, mbahet në konsiderate këtë mospërmbushja për të marrë masa diskrecionale mbi imigracionin.

Nëse Sporteli i vetem verteton mospjesëmarrjen në kurset e trajnimit dhe të informimit qytetar, bën zbritjen e pesëmbëdhjetë kredive. Mospërmbushja e detyrimit të arsimimit të fëmijëve minorene çon në humbjen totale të krediteve të dhënë fillimisht dhe ato të marra pas, deri zgjidhjen e Marrëveshjes për shkelje.

58. Cilët janë shtetasit e huaj të përjashtuara nga verifikimi i marrëveshjes?
Shtetasit e huaj të cilët kanë nënshkruar një marrëveshje për integrim, por që momentin e verifikimit kanë një nga llojet e mëposhtme të lejeve të qëndrimit: lejeqëndrim për azil, azil, mbrojtje të përkoshme, për shkaqe humanitare, për arsye familjare lejeqëndrimi për BE rezidentëve afatgjatë, lejeqëndrimi për anëtar të familjes të huaj e një shtetasi të Bashkimit Europian, si dhe të huajt që kanë lejeqëndrimi me një tjetër i cili ka ushtruar të drejtën e tij për bashkim familjar.
Në çdo rast, marrëveshja mund të pezullohet ose të zgjatet me kërkesën e të huajit, në prani të problemeve shëndetësore serioze, arsyeve familjare, arsyeve serioze punë, frekuentim kursesh trajnimi, përmirësime e orientimi profesional, studim jashtë vendit.

3.3 Lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë

59. Ç'është lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë?
Është një leje qëndrimi që autorizon qëndrimin me kohë të pacaktuar/përhershëm në Itali. Leja e qëndrimit KE për banorët afatgjatë përbën një dokument identifikimi personal për jo më shumë se 5 vjet nga data e lëshimit apo e rinovimit. Rinovimi bëhet në bazë të kërkesës nga personi në fjalë dhe duhet shoqëruar me fotografitë të azhiornuara.

60. Cilat janë kushtet që duhem plotesuar per te marrë lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë?
Lejeqëndrimit BE për rezidentët afatgjatë mund ti lëshohet të huajit që ka prej të paktën 5 vjetesh lejeqëndrim të vlefshme, me kusht që të dëshmoje se të ardhurat minimale vjetore nuk janë më të ulta se ndihma sociale (e barabartë me 5.818,93 € për vitin 2014) dhe njohjen e gjuhës italiane.

Vini Re: Periudhat e qëndrimit të kalura nga aplikanti me statusin ligjor të diplomatit ose ekuivalent, domethënë me leje qëndrimi afatshkurtër nuk duhen numëruar për të llogaritur vitet e posedimit, të paktën pesë vjet, të lejes së qëndrimit.
Mungesat e të huajit nga territori kombetar nuk ndërpresin periudhën prej 5 vjetësh posedimi, nga ana e tij, se lejes së qëndrimit dhe përfshihen në llogaritjen e të njëjtit, me kusht që te jenë më pak se 6 muaj rresht dhe jo më shumë se një total prej 10 muajsh brënda një periudhe pesëvjeçare, perjashtuar rastet kur ndërprerja varet nga nevoja për të përmbushur detyrimet ushtarake, motive serioze e të dokumentuar shëndetsore apo shkaqe të tjera serioze.

60 bis. Kur i kam kushtet për të kerkuar lejeqëndrimin Be për qëndrim afatgjatë, mund ta kërkoj edhe për familjarët e mi?
Leja e qëndrimit për banorët me afat të gjatë mund të kërkohet nga i huaji në zotërim të kushteve të mësipërme (Pytësori 57) edhe për një anëtar të familjes (bashkëshortin, fëmijë të varur, fëmijët të rritur në ngarkim, kur nuk janë në gjendje për të siguruar për nevojat e tyre themelore, prindërit në ngarkim që nuk kanë mbështetjen e duhur familjare në vendin e tyre). Në këtë rast, duhet të provoni, përveç të ardhurave të mjaftueshme në lidhje me përbërjen e familjes, edhe disponueshmërinë e një strehimi të përshtatshëm që i plotëson parametrat minimale të kërkuara nga ligji rajonal rreth banesave rezidenziale që duhet te kenë kualifikim igieni-shëndetsor nga ndërmarrja Shëndtsore lokale kompetente për territorin.

Vini Re: Për lëshimin e lejes së qëndrimit për banorët afatgjatë të KE-së për anëtarët e familjes së aplikantit, stacionet policore kërkojnë që edhe familjarët të jenë në posedim të kërkesës së qëndrimit pesë-vjeçare në Itali.
Mbi këtë pikë, megjithatë, tregojnë për një orientim të ndryshëm të ligjit, sipas të cilit kërkesa e jetesës për pesë vjet duhet të raportohet në të vetmin huajit tashmë rezident legalisht dhe jo edhe për familjen e tij (shiko. Gjykata e Apelit te Venezias, vendim i dates 9 shtator 2013)

61. Ku mund ta kërkoj?
Aplikimi duhet të dorëzohet në zyrat postare duke përdorur formularët në dispozicion. Fëmija i mitur duhet të jenë i shoqëruar nga njëri prej prindërve. Kërkesa mund të paraqitet edhe në nje komunë apo pranë sindikatave që ofrojnë këtë shërbim. (konsulto e zyrat e sindikatave në territorin kombëtar Portale Integrazione)

62. Sa kushton marrja e lejeqëndrimit BE për rezidentët afatgjatë?
Nga data 30 janar 2012 parashikohet pagimi i një kontributi prej 200,00 €. Shpenzimet të tjera të parashikuara jane;
- pagesa e 16 € *"marca da bollo"* që vendoset mbi aplikim;
- pagesa e 30 € për shpenzimet postare të zarfit, për dergimin e shpejtë të letrës;
- pagesa e 27,50 € për lëshimin e lejeqëndrimit në format elektronik.

63. Sa kohë zgjat lejeqëndrim BE për rezidentët afatgjatë?
Lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë nuk ka skandencë.
Është gjithashtu i vlefshmën si dokument identifikimi personal. Nëse doshironi ta përdorni si dokument identiteti duhet të ripërtrihet çdo 5 vjet.

64. Cilet janë dokumentat që duhen të paraqiten për të marrë lejeqëndrimin BE për rezidentët afatgjatë?
Kërkesa duhet të bëhet duke përdorur formularin në dispozicion në zyrën e postës. Në këtë kërkesë ju duhet të tregoni:
- të dhënat personale të plota;
- deklaratë per vendet e rezidencës ose vëndbanimit së 5 viteve të fundit;
- burimet e të ardhurave duke përfshirë edhe ato që vijnë nga njohja e pensionit për aftësi të kufizuara (duke përcaktuar shumën);
- çertifikatë nëse keni kaluar testin e nivelit A2 të gjuhën italiane ose përjashtimin;
- deklaratë mikpritje, ose qiraje ose blerjes së banesës;
- nr. 4 fotografi format pashaporte, të njëjta;
- lejeqëndrimit + fotokopje;
- pashaportë + fotokopje;
- një fotokopje e *kodit fiskal* ose vetëçertifikim;
- çertifikatë të amzës penale e të *"carichi pendenti"*;
- një kopje e deklaratës së të arshurave ose të *Cud*-it;
- çertifikatë të gjendjës familjare ose autoçertifikatë;
- nr. 1 *"marca da bollo"*.

Ndër te tjera:
Nëse jeni një punonjës i vartur:
- deklaratë nga punëdhënësi (me fotokopje të dokumentit të identifikimit), duke dëshmuar vazhdimin e marrëdhënies së punës;
- një kopje te rrogës se fundit;

- një kopje të dokumentacionit të punësimit;
- kopjet e pagesave të sigurimit social (për punëtorët shtëpiakë);
- deklaratën e të ardhurave.

Nëse ju jeni te vetë-punësuar:

- kopje të çertifikatës së regjistrimit në Dhomën e Tregtisë, Industrisë dhe Mjeshtëris, shënimet ose librat, dhe dokumentacioni origjinal vetëm për vision;
- origjinal në vizion dhe kopje të numrit të regjistrimit të TVSH-së.

65. Cilat janë dokumentat që duhen paraqitur për të marrë lejeqëndrimin BE për rezidentët afatgjatë për anëtarët e familjes?

Duhet të paraqisni për çdo anëtar të familjes, përveç dokumenteve të rënditura më sipër, provat përkatëse:

- fotokopje të lejeqëndrimit të familjarit;
- vetëçertifikim se çertifikate te statusit familjar që dëshmon përbërjen e familjes;
- disponueshmërinë e nje strehimi të përshtatshëm, siç dëshmohet nga çertifikatën e lëshuar nga autoritetet shëndetësore lokale përgjegjëse për territorin apo nga Bashkia;
- fotokopje të dokumentacionit që vërteton të ardhurat e tyre (nëse kanë) dhe të bashkëshortit qe ka lejeqendrimi të KE.

66. Çfarë niveli të gjuhës italiane duhet për t'u kualifikuar për lejeqëndrimin BE për rezidentët afatgjatë?

Nga data 9 dhjetor 2010 për të lehtësuar lëshimin e lejesqëndrimit BE afatgjatë, i huaji rezident duhet të demonstrojnë njohurinë e gjuhës italiane. Niveli minimal i njohjes së gjuhës italiane është niveli A2 sipas kuadrit të përbashkët europian të referencës për njohjen e gjuhës, miratuar nga Këshilli i Evropës. Bëhet fjalë për një nivel elementar që nevoitet për të komunikuar në aktivitete që kërkojnë një shkëmbim të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë të informacione e mbi çështje të njohura dhe rutinore, si edhe per përshkrimin në fjalë të thjeshta te aspekte të jetës dhe mjedisit përreth**.**

Njohja e gjuhës italiane në nivel A2 mund të vërtetohet në disa mënyra:

- me çertifikate të nivelit A2 te lëshuar nga një prej katër organizmave çertifikues te njohura nga Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit, Universitetit dhe Kërkimive (Universiteti për të Huajt i Perugias, Universiteti për të Huajt i Sienës, Universiteti i Studimeve Roma Tre, Shoqata Dante Alighieri);
- me anë te një kualifikimi të marre në Itali (çertifikat e shkollës së mesme, diplomë mature, diplomë universitare);
- vërtetim se ndjekni: një kurs studimi në një universitet italian, shtetëror ose privat që njihet ligjërisht, doktoraturën ose masterin;
- duke frekuentuar ose duke treguar pjesëmarrjen në një kurs italishtje në një qendër të përhershme territoriale (CTP), në fund të së cilit lëshohet një titull që vërteton njohurinë e gjuhës italiane në një nivel jo më të ulët se A2 e QCER.
- niveli A2 të gjuhës italiane në kontekstin e krediteve të fituara për marrëveshjen për integrimit;
- konfirmimi se hyrja në Itali dhe është zhvilluar në pajtim me nenin nr. 27 të imigracionit për të kryer aktivitetet e mëposhtme: menaxher ose personel i kualifikuar, profesor universiteti, përkthyes, gazetar apo punonjës i shtypit;
- kalimin e testit të njohjës së gjuhës italiane në nivel A2.

67. Njoh italishten, por unë nuk kam një çertifikatë që e vërteton, si mund te provoj aftësitë e mia gjuhësore?

Në mungesë të një çertifikate që provon njohjen e gjuhës italiane, për të marrë një lejeqendrimi BE afatgjatë duhet bëre testi i gjuhes pranë një CTP.

Për të aplikuar për pjesëmarrje në testin e njohjes së gjuhës italiane duhet të regjistroheni në faqen https://nullaostalavoro.interno.it/Ministero/index2.jsp në seksionin "zonë e rezervuar". Regjistrimi është i lirë por kërkohet një adresë e vlefshme e-mail për ty kryer. Nëse keni nevoje për ndihmë për paraqitjen e aplikimit mund të kontaktoni një patronazh, pranë sindikatave.

A është e mundur të merret lejeqëndrimi BE për rezidentëve afatgjatë, pa pasur nevojë për të provuar aftësitë gjuhësore?

Jo, nga data 9 dhjetor 2010 për të marrë këtë lejeqëndrimi është e nevojshme verifikimi njohurise së gjuhës italiane. Të vetmet përjashtime janë të lejuara, nëse BE kerkohet për:

- fëmijët nën 14 vjet;
- për persona që vuajnë nga kufizime të rënda kapaciteti për mësimin e gjuhës, ky verifikim duhet bërë nga një strukture shëndetësore.

68. Çfarë të drejtash kam si mbajtës i lejeqëndrimit BE për rezidentët afatgjatë?

Leja e qëndrimit BE për rezidentët afatgjatë nuk ka skadencë. Si mbajtës i lejes ju njihet një status i veçantë ligjor, i cili garanton më shumë të drejta se lejeqëndrimi që u lëshohet qytetarve të tjerë shtetas jo të BE-së, përkatësisht:

- mund të hyni dhe të dilni nga Italia pa vizë;
- mund të kyeni çdo lloj veprimtarie të ligjshme, që nuk është e ndaluar shprehimisht të huajve apo që është e rezervuar për qytetarët italianë. Për të kryer punë të vartur nuk është e nevojshme firmosja e lejeqëndrimit;
- mund të qëndroni, për studime ose punë, në një shtet tjetër Shengen, për një periudhë që tejkalon 90 ditë, në përputhje me rregullat në fuqi në Shtetin tjetër anëtar. Është e nevojshme, për këtë arsye, të kontaktoni përfaqësinë diplomatike apo konsullore të vendit në të cilin keni ndërmend të shkoni për të verifikuar kushtet e kërkuara.
- mund të marrin pjesë në konkurse publike, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me postet që përfshijnë ushtrimin direkt ose indirekt të autoritetit publik, ose kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesit kombëtar (p.sh. magjistratët, ushtarake);
- keni të drejtë të merrni ndihmë financiare për invalidët civil (duke përfshirë të miturit të cilët janë të regjistruar në lejeqëndrimin BE për rezidentëve afatgjatë të prindërit);
- mund të merrni kompensimin për shtatzaninë dhe kompensim për familje të madhe;
- mund të merrni përfitime sociale nëse keni banuar ligjërisht në mënyrë të vazhdueshme për të paktën dhjetë vjet në territorin kombëtar;

Mund të dëbohet vetëm:

- për motive të rënda të rendit publik ose sigurisë kombëtare, si dhe në kuadrin e luftës kundër terrorizmit ndërkombëtar;
- në rast se aplikohen kundër tyre masat mbojtëse.

69. Mund të me refuzojnë ose tërheqin lejeqëndrimin BE për rezidentët afatgjatë?

Refuzohet lejeqëndrimi BE për rezident afatgjatë nëse kërkuesi ka qenë i dënuar për njërën nga veprat penale të parashikuara në nenin nr. 380 të Kodit të Procedurës Penale e përsa u përket krimeve me qëllim, neni nr. 381, dhe nëse është dhënë dënim (edhe jo përfundimtare) për të cilin nuk është kërkuar rehabilitimi. Lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë mund të refuzohet në qoftë se jeni larguar nga Italia për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se gjashtë muajsh ose për një total prej 10 muajsh gjatë pesë viteve të fundit për të cilët bëni kërkesë (përjashtuar rastet kur ndërprerja varet nga nevoja për të përmbushur shërbimin ushtarak ose per arsye të rënda); gjithashtu mund të refuzohet për arsye të rendit publik dhe sigurisë shtetërore.
Kuestori ka fuqi revokimi nëse keni një dënim, edhe pse jo definitiv, por nëse rehabilitoheni, atëherë mund ta merrni përsëri.
Mund të revokohet në rast se largoheni nga Bashkimin Europian për një periudhë që tejkalon 12 muaj ose për shkaqe të rendit publik dhe të sigurisë shtetërore.
Në marrjen e vendimit për të tërhequr lejeqëndrimin duhet marrë parasysh mosha e personit në fjalë, periudha e qëndrimit në territorin kombëtar, ekzistenca e familjes dhe lidhjeve shoqërore brenda territorit kombëtar dhe mungesa e lidhjeve të tilla me vendin e origjinës.

70. Çfarë mund të bëj në qoftë se me refuzojnë ose me tërheqin lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë?
Mund të apeloni pranë TAR-it (Gjykata Administrative Rajonale) autoriteti kompetent.

71. Jam në zotërim të një lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë të lëshuara nga një shtet tjetër i BE-së, mund të qëndroj me këtë leje në Itali?
Nëse keni lejeqëndrimi për rezidentët afatgjatë të marrë në një shtet tjetër të Bashkimit mund të hyni në Itali pa vizë dhe të qëndroni për një periudhë që tejkalon tre muaj, për keto motive:
- punë te varur ose vetëpunësim, në bazë të kushteve të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar;
- kurse studimi ose trajnimi profesional;
- qëndrim për qëllime te tjera, me kusht vërtetimin e disponibilitetit të burimeve ekonomike të barabarta me të paktën dy herë minimumin e kërkuar nga ligji për përjashtimin nga pjesëmarrja në shpenzimet shëndetësore dhe sigurimin shëndetësor (rreth 8.500 €).

Brënda tre muajve pas mbërritjes në Itali duhet të aplikoni për lejeqëndrimi dhe në rast qëndrimi për arsye pune duhet te kerkoni autorizim për të punuar.
Këto autorizime lëshohen edhe nëse jeni në Itali si pjesë e kuotave të veçanta të përcaktuara nga dekreti i pervjetshëm që programon flukset për arsye biznesi.
Për qëndrime më të shkurtëra se tre muaj, është e mjaftueshme që i huaji të paraqesë deklaratën pranë Kuestorit, të ngjashme për të huajt të cilët kane leje të tjera te lëshuara nga një vend tjetër i BE-së.

72. Jam i martuar me një të huaj që ka lejeqendrimi BE për rezidentët afatgjatë të përfituara në një shtet tjetër të Bashkimit, mund të hyj dhe të qëndrojë në Itali me bashkshortin/en tim/e?
Po, edhe familja e personit me lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë mund të hyje në territorin kombëtar pa nevojë për të aplikuar për vizë dhe i njejti mund të aplikoje për qëndrim për motive familjare, nëse ai ka banuar mëperparë, mbi këtë bazë, në Shtetin Anëtar, me kusht që të plotesoje kërkesat që ligji parashikon për bashkimin familjar.

3.4 Zona Schengen

73. Ç'është zona Schengen?

Zona Schengen është zona e përbashkët që lejon lëvizjen të lirë për qytetarëve e të Shteteve anëtare. Të gjitha vendet e zonës Schengen (Austria, Belgjika, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Islanda, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Hollanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Republika Çeke, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Zvicra dhe Hungaria) kanë eliminuar kontrollet në kufijtë e tyre të përbashkët dhe kanë krijuar një sistem të unifikuar të vizave dhe të hyrjeve.

74. Cilat janë kushtet për të qarkulluar brënda zonës Shengen?

Nëse jeni i huaj dhe keni pashaportë e lejeqëndrimi të vlefshme në Itali, mund të lëvizni lirisht dhe të kaloni një periudhë maksimale prej tre muajsh në një nga vëndet në listën e mësipërme. Gjatë kësaj kohe ju nuk mund të punoni, dhe kur kalojne këta tre muaj, duhet të riktheheni në Itali.

Në qoftë se keni lejeqëndrimi BE për rezidentët afatgjatë, mund të lëvizni dhe jetoni në vendet e Zonës Shengen që kanë implementuar direktivat e BE-së mbi rezidentët afatgjatë për periudha më të gjata se 90 ditë, për:

- punë (i punësuar ose i vetëpunësuar);
- studimin dhe trajnimit profesional;
- rezidencë (duke përmbushur disa kërkesa).

Vini Re: Letërnjoftimi i lëshuar nga Bashkia ku banonini nuk është i vlefshme për të udhëtuar jashtë vendit prandaj, për të qarkulluar në zonën Shengen duhet pashaporta, përndryshe rrezikoni dëbimin**.**

75. Pres ripërtritjen e lejeqëndrimit: Mund të transitoj nëpër një shtet Shengen?

Nëse lejeqëndrimit juaj është në procesin e ripërtritje ju lejohet të dilni dhe të hyni në territorin kombetar pa vizë, por udhëtimi nuk duhet të përfshijë kalimin tranzit (edhe për një ndalese të avionit) në vende të tjera që bëjne pjesë në marrëveshjet e Shengenit. Duhet gjithashtu të tregoni dokumentet e mëposhtme:

- pashaportë ose dokument tjetër ekuivalent identifikimi i vlefshëm për të largim nga vendi;
- origjinal ose kopje te lejeqëndrimit të vjetër;
- origjinal ose kopje te aplikimit për ripërtëritjen e lejeqëndrimit.

Dalje dhe rihyrja mund të të kryhen vetëm përmes pikave të kalimit të kufirit të jashtëm, edhe të ndryshme nga njëra-tjetra.

76. Jam duke pritur lëshimin e lejes së parë të qëndrimit: mund të transitoj nepër një shtet Shengen?

Nëse jeni duke pritur lëshimin e lejes së parë të qëndrimit për motive punë e familjare, nuk mund të dilni dhe të hyni në Itali duke kaluar nëpër një vend të zonës Shengen. Dalje e ri-hyrje janë të mundshme vetëm duke kaluar në pikat kufitare të jashtme, edhe të ndryshme, por duke treguar dokumentacionin e mëposhtëm:

- pashaportë ose dokument ekuivalent udhëtimi;
- vizë nga e cila kuptohet arsyeja e qëndrimit
- *"ricevuta"* që dëshmon për paraqitjen e kërkesës per lëshimin e lejeqëndrimit.

4 Puna

4.1 Puna në Itali

*Raporti i punës në Itali mund të jetë tre llojesh**:***
- *punë e vartur me kohë të pacaktuar, të caktuar, ose sezonale;*
- *punë pjesërisht e vartur (psh. kontrate me projekt);*
- *punë e pavartur**.***

Punëtori, i cili punon në shërbim të një punëdhënësi, ka të drejtë të shpërblehet; shpërblimi duhet të kryhet në bazë të sasisë dhe cilësisë së punës. Shpërblimi duhet të jetë i mjaftueshëm që punëtori dhe familja e tij të jetojnë në mënyrë dinjitoze dhe të lirë.
Nivelet bazë të shpërblimit për punë të varur janë të përcaktuara në kontratat kolektive të punës (në nivel kombëtar, rajonal, provincial) të cilat duhen respektuar në çdo rast. Punëdhënësi garanton respektimin e sa më sipër në momentin e kërkesës së dokumentave me qëllim hyrjen dhe qëndrimin në Itali të punëtorit. Pjesa më e madhe e të drejtave të punëtorit, në kuadrin e raportit të punës, parashikohet pikërisht nga kontratat kolektive të punës të cilat i aplikohen punëdhënësit pranë të cilit jeni punësuar.

4.1.1 Puna e vartur

77. Çfarë është puna e vartur?
Është një raport pune, i rregulluar nga një kontratë, në bazë të së cilës punëtori angazhohet të punojë për llogari të punëdhënësit dhe punëdhënësi angazhohet t`i shperblejë punën nëpërmjet pagës.

78. Çfarë është kontrata e qëndrimit për punë të vartur?
Është një kontratë e cila rregullon raportin e punës ndërmjet punëdhënësit dhe një punëtori jokomunitar. Në kontratën e qëndrimit për punë të vartur punëdhënësi garanton disponueshmërinë e një banese për punëtorin dhe pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për kthimin në atdhe të punëtorit ne rast *ekspulsioni*. Kontrata e qëndrimit nuk zëvendëson kontratën e punësimit, por është e detyrueshme të firmoset për lëshimin ose ripërtritjen e lejeqëndrimit për punësim.
Për nje marrëdhënie të re punësimi duhet nënshkruar një kontratë e re për pune përmes të cilit kostoja e strehimit dhe riatdhesimit eventual të transferohen te punëdhënësi i ri.

Në rastin e hyrjes së parë në Itali për punë, kontrata e qëndrimit duhet të firmoset domosdoshmërisht nga palët pranë Sportelit të Vetëm për Imigracionin brënda 8 ditësh nga dita e hyrjes së punëtorit në territorin e Shtetit. Nësë bëhët fjalë për krijimin e një marrëdhënie pune të re palët nënshkruajne kontratën e qëndrimit, direkt dhe në mënyre të pavartur, jashtë Sportelit të Vetem, duke theksuar angazhimet në lidhje me strehimin dhe koston e riatdhesimit në **modelin e unifikuar Lav** i detyrueshëm për njoftimin e punësimit, ose për punë shtëpiake, i duhet komunikuar Inps-it.

Vini Re: modeli i kontratës se lejeqëndrimit nuk është më në përdorim, pasi është përfshirë në modelin Unilav e, për punëtorët e shtëpiakë, është zëvëndësuar me komunikim që i bëhet Inps-it.

79. Çfarë limitesh ka puntërori i vartur?
Punonjësi i nënshtrohet direktivave, kontrollit dhe fuqise hirarkike të punëdhënësit, i cili vendos mënyrë e kryerjes së punës.

80. Çfarë pune mund të kryejë punëtori i vartur?
Puna mund të konsistoje në aktivitete të ndryshme. Detyrat dhe veprimet konkrete që punëtori kryen qjuhen *"mansioni"* dhe përcaktohen në kontratën e punës.

81. Sa kohë duhet të punojë punëtori?
Orari normal i punës është fiksuar në 40 orë në javë, gjithmonë sipas kontratave kolektive të punës, në nivel kombëtar ose në varësi të sektorit; punëtori mund të punojë edhe jashtë orarit por gjithmonë sipas rregullave.

Punëtori ka të drejtë të pushojë 11 orë rrallazi çdo 24 orë. Ka poashtu të drjetë për një periudhë pushimi prej të paktën 24 orësh rallazi, zakonisht ditën e djelë, çdo shtatë ditë. Pushimet vjetore, të paguara, duhet të zgjasin të paktën katër javë dhe duhen kryer në çdo rast.

82. Ku punon punëtori?
Punëtori duhet të kryejë punën e tij në vendin e përcaktuar, nga të dyja palët, në kontratën e punës ose, në mungesë, në vendin ku puna duhet të zvidhohet. Punëtori nuk mund të transferohet nga një vend në një tjetër përveçse për motive konkrete teknike, organizative dhe prodhuese.

83. Përveç aktivitetit të punës çfarë i kërkohet tjetër punëtorit të vartur?
Punëtori i vartur duhet të jetë i vëmendshëm, të ndjek rregullat disiplinore që lidhen me kryerjen e punës, e janë vendosur nga punëdhënësi dhe bashkëpunëtorët e tij, si edhe të sillet ndershmërisht ndaj punëdhënësit duke mos përhapur të dhëna sekrete dhe duke mos i bërë konkurencë atij.

84. Çfarë të drejtash patrimoniale gëzon punëtori i vartur?
- Të drejtën e shpërblimit, i cili mund të jetë në bazë të kohës (në bazë të orarit të punës), në bazë të sasisë (në bazë të rendimentit të punëtorit) ose të pjesëmarrjes në kapitalet e shoqërisë, etj.;
- Të drejtën e trajtimit në përfundim të raportit të punës;
- Të drejta në raste të veçanta.

85. Çfarë të drejtash personale gëzon punëtori i vartur?
- Të drejtën e integritetit fizik dhe të shëndetit (pushimin javor, ditor, pushimet vjetore, mbojten e shtatëzanise etj.);
- Lirinë e mendimit dhe mbrojtjen e jetës private dhe të dinjitetit;
- Të drejtën e studimit për punëtorët studentë;
- Të drejtën e aktiviteteve kulturore, argëtuese dhe shoqërore.

86. Çfarë të drejtash sindakale gëzon punëtori i vartur?

- Lirinë e organizimit dhe të aktiviteteve sindakale;
- Të drejtën e grevës;
- Të drejta të tjera sindakale (të drejtën e vendosjes së manifesteve, të shfrytëzimit të lokaleve të shoqërisë për zhvillimin e aktiviteteve sindakale, etj.).

87. Çfarë është sindikata?
Është një shoqatë punëtorësh që ka si synim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punëtorëve në vendin e punës dhe në shoqëri. Sindakatat mund të përfaqësojnë punëtorët të cilët janë rregjistruar në këto të fundit si edhe të firmosin kontrata kolektive të punës të cilat duhet të respektohen nga të gjithë pjesëtarët e kategorive të cilave i drejtohet kontrata.

88. Çfarë është puna me kohë të pacaktuar?
Është një marrëdhënie pune e vartur dhe e rregulluar nga një kontratë që nuk parashikon një skadencë kohore. Marrëdhenia mund të përfundojë në rast vdekjeje të punëtorit, kur të dy palët janë dakort, për dorëheqje të punëtorit ose për pushim nga puna për *"giusta causa"* ose motiv të vlefshëm nga ana e punëdhënësit.

89. Çfarë është puna me kohë të përcaktuar?
Është një kontratë pune e varur e cila ka një afat mbarimi. Hynë në këtë kategori edhe ato raporte pune që i dedikohen një aktiviteti specifik, të mirëpërcaktuar në përmbajtjen e tij, që ka të njëjtën kohezgjatje sa edhe koha e nevojshme për përfundimin e aktivitetit.

90. Çfarë është puna sezonale?
Është një formë punë e varur me kohë të përcaktuar dhe që kryhet vetëm në disa periudha të vitit (p.sh. puna në sektorin bujqësor apo në sektorin e turizmit dhe të hotelerisë). Ligji mbi imigracionin parashikon kushte të veçanta për punëtorët stinorë jokomunitarë të cilët dëshirojnë të hyjnë në Itali për punë stinore (p.sh.: kuota të veçanta për punën stinore, të drejtën e kalimit në rast se ke hyrë një herë në Itali për të njëjtin motiv, etj.).

91. A duhet të jetë domosdoshmërisht e shkruar kontrata e punës me kohë të përcaktuar?
Po, përfundimi i kontratës nuk ka efekt në rast se nuk është përcaktuar në kontratë në formë të shkruar.
Kopja e kontratës i duhet dhënë punonjësit brenda 5 ditëve nga fillimi i punës. Ajo duhet të përmbajë arsyet për të cilat punëdhënësi kërkon të punësojë me kohë të përcaktuar. Zakonisht përkufizimi i datës së fundimit të marrëdhënies së punës lejohet vetëm per arsye teknike, organizim të prodhimit, ose zëvendësim.
Reforma e tregut të punës (Ligji. 92/2012) parashikoh mundësinë që **kompania, herën e parë që lidh një kontratë** me afat të caktuar punësimi me një punonjës, mund të bëjë pa qënë e detyruar të tregoje arsyen. Kjo kontratë mund të zgjasë deri në 12 muaj, dhe nuk mund të zgjatet edhe në qoftë se koha e vendosur fillimisht është më shkurte se maksimumi.

Attenzione: Forma e shkruar nuk është e nevojshme, nëse kohëzgjatja e marrëdhënies së punës, thjesht e rastit, nuk i kalon 12 ditët.

92. Si formalizohet kontrata e punës?
Në momentin e punësimit, punëdhënësi duhet t'i dorëzojë punëtorit një deklaratën e regjistrimit në librin e matrikolave, të firmosur e me këto dhëna:
- të dhënat tuaja;
- vendin e punës;
- datën e fillimit të punës;
- kohëzgjatja e marrëdhënies së punës;
- kohëzgjatja e periudhës së provës, nëse parashikohet;
- profili profesional dhe niveli i inkuadrimit të punonjësit;
- kohëzgjatja e pushimeve;
- orari i punës;
- afati i paralajmërimit në rast mbarimi të parakohshëm të kontratës.

93. Cila është kohëzgjatja maksimale e kontratës me kohë të përcaktuar?
Përcaktimi i kohëzgjatjes së kontratës është i lirshëm.

94. Nëse kam një kontratë me kohë të përcaktuar, në punë mund të jem në disavantazh në krahasim punëtorët me kohë të papërcaktuar?
Për sa i përket parimit të diskriminimit, punëtorët e punësuar me kontratë me kohë të përcaktuar nuk duhet të trajtohen ndryshe nga të tjerët që bëjnë të njëjtën punë si ata. Keni të drejtën e pushimeve, e shpërblimit të Krishtlindjeve, të pagës së 13-të (dhe 14-të nëse parashikohet në kontratë) si edhe të trajtimit financiar në përfundim të punës, si edhe çdo lloj tjetër trajtimi që ndërmarrja u aplikon punëtorve me kohë të papërcaktuar.

95. Kontrata ime e punës është duke mbaruar, a mund të zgjatet?
Po, punëdhënësi mund të zgjasë kontratën e punës por zgjatja pranohet vetëm në rastet e mëposhtme:
- vetëm një herë;
- me miratimin e punonjësit;
- nëse fillimisht kohëzgjatja e kontratës është më e vogël se 3 vjet che me zgjatjen që bëhët nuk i kalon 3 vjetët;
- për të njëjtën aktivitet;
- nëse ka arsye objektive.

96. Kontrata ime e punës me kohë të përcaktuar ka përfunduar, por jam duke punuar akoma për të njëjtin punëdhënës. Është e paligjshme?
Jo, mund të ndodhë që edhe pas mbarimit të kontratës punonjësi të vazhdojë punën. Në këto raste të takon një rritje e pagës sipas përpjestimeve të mëposhtme**:**
- 20% më shumë për çdo ditë vazhdimi deri në ditën e 10-të;
- 40% për çdo ditë pas ditës së 10-të.
- vazhdimi mund të jetë 20-30 ditë për kontratat me kohëzgjatje më të vogël se 6 muaj dhe nga 30 *në 50 ditë për ato me kohëzgjatje më të gjatë.*

Përtej këtyre kufijve marrëdhënia e punës kthehet në mardhënie pune me kohë të papërcaktuar.

97. A mund të ripërtrihet kontrata e punës me kohë të përcaktuar?
Po, punonjësi mund të ripunësohet me një kontratë me kohë të përcaktuar, por sipas këtyre kushteve:
- së paku 60 ditë pas skadimit, nëse kontratë e parë kishte një kohëzgjatje prej 6 muajsh;
- së paku 90 ditë pas skadimit, nëse kontrata e pare kishte një kohëzgjatje prej më shumë se 6 muajsh.

Negocimi kolektiv kombëtar, dhe në emër të këtij të fundit, edhe ai i decentralizuar, mund të përcaktojnë një ritëm më të shpejtë, në prani të një proçesi të veçantë organizativ brënda kompanisë (start-up, prodhimi i një produkti të ri ose aktivitet i ri, fazë shtesë e një Projekti hulumtues etj.).

98. Cila është diferenca mes ripërtritjes dhe zgjatjes?
Në rastin e zgjatjes kontrata "e vjetër" zgjatet përtej kufirit të fiksuar në fillim; në rastin e ripërtritjes, punëdhënësi ripunëson punonjësin me një kontratë të re.

99. Punëdhënësi më ka rinovuar kontratën e punës me kohë të përcaktuar pa respektuar skadencat. Kontrata ime a është e vlefshme?
Po, por nëse punëdhënësi nuk i ka respektuar afatet e më sipërme, marrëdhënia e punës konsiderohet kontratë me kohëzgjatje të papërcaktuar.
Apeli jashtëgjyqësor me të cilin keni ndërmend të mbroni pavlefshmërinë e afatit duhet të bëhet brënda 120 ditëve pas përfundimit të kontratës, ndërsa ankesa pranët **Gjyqtarit të Punës** duhet të paraqitet brenda 180 ditëve të ardhshme.
Në rast të paligjshmërisë së kontratës me kohë të përcaktuar, kompensimi për dëmet, si dhe shndërrimin i marrëdhënies së punës në marrëdhënie pune me kohëzgjatje të papërcaktuar, është për t'u konsideruar të gjithëpërfshirëse i të gjitha dëmeve dhe humbjeve të pësuara nga punonjësi. Kompensimi varion nga 2,5-12 muaj rroge.

100. Punëdhënësi im mund t`a përfundojë para kohës kontratën?
Jo, punëdhënësi mund të ndërpresë raportin e punës vetëm për motive të rënda *"giusta causa"*.

101. Jam pushuar nga puna pa *"giusta causa"*. Çfarë mund të bëj?
Mund të kërkosh dëmshpërblim për dëmin, për një vlerë maksimale që varion nga 15 deri në 24 paga, pa kërkuar reintegrimin në vendin e punës në ndërmarrje.

102. A mund ta përfundoj para kohe marrëdhenien e punës?
Po, por beni kujdes dhe rrespektoni ditet e nojfimit te parashikuara nga kontrata. Jo, ashtu si edhe punëdhënësi, punonjësi nuk mund të ndërpresë raportin e punës para kohës. Në rast të kundërt, zbritet nga paga shuma e përcaktuar për mungesën e paralajmërimit.

TRAJNIMI FORMUES

103. Çfarë është trajnimi formues dhe përse shërben?
Trajnimi formues është një kontratë qe ka si synim lehtësim e hyrjes se të rinjve në tregun e punës. Mund të përkufizohet si një masë e politikës aktive që kërkon të orientojë drejt punës. Edhe pse nuk ka formën e një marrëdhënie pune, synon pasurimin e njohurive, të aftësive profesionale dhe hyrjen ose rihyrjen në tregun e punës të të rinjëve. Stazhet ndahen në "kurrikulare", ato stazhe që përfshihen brënda programit mësimor të universiteteve dhe shkollave, dhe "jo-kurrikulare". Për të rrealizuar një stazh është e nevojshme ekzistenca e një marrëveshje mes entit promotor (universitetet, shkollat e larta (publike dhe private), zyrat arsimore, agjencitë e punësimit, qëndrat publike të formimit profesional dhe/ose të orientimit, fondacionet, konsulentët e punës, komunitetet terapeutike dhe kooperativat sociale, shërbimet e caktimit të punës për njerëzit me aftësi të kufizuara, institucionet arsimore private jo-fitimprurëse) dhe subjektit mikpritës (kompani, firmë profesionale, kooperativë, organe publike, etj.), të shoqëruara nga një projekt arsimor të përpiluar nga punëdhënësi.

104. Cilat janë rregullat që duhet zbatur për trajnimet profesionale?
Trajnimeve formuese dhe atyre orientuese, që janë juridiksionin i Rajoneve, u aplikohen, nëse ka, rregullat rajonalë. Në mungesë të dispozitave të veçanta, zbatohet neni nr. 18 i ligjit të 24 qershor 1997 nr. 196 dhe rregullorja për zbatim (DM 25 mars 1998 nr. 142).
Me marrëveshjen e 24 janarit 2013 në Konferencën mes Shtetit dhe Rajoneve, janë dekretuar udhëzime për sa u përket trajnimeve. Këto udhëzime parashikojnë qe trajnimet formuese dhe udhëzuese tu destinohet personave të cilët kanë përfunduar studiment prej më shumë se 12 muajsh. Këtp udhezimet zbatohen nga Rajonet me ane ligjeve të tyre.

105. Cila është kohëzgjatja maksimale e trajnimit formues?
Disiplinimi i praktikës është përgjegjësi e Rajoneve dhe krahinave autonome në pajtim me neni nr. 117 të Kushtetutës. Rajonet mund të marrin vendime në mënyrë indipendente rreth kohëzgjatjes maksimale të trajnime formuese .
Në mungesë të rregullores rajonale, disiplimimi i trajnimeve bëhet në bazë të nenit nr. 18 të Ligjit nr. 196 të vitit 1997 dhe rregullores për zbatimi (Dekreti Ministror i 25 marsit 1998, nr. 142).
Duhet theksuar se për sa i përket kohëzgjatjes së trajnimit, udhëzimet e miratuara nga Marrëveshja mes Shtetit dhe Rajoneve me datë 24 janar 2013 parahikohet: për trajnimet e formimit një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, për stazhet e integrimit ose riintegrimit të punëtorit një maksimum prej 12 muajsh, për trajnimet që aktivizohen në favor të personave të disavantazhuar një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh, për stazhet në favor të personave me aftësi të kufizuara një maksimum kohëzgjatje prej 24 muajsh. Kohëzgjatja maksimale për llojet të ndryshme të trajnimeve përfshijn rizgjatjet.

106. Çfarë është stazhi i integrimi/riintegrimit në punë?
Stazhet e hyrjes ose rihyrjes në punë synojnë krijimin e shtigjeve të integrimit/ri-integrimit në tregun e punës dhe u destinohen kryesisht të papunëve, atyre që janë në *"mobilità"* dhe të papunëve. Ky lloj trajnimi/stazhi aktivizohet edhe në favor të punëtorëve të pezulluar në gjenden në *"cassa integrazione"*, mbi bazën e marrëveshjeve të veçanta në zbatimin e politikave aktive të tregut të punës për sigurimin e amortizatoreve të sigurisë sociale.
Stazhet hyrjes ose rikthimit në punë mund të aktivizohen edhe në favor të njerëzve me aftësi

të kufizuara, të pafavorizuar, në bazë të ligjit nr. 381/1991, si dhe për azil-kërkuesit dhe përfituesit e mbrojtjes ndërkombëtare.

107. Një i diplomuar prej më shumë se 12 muajsh mund të bëjë një stazh integrimi/riintegrimit në punë?
Po. Një i diplomuar prej më shumë se 12 muajsh mund të bëjë një stazh që parashikon integrimit/riintegrimit, por me kusht që te bëjë pjesë në një nga kategoritë në favor të të cilave mund të aktivizohen trajnimit/stazhet, në përputhje me dispozitat e tjera rajonale mbi këtë çështje.

108. Çfarë nënkuptohet me trajnimet/stazhet kurrikulare?
Me trajnim/stazh "kurrikulare" nënkuptohen ato trajnime/stazhe që ju japin të drejtën e perfitimeve të kreditë të parashikuara në kurrikulat e kurseve universitare, të instituteve shkollore në baze të rregullave. Konsiderohen gjithashtu si trajnime/stazhe kurrikulare ato stazhe që ofrohen brënda një kursi arsimor ose profesional, edhe pse nuk kanë si objektiv arritjen e kredive, atëherë kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
1) Promovimi i një stazhi si pjesë e një universiteti ose instituti të autorizuar të lëshojë diploma akademike, të një institucioni arsimor që ofron diploma me vlerë ligjore, një qendër trajnimi profesional që vepron sipas një marrëveshjeje me Rajonin ose Provincën ose që është i akredituar;
2) Përfituesit e iniciativës janë studentët universitar (duke përfshirë ato që janë të regjistruar në kurse universitare dhe të doktoraturës), studentë e shkollave të mesme e të shkollave profesionale dhe ata që jane të regjistruar në kurse trajnimi e studimi dhe brenda të cileve trajnimi/stazhi promovohet;
3) Kryerja e trajnimeve brenda periudhës së frekuentimit të kursit të studimit ose të kursit të formimit.

109. A mund të aktivizohen trajnime/stazhe në favor të shtetasve të huaj?
Duhet bërë një dallim mes:
1) Të huajve të cilët jetojne në Itali me lejeqëndrimi të rregullt që lejon punësimin, mund të zhvidhojne trajnime e stazhe sipas të njëjtave kushte si për qytetaret italianë.
2) Shtetasit e huaj që banojnë jashtë vendit dhe që dëshirojnë të hyjnë në Itali për të bërë një stash nuk kane nevoje të kërkojnë një autorizimi për të punuar, por është e nevojshme marrja e një vizë hyrjeje për studim ose trajnim që lëshohet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore në vendin ku i huaji banon, brënda kuotave të përcaktuara çdo vit (zakonisht rreth 5,000 kuota të ndara midis rajoneve të ndryshme). Hyrjet për trajnime e stazhe formimi edhe pse ndodhin jashtë kuotave vjetore të vendosura me anë të dekretit të flukseve, janë të mundshme vetëm brenda kuotave të caktuara çdo tre vjet me një dekret ndërministror.

110. Praktikantët kane të drejtë për rrogë?
Marrëveshja e nënshkruar më date 24 janar 2013 me anë të se ciles janë miratuar udhëzimet për trajnimet dhe stazhet, parashikon, për sa u përket stazheve ekstra-kurrikulare, një kompensimi prej jo më pak se 300,00 € në muaj për stazhistët, duke përjashtuar në çdo rast kompetencat e Rajoneve mbi këtë çështje, përjashtur rastet kur rajonet vendosin, në bazë të ligjeve rajonale, një shumë më të lartë.

111. Administratat publike janë të detyruara të paguajë kompensimin e duhur?
Për të përcaktuar nëse AP është e detyruar të paguajë kompensimin e duhur, duhet domosdoshmërisht ti referohemi legjislacionit rajonal:

a) nëse rajonet me ane të masave rregullatore kanë vendosur se duhen paguar stazhet, atëherë këto të fundit që zhvidhohen në selinë e AP-ke, pjesë e Rajonit përkatës, duhet paguar kompensimi.
b) Në të kundërt, nëse Rajoni në fjalë ende nuk ka një normative që disiplinon trajnimet dhe që e konsideron të detyrueshëm kompensimin, AP mund të vazhdojë të aktivizoje stazhe reja pa qëne e detyruar të paguajë kompensimin e duhur deri kur legjislacionit rajonal që përcakton këtë detyrim të vendose të kundërten.

4.1.2 Puna pjesërisht e vartur

112. Çfarë është puna pjesërisht e vartur?
Është një marrëdhënie pune për të cilen një bashkëpunëtor, kryen aktivitetin e tij në favor të një punëdhënësi (që e koordinon), në mënyrë autonome dhe pa kufizimet e punës së vartur. Me një kontrate të posaçme përcaktohen kushtet e punës dhe pagesa.
Kjo kontratë, e ashtuquajtur kontratë me projekt, duhet të ketë një kohëzgjatje të përcaktuar dhe duhet të përmbajë përshkrimin e hollësishëm të projektit, të cilin bashkëpunëtori angazhohet ta realizojë. Projekti duhet të synojne arritjen e një rezultati përfundimtar dhe nuk mund të konsistojnë në një përsëritje të thjeshtë të qëllimit social të ndërmarrjes, as detyrat nuk mund të jenë thjesht të përsëritura. Kontrata me projekt nuk parashikon një orar të ngurtë ose një numër të paracaktuar e orëve të punës, por zhvidhimin e projektit në kohë dhe mënyrën e specifikuar në momentit e lidhjes së kontratës.
Nëse aktivitetet e bashkëpunetorit jane të ngjashme me ato të kryera nga punonjësit e varur, përjashtuar një provë të kundërt të punëdhenësit, bashkëpunimi konsiderohet si një marrëdhënie pune e varur, që nga fillimi.

113. Çfarë lloj lejeqëndrimi të jepet nëse je një punonjës pjesërisht i vartur?
Një lejeqëndrimi për punë të pavartur.

Vini Re: Punëtorët e huaj që ende jetojnë jashtë vendit nuk mund të hyjnë në Itali për të motive punë në bazë të një kontrate me projekt. Dekretet e flukseve, në përcaktimin e kuotave të hyrjes për vetëpunësim, i reservojnë këto vënde për kategori të caktuara të punëtorve të pavartur, domethënë: punëdhënësve të cilët zvidhojne aktivitete me interes për ekonominë italiane, profesionistët e lirë që nuk mund të përfshihen në një kategori por që bëjnë pjesë në listat e AP-ke; figura profesionale koorporatave të kompanive jo-bashkëpunuese, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat në fuqi në lidhje me vizat hyrjes (per artistët me famë ndërkombëtare apo me kualifikimeve të larta profesionale, të punësuar nga autoritetet publike ose nga organet private).

4.1.3 Puna e pavartur

114. Çfarë është puna e pavartur?

Është një mardhenie punë, në bazë të së cilës një person angazhohet të kyej, në këmbin të një shpërblimi, një vepër ose një punë, me punën e vet, pa qënë i nënshtruar nga punëdhënësi. Vetëpunësimi mund të ushtrohet me ose pa TVSH.

115. Çfarë kufizimesh kanë të vetëpunësuarit?

Punëtori i pavartur menaxhon në mënyre indipendente biznesin e tij, duke gëzuar liri të plotë në lidhje me përdorimin e kohës, vendit dhe mënyrës së organizimit të së njëjtës (natyrisht brënda limiteve të vendosura nga kontrata ose nga natyra e punës).

116. Cilat janë formalitetet të parashikuara nga ligji që duhen kryer për të filluar një aktivitet të pavartur?

Për të filluar një aktivitet të çdo lloji, dhe për punën e pavavarur, ligji parashikon një sërë detyrimesh:

- duhet zgjedhur **Kodi i Aktivitetit**: në varësi të llojit të aktivitetit që keni ndërmend të ushtroni duhet të zgjidhni kodin e përcaktuar me rregullore. Nëse veprimtaria nuk është përshkruar në ndonjë kod, duhet të përdorni një kod gjenerik që është i afërt me llojin e aktivitetit. Zgjedhja e kodit do të ketë implikime për menaxhimin taksave dhe kontributeve;
- duhet zgjedhurrregimin tatimor: në varësi të parshikimeve te teardhurave vjetore duhet të zgjedhni nje regjim tatimor të veçante nga i cilin rrjellin metodat e ndryshme të mbajtjes së kontabilitetit. Mes tyre eshte edhe regjimi tatimor për tatimpaguesit minimale që thjeshton në mënyrë te ndjeshme menaxhimin e kontabilitetit për ata që faturojë më pak se 30 mijë në vit. Për më shumë informacion konsultoni faqen e internetit të Agencise se te Ardhurave;
- duhen kompiluar dokumentat e hapjes së aktivetit: për kompilimin mund t'ju drejtoheni zyrave të Agjencisë së të Ardhurave (Vetë-Punësim) ose Dhomës së Tregtisë (Ndërrmarrjet). Nëse keni nevojë për këshilla, mund të kontaktoni një nga qendrat e asistencës tatatimore ose një konsulent bisnesi të njohur nga ligji. Zgjedhja varet kryesisht nga buxhetin në dispozicion;
- duhet hapur nr. TVSH: nëse kodi i aktivitetit të zgjedhur bën pjesë në ndërmarrjet duhet të kontaktoni Dhomën e Tregtisë. Në rast se bëhet fjalë për vetëpunësimin duhet të kontaktoni Agjencinë e të Ardhurave. Hapja dhe mbyllja e TVSH-së është falas.

- duhet të regjistroheni pranë Siguracioneve Shoqërore INPS-it apo tek një tjetër fond providencial: në varësi të veprimtarisë që kryeni duhet të regjistroheni në një formë të veçantë të sigurimesh që menaxhohet nga INPS-i apo pranë organeve të tjera të sigurimeve shoqërore sektoriale;
- duhet të regjistrohoni pranë INAIL-it: regjistrimi i detyrueshëm kundër aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale prane zyrës se INAIL-it përgjegjëse për zonën;
- duhet berë raportimi i fillimit të aktivitetit (SCIA) pranë komunës tek (SUAP – Sporteli i Vetëm për aktivitetet prodhuese), që verifikon përputhshmërinë me rregulloret e urbanistike, kodet e ndërtimit, mjedisit, sigurisë publike, parandalimin e zjarrit, kanalizimet dhe sigurinë në vendin e punës, të rregullave që lidhen me efikasitetin e energjisë dhe dispozitat e përmbajtura në kodin e trashëgimisë kulturore dhe peisazhit.

Me efekt nga data 1 prill 2010 ndërmarrjet, përfshirë edhe ato individuale, kanë për detyrim të kryejnë të gjitha procedurat administrative të fillimit, modifikimit, dhe përfundimit të aktivitetit nëpërmjet një Komunikimi të Vetëm (ComUnica), që bëhet elektronikisht ose me anë të një dispositivi informatik. Në këtë mënyrë një marrës i vetëm kujdeset per trasmetimin e informacioneve që u duhen bërë enteve të ndryshme kompetente.
Pranë Qendrave te Punësimit janë në dispozicion shërbime informacioni dhe konsultimi per te filluar nje aktivitet të pavartur.

117. A ekzistojne mundësi financimi të ofruara nga ligji për të filluar një aktivitet të pavartur?

Ekzistojnë mundësi të cilat nuk njihet nga shumica. Mund ti drejtoheni INVITALIA-s, Agjencia kombëtare për promovimin e investimeve të brëndshme dhe zhvillimin e ndërmarrjeve. Ajo cila vepron nën delegimin e Qeveris për të rritur konkurrencën e sistemit produktiv. Ligji lehtëson Vetëpunësimin (D.Lgs. n. 185/2000 - Titulli II) që është instrumenti kryesor që mbështet zbatimin dhe fillimin e bizneseve të vogla nga të papunët apo njerëzit në kërkim të punës së tyre të parë.
INVITALIA jep grante financiare (grant me fond të humbur dhe kredi me interes të ulët) dhe shërbime si asistenca teknike për tri lloje iniciativash:
- Punë të pavartur (në formën e ndërrmarjes personale), me investimet totale të planifikuara deri tek 25,82 €;
- Mikrondërmarrje (në formën e kompanisë), me investime totale të planifikuara deri € 129,11;
- Franchising (në formën e një pronësie personale ose ndërrmarrje), që rrealizohet me *Franchisor*;
- të kredituar me INVITALIA.

Për bizneset e avijuara, ekzistojnë stimuj e financime te INAIL-it për të përmirësuar sigurinë në vendin e punës. Kontributi mund të arrijë deri ne 100,000 €.
Aplikimi per financim duhet plotësur në faqen e internetit të Invitalia.

4.1.4 Kushtet për pranim në punë të minorenve

118. Cila është mosha minimale për të filluar punë në Itali?

Mosha minimale për pranim në punë të të miturit është mosha në të cilën ky i fundit ka përfunduar arsimin e detyrueshëm, por në çdo rast nuk mund të jetë më i vogel se 16 vjeç (Ligji nr. 296/2006), ose 15 në rastet e alternimit shkollë/punë.

Ky rregull vlen për të gjitha llojet e marrëdhënieve të punës që mund të vendosen me të miturit.
Të vetmet përjashtime, për sa i perket limitit të moshës, lejohen në fushën **e aktiviteteve të punës që kane të bejnë me aktivitet kulturore, artistike ose publicitare në industrinë e zbavitjes.**
Në raste të tilla, duhet kërkuar autorizim paraprak nga Drejtoria kompetente Territoriale e Punës (ose e vendit ku puna do të kryhet), e cila jepet vetëm nesë ekziston pëlqimi paraprak me shkrim i mbajtësit të përgjegjësisë prindërore dhe se ky aktivitet nuk ka pasoja mbi sigurinë, integritetin pisco-fizik e zhvillimin, ndjekjen e shkollës ose pjesëmarrjen në programet orientuese ose trajnimet që fëmija duhet të ndjekë (neni 4 i ligjit nr. 977/1967).

119. Fëmija që ka mbushur 16 vjeç mund të nënshkruajë kontratë punë?
Po, fëmija/i riu i cili ka mbushur 16 vjeç mund të nënshkuajë në autonomi kontratën e punësimit, pa nevojën e ndihmës së personave që ushtrojnë autoritetin prindëror.

120. A i nënshtrohet ndojë disipline të caktuar mardhënia e punës me një të mitur?
Fëmija që punon ka të drejtën e një periudhe pushimesh vjetore të paguara dhe, për punë të barabartë, ka të drejtë të marrë të njëjtin shpërblim si punonjësit në moshë madhore, por githashtu ligji parashikom që të jete i mbrojtur në mënyrë të veçante.
Ligi nr. 977/1967 vendos qe punësdhënësi, para se të punësojë një minoren, ka per detyrë të verifikojë rreziqet, duke pasur parasysh moshën e të miturit, dhe ta visitoje paraprakisht e periodikisht pranë nje Qëndre Shëndetsore kompetente për terriorin, për të verifikuar aftësine për pune të të miturit.
Në rast aktivitetesh pune, për të cilat ligjet në fuqi (Dekreti legislativ nr.81/2008) vendos kontrollin e vazhdueshëm shëndetsor (për shembull: puna në kompiuter) visitat mjeksore praprake dhe periodike duhet të bëhen nga mjeku kompetent, publik ose privat, i zgjedhur nga punëdhënësi.
Orari i punës i të miturve nuk mund ti kalojë 8 oret ditore dhe 40 orët javore. I mituri nuk mund të bëjë orar të jashtëzakonshëm. Orari i punës nuk mund të zgjasë pa ndërprerje për më shumë se 4 orë e gjysëm, pas kësaj kohe punëtori ka të drejtë për një periudhë pushimi prej së paku një ore e gjysëm (kontratat kolektive mund të zvoglojne kohëpushimin deri në gjysëm orë).
Minorenët kanë **të drejtë pushimi javor dy ditë**, nëse eksiston mundësia radhazi, duke perfshirë të djelën; kjo periudhë mund të rreduktohet, nëse eksistojne motive te vlefshme teknike dhe organizative, por sidoqoftë nuk mund të jetë më pak se 36 ore rresht, përjashtuar aktivitet që karakterizohen nga periudha të ndërprera pune ose me kohë zgjatje ditore të shkurtër.
Për disa aktivitete pushimi javor mund të jepet një ditë të ndryshme nga e djela: bëhet fjalë për aktivitete kulturore, artistike, argëtuese dhe reklamat, sportive, turizëm dhe hotel ieri, duke përfshirë baret, shitësit e akulloreve, dyqanet e ëmbëlsirave etj.,aktivitete për të cilat ngarkesa me e madhe e punës fokusohet të dielën.

121. Të miturit mund të përdoren për punën e natës?
Është e ndaluar puna e natës per fëmijët (nga ora 22-6 ose nga ora 23-7). Përjashtuar raste të rënda që mund ti krijojnë probleme funksionimit të kompanisë, me kusht që punëdhënësi të njoftoje menjëherë Ispektoratin e Punës, duke treguar shkakun e forcës madhore, emrat e punëtorëve të mitur dhe orë për të cilat janë të punësuar.

Ky përjashtim lejohet vetëm "në raste të jashtëzakonshme për aq kohë sa është domosdosmërisht e nevojshme", "me kusht që një punë e tillë të jetë e përkohshme dhe nuk lejon asnjë vonesë" dhe "punëtorët e rritur nuk janë në dispozicion" sapo gjendja të kthehet në normalitet atëhere rikthehet në fuqi rregulli që u ndalon të minurve punën e natës.

122. Cilat jane punët që u ndalohen të miturve?

Neni nr. 6 i Ligjit nr. 977/67 parashikon ndalimin e përdorimit të të miturve në punë që mund të kompromentojnë zhvillimin e tyre te plotë mendor dhe fizik; **veprimtaritë e ndaluara** specifikohen në dokumentin nr.1 të bashkangjitur (shtojca 1, që u prezantua me dekretin legjislativ nr. 345/99 dhe u ndryshua më pas nga dekretit legjislativ nr. 262/2000).

Duke përjashtuar ndalesat e sipërpërmendura të rënditura në Shtojcën I, u lejohet adoleshentëve, për qëllime rreptësisht arsimore, apo formimimi profesional dhe vetëm për kohën e nevojshme për nje trajnim të tillë (të kryer në klasë ose në laboratorë që përdoren për aktivitete trajnuese, ose kryhet në vende që janë përgjegjësi e drejtpërdrejte e punëdhënësit). Këto aktivitete duhet të kryhen nën mbikqyrjen e trajnerëve kompetente në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes dhe në përputhje me të gjitha kushtet e sigurisë dhe shëndetit sipas dispozitave të legjislacionit ekzistues.

Në raste të tilla, me përjashtim të institucioneve të arsimit dhe të formimit profesional, aktivitetet duhet të autorizohen nga Drejtoria territoriale e punës, pasi ka konsultuar njësinë lokale të shëndetit publik përgjegjës për territorin, në mënyrë që punëdhënësi të respektojë legjislacioni mbi shëndetin dhe sigurinë në punë.

Të miturit nuk mund të përdoren gjithashtu për të transportuar pesha për më shumë se 4 orë gjatë ditës, duke përfshirë edhe kthimin bosh.

123. Me çfarë kontratash mund të punësohen të miturit?

Dekreti legislativ nr. 77/2005 disiplinon alternimin shkollë-punë që përbën një nga format e rrealizimit të kurseve të ciklit të dytë shkollor. Sistemi i alternimit u përket të rinjve të cilët janë të paktën 15 vjeç dhe mund të:

- kryejnë tërë formimin, deri në moshën 18 vjeç, me anë të alternimit të shkollës dhe punës, nën përgjegjësinë e istitucionit shkollor apo formues, në bazë të një marrëveshjee paraprake me nderrmarrje, shoqata tregtare, Dhomave të Tregtisë e ente publike ose private ose te sektorit te tretë. Të gjitha këto subjekte duhet të jenë në dispozicion për të mirëpritur të rinjtë për periudha kohore të nevojshme për praktikën, praktik që nuk përbën marrëdhënie pune;
- krijojnë një kontratë *apprendistati* që synon marrjen e një kualifikimi apo një diplome profesionale.

Nga data 25 prill 2012 ka hyrë në fuqi përfundimisht rregullorja e re mbi kontratat e aprendistatit (Dekreti Legjislativ nr. 167/2011). Të rinjtë nga mosha 15 deri në 25 vjeç mund të firmosin një kontrate aprendistati për kualifikimin profesional që zgjat tre ose katër vjet. Punësimi i të miturve nëpërmjet këtyre kontratave është i mundur vetëm në rajonet që kanë adoptuar, pas konsultimit me partnerët socialë, një rregullore të veçantë mbi profilet formuese të aprendistatit.

Kontratat e aprendistatit profesionalizues apo që jep zanat (që kanë si synim arritjen e një kualifikim profesional për qëllime kontraktuale) ose aprendistati të lartë dhe kërkimit (për arritjen e një diplome të arsimit të mesëm, një diplomë universitare ose të arsimit e lartë), mund të lidhet vetëm nga persona qe kane mbushur 17 vjeç dhe që kanë një kualifikimi profesional.

Minorenët të cilët kanë mbushur 16 vjeç mund të firmosin edhe kontrata pune të ndryshme nga ajo e aprendistatit, si me kohë të caktuar ose të pacaktuar.
Vetëm të rinjte që kanë mbushur 18 vjeç mund të jetë të punësohen me një kontratë hyrje (neni nr. 54 dekretit legjislativ nr. 276/2003).

4.2 Hyrja në tregun e punës në Itali

124. Si mund të hy në tregun e punës në Itali?
Në dy mënyra:
- direkt në Itali (duke respektuar kushtet që kërkohen);
- nga jashtështeti, me anë të një autorizimi personal

Për ata që ndodhen në Itali

125. Për të punuar në Itali duhet të kem lejeqëndrimi?
Po, për të punuar në Itali, duhet të keni lejeqëndrimi që mundëson punësimin, të lëshuar për një nga arsyet e mëposhtme: lejeqëndrimi për anëtarët e familjes së një qytetari të BE-së, kartë qëndrimi të përhershëm për anëtarët e familjes së shtetasve të BE-së, arsye familjare, familja e të miturit, integrim i të miturit, punë sezonale, punë artistike, vetë-punësim, punësim, në pritje të punësimit, punësim sezonal edhe punë shumëvjeçare në raste të veçanta, leja e qëndrimit KE për rezidentëtafatgjatë, mbrojtje e përkohsme, kërkimore shkencore, studim (në këtë rast mund të punoni deri në 20 orë në javë dhe 1040 orë në vit); arsye humanitare dhe punë pushime.
Nuk mund të punosh në qoftë se keni lejeqëndrimi për:
- turizëm;
- arsye fetare;
- trajtim mjekësor;
- të miturit;
- kërkes për azil politik;
- biznes;
- drejtësi
- në pritje të nështetësise

Vini Re: Për azilkërkuesit, nëse kërkesa për azil nuk është shqyrtuar brenda 6 muajve nga paraqitja e kërkesës për shkaqe që nuk mund ti atribuohen të huajit, leja e qëndrimit do të ripërtrihet për 6 muaj dhe do të lejojë mbajtësin të punësohet deri në përfundimin e proçesit burokratik.

126. Çfarë duhet bërë për të punësuar një punëtor të huaj tashmë me banim të ligjshëm në Itali?
Punëdhënësit të cilët dëshirojnë të punësojnë një punëtorë të huaj me banim të ligjshëm në Itali dhe në zotërim të lejeqëndrimit që i mundëson të punojë, duhet të dërgojnë në Qendrën për Punësim te vendit ku ndodhet vendi i punës, brënda 24 orësh para ditës së parë të punës, **modelin "Unilav"** për njoftimin e detyrueshëm të punesimit.

Me komunikim e ketij modeli, që do të kryhet ekskluzivisht në mënyre elektronike, përmbushen në të njëjtën kohë të gjitha detyrimet e komunikimit: te Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore (INPS), te Instituti Kombëtar për Sigurimin dhe dëmtimeve në punë (INAIL) dhe format tjera të zëvendësimit të sigurimeve shoqërore ose ekskluzive, si dhe tek prefektura.
Modeli përmban edhe angazhimet, (të parashikura perpara në "modelin Q"), të cilat punëdhënësi është i detyruar sipas Aktit të Imigracionit të mbajë, pagesën e shpenzimeve për riatdhesimin e të huajit në rastin e një kthim të detyruar dhe strehimit e të huajit.
Edhe në rastin e punës shtëpiake, komunikimi që bëhet te INPS-it, tani është i vlefshme për për të kryer detyrimin për të paraqitur modelin e vjetër Q.
Për lëshimin ose ripërtritjen e lejeqëndrimit për pune qytetari i hyaj duhet t'i bashkangjise aplikimit kopje të komunikimit UNILAV. Gjatë kësaj faze, shtetasi i huaj në zotërim të *ricevuta* postare që dëshmon kërkesën për ripërtëritjen e dokumentave, mund të vazhdojë të punojë.
Për informacione të mëtejshme dhe për formularët e aplikimit mund të visitoni në faqen web **Clic lavoro** Komunikimet e detyrueshme.

Për ata që vinë në Itali

127. Si hyhet në Itali për punë?

Numri i shtetasve të huaj që pranohen në Itali për punë (duke përfshirë edhe punen sezonale) ose vetëpunësim përcaktohet brenda "kuotave" në dekretet mbi flukset, të cilat përcaktojnë numrin maksimal të të huajve jo BE që mund të hynë në Itali për punë (të vartur, sezonale, dhe të pavartur). Në rastet e përcaktuara nga ligji, ju mund të hyni për të punuar edhe jashtë kuotave.

128. Çfarë nënkuptohet me hyrjet jashtë kuotave? Kush mund të hyjë në Itali nëpërmjet këtij kanali?

Hyrjet jashtë kuota, janë hyrje për motive pune që mund të verifikohen gjatë gjithë vitit e për të cila nuk ekziston asnjë limit numerik (përjashtuar hyrjet për trajnimet forumuese, për sport profesional ose amatorial e punë vullnetare) parashikohet një procedure e thjeshtëzuar për lëshimin e nulla osta për punë. Në disa raste (drejtuesit, profesorët univeristar, punonjës të specializuar që punojnë në Itali, punëtorët detarë, stazhistët dhe gazetarët) nullaosta për punë nuk nevoitet dhe procedura prashikon direkt, ose me paralajmerim të Sportelit të Vetëm, kërkesën për vizën e hyrjes pranë përfaqsive diplomatike e konsullore italiane jashtë shteti.
Sipas ligjit italian (neni nr. 27 e sa më pas dekreti legjislativ nr. 286/98) mund të hyne në Italia jashtë kuotave (për punë të vartur ose të pavartur):

- drejtues/personel me kualfikime shumë të larta profesionale;
- lektorë univeristarë që do te kryejne ne Itali pune akademike;
- të huaj në zotërim të një titulli studimi të lartë, që e lejon në vendin e origjinës, të kryejë programe doktorature, programe studimi, në bazë të një kërkese nga një Institut studimesh, i regjistruar në listën e Ministrisë së Arësimit, të Universitetit dhe të Punës kërkimore-shkencore;
- perkthyes;

- të huaj nga 20 deri në 30 vjec, të pranuar për të marrë pjesë në programe vullnetarie pranë enteve ekleziastike të njohura nga shoqëria civile, organizzata jo shtetërore dhe shoqata të promovimit social, në prezencë të një marrëveshjeje midis të huajit dhe organizatës pritëse.

Vetëm për punë të vartur mund të hynë jashtë kuotave kategorite e mëposhtme:

- bashkëpunëtoret familiar, prej më shume se një viti jashtë shteti, me mardhënie pune të vlefshme e me kohë të plotë me qytetarë italiane ose të një Shteti anëtar të Bashkimit Europian, rezident jashtë shteti por që trasferohen në Itali.
- të huajt, të cilët ndjekin kurse formimi profesional, dhe që bëjnë praktikën pranë punëdhënësve italianë duke patur edhe marrëdhënie pune të vartur;
- punonjës pranë organizatave ose ndërmarrjeve që punojnë në territorin italian;
- marinarët;
- të punësuarit nga punëdhënësit, individë ose juridikë rezident ose banues jashtë shtetit, të cilët janë transferuar përkohësisht jashtë vendit pranë personave fizikë ose juridikë rezidentë në Itali, për të kryer shërbime të caktuara në territorin italian, shërbime të caktuara nga kontrata e lidhur midis këtyre personave fizikë ose juridikë;
- artistët e cirkut ose të tjerë që udhëtojnë për spektakle të ndryshme;
- personel i spektakleve artistike, teknike për spektakle lirike, teatrale, koncertore dhe balet;
- balerinë, artistë, muzikantë, që punojnë pranë lokaleve të ndryshme;
- artistë që punojnë pranë enteve muzikore, teatrale dhe kinematografike, pranë radiove dhe televizioneve, me qëllim manifestime kulturore dhe folkloristike;
- sportistë profesionistë;
- gazetarë/korrespondentë zyrtarisht të njohur dhe të akreditуar pranë organeve të shtypit dhe televizionit;
- persona që kryejnë punë rasti në kuadrin e programeve të shkëmbimit rinor: ose më sakte persona të punësuar *"alla pari"*:
- infermierë profesionistë të punësuar pranë strukturave sanitare publik.

Për të nojhur me në detaj procedurat që duhen ndjekur për çdo kategori, shiko " Blue Card e rastet e tjera të veçanta për hyrjen jashë kuotave" (e disponueshme edhe në anglisht në faqen web http://www.integrazionemigranti.gov.it/Pagine/default.aspx)

129. Çfarë është karta blu BE? Kujt mund ti lëshohet?

Dekreti legislativ nr. 108/2012 parashikon një kategori të re punëtoresh që mund të hyjnë në Itali jashtë kuotava të parashikuara për punetorët e super kualifikuar.

Konsiderohen punëtore të **super kualifikuar** të huajt që kanë një diplome të shkollës së mesme të lëshuar nga autoritet kompetente të vëndit ku diploma është kryer, që dëshmon përfundimin e një programmi mësimor të mesëm ose te një programi të parashikuar pas ciklit te dytë, me kohe zgjatje të paktën prej tre vitesh, dhe diplomë që provon kualifikimin profesional.

Diploma profesionale e shkollës së mesme, lëshuar nga vendi i prejardhjes, duhet të njihet në Itali.

Për sa i perket njohjes së diplomave të kualifikimit profesional të pa njohura (ose më sakte diploma kualifikimi profesional që nuk mund të krahasohen me një diplome të tillë rregullisht të njohur në Itali), i huaji, ose nderrmarja që dëshiron ta punësoje, duhet të presantojë një kërkesë për njohjen e diplomës pranë Ministrisë së Arsimit, Universitetit dhe Kërkimit.

Në Itali, për pranimin e këtyre lloj kerkesave, entet e autorizuara janë ato që parashikohen nga neni nr. 5 ti Dekretit Legjislativ nr. 206/2007.
Punetorit të huaj që ka hyrë në Itali si punëtor i super kualifikuar i leshohet një lejeqëndrimi që qjuhet "Karta blu BE". Ky lloj lejeqëndrimi ka një kohëzgjatje prej dy vitesh në rast kontrate pune me kohe të pacaktuar. Në rasta të tjera, ka të njëjtën kohëzgjatje sa edhe kontrata e punës.

130. Cila është procedura e parashikuar për të marrë kartën blu BE?
Kërkesa për autorizim (modeli BC) që bëhet nga ana e punëdhënesit i duhet trasmetuar Sportelit të vetëm me anë të një procedure informatike në faqen web të Ministrisë së brëndeshme (https://nullaostalavoro.interno.it) në të cilën mund të hyhet pasi behët, falas, rregjistrimi.
Punëdhenesi sëbashku me garancinë rreth banimit dhe propozimin per kontraten e lejeqëndrimit duhet të tregojë:
- nje propozim pune, prej të paktën nje viti, për zvidhimin e një aktiviteti për të cilin është i nevojshëm kualifikimi profesional i mesem;
- diploma e shkollës që dëshmon kualifikimin e punëtorit;
- shuma vjetore e rrogës, jo më e ulët se tre herë niveli minimal i parashikuar për përjashtimin nga pjesmarrja në shpenzimet shëndetsore (me sakte 24.789 € ose 8.236x3)

Pas lëshimit të autorizimit, jo më shumë se 90 ditë nga data në të cilën është paraqitur kërkesa, punëtori i huaj mund të paraqitet pranë përfaqsisë Diplomatike e Konsullore të vëndit të vet për të kërkuar vizë për hyrje ose nëse jeton me lejeqëndrimi të rregullt në Itali, per motive të tjera, mund të paraqitet direkt pranë Sportelit të vetëm për të nënshkruar kontratën e lejeqëndrimit. Sidoqoftë viza e hyrjes është e nevojshme nëse kjo kërkese është bërë për të huaj që jetojne rregullisht në Itali për këto motive: mbrojtje internazionale, mbrojtje të perkoshme, humanitare ose për punë sezonale ose punëtorë të shkëputur sipas nenit nr. 27 pika a), g), e i) të teksit të vetëm per imigracion.
Autorizimi për punë mund të tërhiqet nëse punëtori nuk paraqitet, brënda 8 ditësh nga hyrja në territorin Italian, pranë Sportelit të vetëm për te firmosur kontratën e lejeqëndrimit, përjashtuar **rastet e forcës madhore**.
Të huajt që kanë kartën blue BE, kanë disa limitacione, për dy vitet e para të punësimit në territorin kombëtar, si për sa i perket ushtrimit të një pune të ndryshme nga ajo e "super kualifikuar" dhe ndërrimit te punëdhënsit. Në rastin e lart përmëndur, ndryshimi i punës është totalisht i ndaluar, kursë ndërrimi i punëdhënesit mund të bëhet në rast autorizimi nga zyra kompetente e Drejtorisë për Punë të zonës. Pasi të jetë firmosur kontrata e lejeqëndrimit dhe të jetë bërë komunikimi i mardhënies së punës, punëtorit i lëshohet një lejeqëndrimi elektronike që qjuhet "karta blu BE", me kohëzgjatje prej 2 vitesh në rast se kontrata e punës është me kohë të pacaktua, ose me kohë zgjatje sa ajo e kontrates së punës.

131. Çfarë është programimi i flukseve të hyrjes?
Hyrja në territorin e shtetit italjan për motive pune të vartur (edhe pune sezonale) pune autonome, është e mundur, përjashtuar disa profile profesionale për të cilat lejohet hyrja edhe jashtë kuotave (shiko sa më lart), vetëm brënda kuotave vjetore të parashikuara nga dekreti për fluksin e hyrjeve për motive pune. Këto dekrete merren nga Këshilli i Ministrave çdo vit.
Dekreti i fundit mbi flukset për punë të vartur është i vitit 2010 (**D.P.C.M. te 30 nentorit 2010**).
Për vitin 2013 (DPCM i datës 25 nëntor 2013) janë krijuar kuota e hyrjes ekskluzivisht për punë të pavarur (2,300 kuota), për punëtorët me origjinë italiane që jetojnë në Argjentinë,

Uruguaj, Venezuelë dhe Brazil (300 kuota) dhe për punëtorët që kanë përfunduar programe trajnimi në vendet e origjinës në përputhje me nenin 23 të Tekstit te vetem (3000). Shih studimin mbi Portale Integrazione Migrante.

132. Kam gjetur një punëdhënës të gatshëm të më punësojë: çfarë duhet të bëj?

Dorëzimi nga punëdhënës, italian ose i huaj me qëndrim të rregullt në Itali, i kërkesës për leje punësim të një punëtor jo BE është monenti kur e tërë procedura fillon.

Për të marrë një vizë hyrjeje për arsye pune, punonjësi duhet të ketë marrë autorizimin për punë të lëshuar nga Sporteli i vetem për imigracion.

Kërkesa për autorizim për punë mund të bëhet vetëm pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikes Italiane të dekretit vjetor që programon flukset. Siç specifikohet në qarkoret ministriale të miratuara përpara datës së caktuar për dorëzimin e aplikacioneve.

Sporteli i vetëm lëshon autorizimin me kusht që kërkesa për punësim të bëhet nga punëdhënësi të:

- jetë brënda kuotave të vendosura çdo vit nga dekreti i fluksit;
- asnjë punëtorë italian apo i BE-së i regjistruar si i papunë të jetë i gatshëm të pranojë ofertën për punë (edhe në rastin e disponueshmërisë punëdhënësi, megjithatë, ka fuqinë për të konfirmuar kërkesën e tij);
- nëse nuk ka pengesa nga ana e policisë.

Zakonisht miratohen dekrete fluksesh të ndryshëm për punësimin e punonjësve sezonal e jo-sezonal.

Vini Re: Ligji n. 99 i datës 9 gusht 2013 ka sjellë një ndryshim të rëndësishëm në procedurën që lidhet me verifikimit pranë qëndrave të punësimit të punëtorëve rezidentë në Itali për vendin e ofruar. Ndërsa procedura e vjetër parashikonte që pasi dërgohej nga punëdhënësi kërkesa per nulla osta për të punësuar punëtorin, Sporteli i vetëm për Imigracionin organizohet për të komunikuar këtë kërkesë në Qendrën e Punës përgjegjëse, e cila brenda 20 ditëve duhej të verifikonte disponueshmërinë e punëtorëve kombëtare, të Be-së apo shtetas të huaj në zotërim të një leje qëndrimi për vëndin e ofruar punëtorit të huaj, në procedurën e re verifikimi bëhet pranë qendrës së punësimit. Punëdhënësi është i detyruar të aplikuajë pranë Qendrës për punë, e duhet ta bëjë këtë procedurë para se të paraqesë kërkesën për nulla osta për një tjetër punëtor të huaj pranë sportelit të Vetëm për Imigracionin.

133. Çfarë ndodh pasi bëhet kërkesa? Sa kohë duhet të pres?

Aplikacionet përpunohen në bazë të rendit kronologjik të paraqitjes së tyre.

Policia verifikon eksistencën e ndonjë pengese ligjiore ndaj punëdhënesit ose punëtorit të huaj, për të mos lëshuar autorizimin. Sporteli i vetëm pasi konsultohet me Zyrat Rajonale të Punës rreth kushteve të kontratës dhe të kapacitet finanziar të ndërrmarrjes, si dhe të ekzistences së kuotave, duke patur parasysh mendimin e Departamentit të Policisë, thërret punëdhënësin për prezantimin e dokumenteve të përmendura në aplikim, për lëshimin e autorizimit dhe nënshkrimin e kontratës për të qëndruar. Autorizimi do të jetë i vlefshme për një periudhë që nuk i kalon 6 muajt nga data e lëshimit. Punëtori i huaj duhet të aplikojnë për vizë në përfaqësitë konsullore të vendit të tij të origjinës. Konsullata i komunikon të huajit kontratën e propozuar për qëndrim për pune dhe, brenda 30 ditëve nga data e kërkesës, i jep vizën e hyrjes dhe *kodin fiskal*. Pasi viza është dhënë, punëtori mund të hyjnë në Itali.

Brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali, punëtori i huaj duhet të paraqitet pranë Sportelit të vetëm kompetet, që, pasi shqyrton dokumentacionin, i jep punonjësit e një çertifikatë të *kodit fiskal*. Punëtori i huaj, firmos kontratën e qëndrimit për punë, pa kushte e pa bërë ndryshime në të, dokument që do te ruhet pranë të njëjtit sportel.
Sporteli i vetëm gjithashtu i jep punëtorit të huaj formularin e aplikimit të lejeqëndrimit që dërgohet në Policinë kompetente nëpërmjet formularit që duhet dorëzuar në zyrën postare.

Vini Re: punëtori i huaj mund të punojnë dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat - regjistrimin e lindjeve, ndryshimin e vendbanimit, lëshimin dhe rinovimin kartës së identitetit, regjistrimin në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar, lëshimin e *kodit fiskal*, sëmundje, shtatezanisë, përfitimet mbështetje për të ardhurat, si ata që janë në pritje të rinovimit të lejeqëndrimit, edhe pse duke pritur për lëshimin e lejes së parë të qëndrimit, me kusht që të paraqitni kërkesën për lëshimin e lejeqëndrimit në Sportelin e vetëm për imigracionin brënda 8 ditësh nga hyrja në territorin kombëtar e të jetë nënshkruar kontrata për qëndrim. Duhet paraqitur një kopje e kërkesës për lejeqëndrimi të lëshuar nga Sporteli i Vetëm për Imigracionin, e *ricevuta* e zyrës Postare qe dëshmon për paraqitjen e kërkesës.

134. Si hyhet në Itali për punë sezonale?
Hyrja në Itali e punëtorëve që nuk janë pjese e BE-së për qëllime punësimi sezonal është e mundur vetëm brenda kuotave të përcaktuara çdo vit ne bazë të dekretit që planifikon flukset për qëllime punësimi sezonal.
Aplikimi për punësim mund të bëhet nga punëdhënësi italian ose i huaji që banon ligjërisht në Itali, për një punëtor me banim jashtë vendit që i përket njërit prej nacionaliteteve të përmendura në dekretin mbi flukset.
Procedurat e hyrjes për punë stinore janë te modeluara, në përgjithësi, sia ato për punësim me afat të caktuar dhe të përhershëm jo-sezonal, me disa dallime që kryesisht kanë për synim të shpejtojnë dhe të lehtesojne krijimin e marrëdhënieve të tilla të punës.
Aplikimet për punësim mund të dorëzohet elektronikisht nga punëdhënësi ose nga shoqatat e kategorisë në emër të anëtarëve të tyre. Aplikacionet duhet të dërgohen tek Sporteli i Vetëm për Imigracionin ekskluzivisht me mjete elektronike, përmes internetit https://nullaostalavoro.interno.it/, duke plotësuar formularin e aplikimit.

135. Çfarë ndodh pastaj? Sa kohë duhet pritur?
Autorizimi per hyrje lëshohet nga Sporteli i vetem për Imigracionin brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës.
Që nga viti 2012 është në fuqi procedura e heshtjes – pëlqimit, që ka si qëllim lehtësimin e praktikës, në bazë të së cilës Sporteli i vetëm, pasi kanë kaluar njëzet ditë, nuk informon punëdhënësin për refuzimin e kërkesës, atëherë do të thotë se kërkesa është pranuar nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
- kërkesa ishte për një të huaj të autorizuar edhe vitin e kaluar për të kryer punë sezonale pranë të njëjtit punëdhënës;
- punëtori sezonal vitin e kaluar ka qenë rregullisht i punësuar nga punëdhënësi dhe është kthyer në shtëpi kur i skaduar lejeqëndrimi. Për përdorimin e këtij thjeshtimi burokratik duhet që punëdhënësi të specifikoje, në modelin C-stag të dhënat që lidhen me vitin e kaluar, të komunikimit të detyrueshëm që i referohet rekrutimit te punëtorit ose të dhënat e lejeqëndrimit të punëtorit.

Autorizimi për punë sezonale është i vlefshme për një minimum prej 20 ditësh dhe maksimumit prej 9 muajsh nga data e nënshkrimit të kontratës së qëndrimit. Gjatë kësaj kohe mund të ndryshoni punëdhënësin, me kusht që të mbeteni gjithmonë në fushën e punës sezonale.

136. Çfarë është autorizimi shumëvjeçar për punë sezonale?

Të huajit, që mund të dëshmoje se ka qënë në Itali për pune sezonale për dy vjet rradhazi, mund ti lëshohet një lejeqëndrimi trevjeçare, për pune sezonale. Kohezgjatja për çdo vit është e njëjta si në dy vitet e mëparshme. Për të pranuar kërkesën për autorizim për punë shumëvjeçare, nuk është e nevojshme që dy raportet e punës sezonale të mëparshme të paraprinë mosdoshmerisht presantimin te kërkesës.

Punëdhënësi duhet të kërkoje lëshimin e autorizimit për punë shumëvjeçare pranë Sportelit të vetëm per imigracion duke përdorur një formular të përcaktuar.

Kërkesa mund të presantohet edhe nga një punëdhënës i ndryshem nga ai i dy viteve të mëparshme.

Sporteli i vetem, pasi verifikon kushetet, lëshon autorizimin trevjeçar, duke treguar periudhën vjetore të vlefshmërisë.

Një nga vantazhet kryesore të lejeqëndrimit shumëvjeçar është lejimi i punëtorit sezonal të hyjë në Itali vitin në vijim pa marrë parasysh publikimin e dekretit të flukseve për punë sezonale. Kërkesa për punësim në rast lejeqëndrimi shumevjeçar për punë sezonale për vitet që vijojnë, mund të bëhet edhe nga një punëdhënës i ndyshëm nga punëdhënësi që ka marrë autorizimin trevjeçar për punë sezonale.

137. A mund të trasformoj lejeqëndrimin e lëshuar për punë sezonale në lejeqëndrimi për punë të vartur?

Punonjësi i huaj i autorizuar të hyjë në Itali për punë sezonale, mund të trasformojë lejeqëndrimin për punë sezonale në një tjetër - për punësim të përkohshëm ose të përhershëm – në bazë të kuotava në dispozicion.

Është e nevojshme që në momentin e paraqitjes së kërkesës, lejeqëndrimi për motive pune sezonale të jetë akoma i vlefshëm.

Punëtori i huaj duhet të dërgoje tek Sporteli i vetem për imigracionin kërkesën e konvertimit të lejes per punë sezonale ekskluzivisht në mënyrë elektronike nëpërmjet internetit: https://nullaostalavoro.interno.it.

Në rast të disponueshmërisë së kuotave, i huaji ftohet pranë Sportelit të vetëm për të nënshkruar kontratën e qëndrimit dhe formularin e aplikimit për lejeqëndrim për punësim.

Vini Re: Ndërsa në të kaluarën, për të konvertuar leje qëndrimin sezonal, në leje për punë jo-sezonale, punonjësi pas hyrjes së parë për punë sezonale në Itali, duhej të kthehej në vendin e tij të origjinës dhe të duhej të bënte kërkesë për ri-hyrje për punë sezonale vitin e ardhshëm, Qarkorja e përbashkët e Ministrisë së Brëndëshme dhe të Punës e datës 5 nëntor 2013 ka sqaruar si duhet interpretuar paragrafi 4 i art.24 të dekretit legjislativ nr . n.286/98: punëtorët e huaj sezonale duhet të kthehen në shtetin e origjinës vetëm me qëllim lëshimin e lejes së re për punë sezonale, për vitin e ardhshëm, ndërsa për konvertimin në leje qëndrimi për punë jo-sezonal, përcaktohet në fjalinë e dytë të paragrafit 4, neni 24, duhet të ekzistojnë, brënda kuotave, vetëm kushtet për lëshimin e lejeqëndrimit, përkatësisht ekzistenca e një marrëdhënie pune të caktuar ose të packtuar dhe mungesa e pengesave.

Përfundimisht, sqaroi qarkoren e 5 Nëntorit, në rastin e aplikimit për konvertimin e lejes së qëndrimit për punë sezonale, nuk duhet të verifikohet kthimi i punëtorit sezonal në vendin e

origjinës dhe marrja e vizës së dytë për hyrje në Itali për punë sezonale, me kusht, që të verifikohet nga Zyrat Rajonale e Punës dhe e Sportelit të vetëm ekzistenca e kushteve për punësim sipas kuotave të hyrjes të parashikuara në mënyrë specifike për konvertimet e tilla, si punësimi efektiv në rastin e parë për punë sezonale (me anë të verifikimit të ekzistencës së komunikimit për punesim që kërkohet).

138. A është e mundur hyrja në Itali për punë sezonale me kontratë me kohë të pjesshme?

Po, është e mundur me kusht që koha mesatare javore e punës të jetë jo më pak se 20 orë. Rroga mujore e punëtorit duhet të paguhet jo më pak se sa parashikohet nga kontrata koletive nacionale e kategorisë.

139. Në çfarë sektorësh mund të punësohen punëtorët sezonale?

Sektorët në të cilët është e mundur krijimi i marrëdhënieve të punës sezonale, janë vetëm sektori i bujqësisë dhe i turizëm-hotelerisë. Duhet të jenë sektorët në të cilet aplikohet një nga marrëveshjet kolektive të punës që paraqiten në modelin e kërkesës për punë sezonale në faqen e internetit të Ministrisë së Brendshme.

140. Jam punëtor sezonal: mund të vij përsëri në Itali vitin e ardhshëm?

Po, si punëtor stinor ke të drejtën e radhës për të ardhur përsëri në Itali vitin e ardhshëm, për punë stinore në dallim nga punëtorët e tjerë, të cilët vijnë nga vendi yt për herë të parë në Itali.

Vini re: nga viti 2012 është fuqi procedura e qjuajtur heshtje - pëlqim në bazë të së cilës nëse Sporteli i vetëm, pasi kanë kaluar njëzet ditë, nuk i ka njoftuar punëdhënësit refuzimin e kërkesës, kjo konsiderohet e pranuar nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
- kërkesa është për një te huaj të autorizuar vitin e kaluar për punë sezonale me të njëjtin punëdhënës aplikant;
- punëtor sezonal vitin e kaluar ka qenë i punësuar rregullisht nga punëdhënësi dhe është kthyer në shtëpi në bazë të skadënces.

Për të shfrytëzuar këtë thjeshtimin është e nevojshme qe punëdhënësi të specifikojë, në modelin C-stag - të dhënat e vitit e kaluar, raportimi i detyrueshëm në lidhje me punësimit dhe të dhënat e lejes së qëndrimit të punëtorit

141. Si hyhet në Itali për punë të pavartur?

Mund të hyni brënda kuota ose jashtë kuotava, edhe pse opsioni i fundit është shumë e kufizuar në praktikë. Për të kryer një aktivitet, punë të pavarur, duhet të marrë një vizë për vetëpunësim. Përveç kësaj, duhet të vërtetoni se keni mjete ekonomike të mjaftueshme, po ashtu aktiviteti që doni të ushtroni nuk duhet të jetë i rezervuar me ligj për qytetarët italianë ose të BE-së.

Vini re: sëbashku me dekretin e flukseve vendosen edhe kategoritë e punëtorve autonomë që mund të hynë në Itali. Gjatë viteve të fundit janë parashikuar këto kategori: profesionistë të lirë, bisnezmen që duan të zvillojnë aktivitete me interes nacional, anëtar ndërmarrjesh (jo kooperativa) prej të pakten 3 vjetësh, artistë me famë internacionale dhe hulumtues.

142. Çfarë duhet të bëj për të marrë vizë për punë të pavartur?

Nëse dëshironi të ushtroni një aktivitet të pavartur në Itali dhe nëse bëni pjesë në kuotat e parashikuara nga dekreti aktual mbi flukset për punën e pavartur, procedura ndjek një rrugë tjetër. Në bazë të aktivitetit që dëshironi të ushtroni në Itali mund të bëni pjesë në kuotat që parashikojnë nënshkrimin në një Rregjistër ose Organ Profesional, ose në ato kuota që nuk parashikojnë nënshkrimin në ndonjë Rregistër apo Organ Profesional.

Aktivitetet për të cilat është e nevojshme rregjistrimi në një Organ Profesional o Rregjistër

Në rast se aktiviteti që dëshironi të ushtroni, parashikon regjistrimin në Rregistrin e ndërrmarrjeve dhe kërkohet autorizimi ose liçenca ose regjistrimi në një rregistër të veçantë ose në një organ profesional, ose më saktë parashikon presantimin e një deklarate ose denoncimi, ose përmbushje të kushteve administrative, i huaji duhet t'u kërkoje autoriteteve kompetente edhe me anë të një prokuratori personal (më anë të një procedure të përkthyer e të legalizuar pranë Konsullatës italiane në vëndin e residences së të huajit), një deklaratë që dëshmon se nuk eksistojnë pengesa për dhënien e autorizimit ose të kualifikimit.

Në rast se nuk nevoiten autorizime ose liçenza të veçanta, deklarata për të dëshmuar se nuk eksistojne pengesa lëshohet direkt nga Dhoma e Tregtisë dhe Biznesit të vendit në të cilin do të hapet aktiviteti.

Duhet kërkuar gjithashtu pranë Dhomës së Tregtisë deklarata e parametrave financiar për të filluar aktivitetin. Këto burime nuk duhet të jenë më pak se shuma vjetore e ndimës sociale **(5.818,93€).**

Aktivitete për të cilat nuk është i nevojshëm regjistrimi në Organet Profesionale e Rregjistra

Nëse aktiviteti nuk mund të rregjistrohet në Regjistrin e ndërmarrjeve, dhe aktivitetet janë të lira nga liçencat dhe autorizimet, nga denoncimet për fillimin e aktivitetit, ose rregjistrim në organet profesionale, regjistra ose lista të aktivizuara (p.sh., aktivitetet e konsulencës, me kontratë bashkëpunimi të koordinuar e të vazhdueshëm), e për këto arsye nuk mund të identifikohet administrata përgjegjëse për lëshimin e deklaratës dhe të dokumentacionit që nevoitet për të aplikuar për vizë është e nevojshme të keni:

a) një kontratë të vlefshme, në rast se është nënshkruar nga një ndërmarrje italiane, me çertifikate regjistrimi në Regjistrin e ndërmarrjeve, e në rast klienti të huaj, me një dëshmi të ngjashme të vulosur nga përfaqsia Diplomatike e Konsullore italiane përgjegjëse.
b) kopie të një deklarate përgjegjsie formale, paraprakisht e lëshuar ose e dërguar nga klienti italian ose nga përfaqsuesi i tij legal pranë Drejtorisë territoriale të Punës kompetente, ikspektorati i punës, në të cilën përshkruhet se në bazë të kontratës së firmosur nuk do të istaurohet ansjë raport pune të vartur.
c) një kopje e deklaratës së fundit financiare e depozituar në regjistrin e ndërmarrjeve, në rastin e një korporate, ose të deklarates së fundit të të ardhurave, në rastin e një partneriteti apo të një aktiviteti individual ose të një klienti jo ndërmarrës, nga i cili rrezulton se të ardhurat janë të mjaftueshme për të siguruar shpërblimin.

Per të aplikuar për vizë duhet të keni një strehim të përshtatshëm, me anë të një kontrate pronësie, qiraje ose deklarim mikpritje, duhet gjithashtu të keni në Itali një buxhet të përshtatshem për të garantuar mbulimin e shpenzimeve. Kjo disponueshmërinë duhet të ketë një vlerë më të lartë se minimumi i kërkuar nga ligji për përjashtimin nga pjesëmarrja në shpenzimet shëndetësore (8,400.00 €), dhe mund të demonstrohet nëpërmjet një garancie bankare, një deklaratë nga klienti ose përfaqësuesit ligjor të kompanisë.

Ky dokumentacion duhet të dorëzohet, edhe nëpërmjet avokatit (me prokurë të përkthyer dhe të legalizuar nga Konsullata italiane në vendin e qëndrimit të të huajit), në stacionin policor përgjegjës për zonën, i cila, nëse nuk ka ndonjë pengesë apo probleme të tjera, lëshon autorizim për lëshimin e vizës. Kërkesa për autorizim, që i përcillet policisë, duhet të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin që i përket aktivitetit të pavartur që dëshironi të ushtroni, duke përfshirë çdo autorizim, deklarata dhe çertifikata te lëshuara nga autoritetet kompetente.
Pasi merret autorizim nga policia, mund të vazhdoni aplikimin për vizë në ambasadën italiane. Përfaqësija, pasi ka marrë edhe autorizimet nga autoritetet përkatëse do të lëshojë vizën. Pas marrjes së vizës, i huaji mund të hyjë në Itali brenda 180 ditëve nga lëshimi i saj dhe brënda 8 ditëve pas hyrje duhet të kërkojë lejeqëndrimin duke përdorur aplikimin e duhur.

143. A mund të më refuzohet viza nga ana e autoriteteve diplomatike italjane?
Po. Lëshimi i vizës mbetet në diskrecionin e autoriteteve diplomatike-konsullore. Refuzimi duhet të jetë gjithmonë i shkruar dhe i motivuar, përjashtuar rastet e refuzimit për motive sigurie e qetësie publike.

144. Pasi kam hyrë në Itali me vizë për punë të pavartur si duhet të veproj?
Duhet të marrësh lejeqëndrimin për punë të pavartur, në të njëjtën mënyrë si një punëtor i vartur, brënda 8 ditësh pune prej hyrjes në territorin italian.

145. Me lejeqëndrimin mund të kryej çdo lloj pune të pavartur?
Lejohet çdo lloj aktiviteti jo i rastësishëm dhe i pavartur me kusht që të mos i takojë me ligj vetëm qytetarëve italianë ose të BE-së. Në çdo rast, i huaji duhet të tregojë që ka burime ekonomike të mjaftueshme për aktivitetin që dëshiron të fillojë në Itali. Me lejeqëndrimi për punë të pavartur punëtori mund të kryej dhe një aktivitet pune të varur duke u punësuar në këtë mënyrë nga një punëdhënës, pa patur nevojë të shfrytëzojë sistemin e kuotave të hyrjes.

146. Çfarë vlefshmërie ka lejeqëndrimi?
Lejeqëndrimi ka një vlefshmëri maksimale prej 2 vjetësh.

4.3 Themelimi dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës

147. Cila është përmbajtja e kontratës së punës
Si punonjës i huaj, në momentin e punësimit ke të drejtë të njohesh të gjitha informacionet mbi kushtet e punës, të cilat duhet të përcaktohen në një dokument të shkruar:
- cili është punonjësi;
- cili është punëdhënësi;
- ku ndodhet vendi i punës;
- sa është kohëzgjatja e punës;
- sa është kohëzgjatja e periudhës së provës;
- cili është orari i punës;
- pozicioni i punës, niveli dhe kualifikimi i punëtorit;
- sa është paga;
- sa është kohëzgjatja e pushimeve të paguara;
- cilët janë kufijtë kohorë brenda të cilëve mund të ndërpritet raporti i punës.

Vini re: Në momentin e zgjedhjes, punëdhënësi nuk mund të të drejtojë pyetje mbi bindjet e tua politike, fetare, gjëndje shtatzanie apo sieropozitiviteti, gjëndje civile e gjëndje famigliare (principi i mos diskiminimit)

Përfundimi i një marrdhënie pune

148. Si duhet të veproj për të dhënë dorëheqjen nga puna?
Duke respektuar gjithmonë periudhën e paralajmërimit, duhet të paraqesësh në formë të shkruar dorëheqjen tënde, nëpërmjet një letre në dy kopje, ku duhet të përcaktohen:
- të dhënat mbi shoqërinë të cilës i drejtohet letra;
- vendi dhe data;
- firma jote;
- firma e punëdhënësit.

149. Duhet të respektoj doemos periudhën e paralajmërimit?
Periudha e paralajmërimit përcaktohet në fillim të raportit të punës ose parashikohet në kontratën kolektive. Nëse nuk e respekton, duhet të paguash një gjobë të barasvlefshme me pagën që do të merrje gjatë periudhës së paralajmërimit.

150. Punëdhënësi mund të mos e pranojë paralajmërimin?
Po, në këtë rast mund të pranosh tërheqjen e menjëheshme me të drejtën e dëmshpërblimit.

151. Në rast se punëdhënësi nuk i ka përmbushur detyrimet e tij *(giusta causa),* a jam i detyruar të respektoj periudhën e paralajmërimit?
Në këtë rast, mund të ndërpresësh menjëherë punën, pa respektuar periudhën e paralajmërimit, pasi ekziston një motiv i fortë (giusta causa).

152. Kur është i mundur pushimi nga puna i punëtorit?
Kushtet kryesore për pushimin individual nga puna, edhe pas Reformës së Tregut të Punës, **janë gjithmonë të njëjtat**. Rregulli i përgjithshëm që fikson kufijt rreth punëdhënësit mbi fuqinë që ka për të pushuar është e përmbajtur në nenin nr. 1 të ligji 604/1966 që vendos se "në raportin e punës me kohë të pacaktuar **pushimi nga puna i pononjësit nuk mund të ndodhë përjashtuar *"giusta causa"*** në bazë të nenit nr. 2119 të Kodit Civil ose për **motive të justifikuara.**
Ligji 92/2012 ka sjellë modifikime të reja që u përkasin të gjithë punëdhënesve, pavarsisht nga dimensiont e ndërmarrjes.
- është vendosur që komunikimi i çdo lloj shkarkimi të punëtorit duhet të përmbajnë në fillim arsyet që kanë çuarnë perfundimin e mardhenies se punes.
- shkarkimi mund të sfidohet, me çdo dokument të shkruar, duke përfshirë edhe aktet jashtëgjyqësore, të përshtatshëm për të bërë të njohur vullnetin e punëtorit, edhe përmes ndërhyrjes së Sindikatave, brënda 60 ditëve nga marrja e njoftimit.
Punëdhënësi mund të revokoje shkarkimin brënda 15 ditësh nga njoftimi. Në këtë rast marrëdhënia e punësimit vazhdon sikur të mos këte ndodhur asgjë, dhe punëtori duhet menjëherë të rifillojë shërbimin.

153. Çfarë është shkarkimi disiplinor?

Shkarkimi disiplinor verifikohet në të gjitha rastet në të cilat përdoret per të sanksionuar një shkelje të punëtorit. Bëhet duke respektuar garancitë procedurale të përcaktuara në nenin nr. 7, Ligji nr. 300/1970.

Në veçanti, shkarkimi disiplinor mund të behet në prani të një *giusta causa* (neni 2119 i Kodit Civil), domethënë një sjellje e rëndë e punonjësit sa të mos lejohet, edhe përkohësisht, vazhdimi i marrëdhënies së punës, ose në rast argumentimi objektiv (neni nr. 3 i Ligjit 604/1966), i cili parshikon një thyerje të konsiderueshme të detyrimeve kontraktuese të punëtorit. Detyra për të provuar ekzistencën e **faktit të kontestuar** (qe vihet në bazën të vendimit për pushimin nga puna) bie mbi punëdhënësin.

154. Çfarë është shkarkimi për "*giustificato motivo oggettivo*"?

Pushimi për *"giustificato motivo oggettivo*" (motiv objektiv i justifikuar) i përfaqësuar nga arsye të lidhura me organizimin e punës së ndërmarrjes është një justifikim objektiv i krizës, i ndërprerjes së veprimtarisë dhe, madje, i përfudimit të detyrave të cilat i ishin caktuar më parë punëtorit, pa asnjë mundësi të rivendosjes së tij në detyra të tjera eksistuese brënda ndërmarrjes në përputhje me nivelin e inkuadrimit të punëtorit.

Me riformen e viti 2012, përfshihen në grupin e pushimit nga puna për arsye objektive rastet e pushimit për tejkalim e periudhës së *comporto* (shkarkimi i punëtorit që mungon në punë për motive shëndeti për një periudhë më të gjatë se peiudha që është vendosur nga marrëveshjet kolektive për ruajtjen e vëndit të punës) dhe për paaftësi fizike ose mendore.

Para njoftimit të pushimit nga puna për arsye objektive, punëdhënësi është i detyruar të kërkoje aktivizimin e një procedure pajtimi para Komisionit Territorial në Drejtorinë e Punës.

Punëdhënësi duhet të deklarojë qëllimin për të proceduar me pushimin nga puna për shkaqe objektive dhe të tregojë arsyet për shkarkimin dhe masat që do të marrë për të mbështetur zhvendosjen e punëtorit.

Drejtoria territoriale e punës do të mbledhë punëdhënësin dhe punëtorin brënda 7 ditëve nga marrja e kërkesës: takimi zhvillohet para Komisionit Territorial për pajtim të referuara në nenin nr. 410 c.p.c.

Palët mund të ndihmohen nga organizatat përfaqësuese pranë të cilave janë të rregjistruar, ose mund ti japin mandatin përfaqësimit sindikal të punëtorëve, ose të asistohen nga një avokat ose një konsulent i punës.

Procedura përfundon brënda 20 ditëve nga data e paraqitjes së thirrjes nga Drejtoria Territoriale e Punës.

Në rast të një rezultati pozitiv me përfundimin e marrëdhënies së punës:

- punëtori, nëse i plotëson kërkesat, përfiton asistencën e papunësisë nga Sigurimet Shoqerore per Punesim;
- mund të vihet në kujdesin e një agjencie për punë në mënyrë që të gjeje nje pune tjeter.

Në rast të një **rezultati negativ** dhe, në çdo rast, pasi një periudhën prej 7 ditësh, punëdhënësi mund të njoftojë për shkarkimin e punonjësit.

155. Nëse punoj në një ndërmarrje të vogël dhe shkarkohem padrejtësisht, kam të drejtë kompensimi?

Po, në ndërmarrjet e vogla, nëse shkarkimi konsiderohet i padrejtë, punëdhënësi mund të zgjedhë mes integrimin të punëtorit të shkarkuar në mënyrë të paligjshme, brenda 3 ditësh, ose të paguajë një kompensimi nga një minimum prej 2.5 deri në një maksimale prej 6 muajsh rrogë.

Në rast se gjykata shpallë pavlefshmërinë e një vendimi (ose mosefektivitetin)e shkarkimit, punëtori mund të marrë:

- riintegrimi në vendin e punës ose një shperblim prej 15 pagesash mujore në vend të rikthimit (pa kontribute);
- kompensim të plotë të muajve të humbur nga data e pushimit nga puna deri në atë të rikthimit, sidoqoftë jo më pak se 5 rroga dhe pagimin e kontributeve për të njëjtën periudhë.

156. Nëse punoj në një ndërmarrje të madhe dhe shkarkohem padrejtësisht, kam të drejtë kompensimi?
Ligji 92/2012 ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme disiplinën e shkarkimeve dhe, në veçanti, neni nr. 7 i Ligjit 604/1966 dhe neni nr. 18 i Statutit të Punonjësve. Nëse punonjësi presanton një apel në gjykatë dhe shkarkimin shpallet i paligjshme, të drejtat që përfiton mund të jenë të ndryshme në varësi të shkakut të paligjshmërise. Në veçanti;
- në mungesë të detajeve që kanë sjellë shkarkimin: punëtori mund të marrë një kompensim nga një minimum prej 12 deri në një maksimum prej 24 muajsh rroge;
- në rast të dështimit të percaktimit të shkaqeve për një shkarkimin e tillë: punëtori mund të marrë një kompensim nga një minimum prej 6 deri në një maksimum prej 12 muajsh;
- në qoftë se shkelja është haptazi e pabazuar: punëtor mund të arrijë integrimin në vendin e punës.

4.4 Shërbimet për Punësim

157. Çfarë janë shërbimet për punësim dhe për çfarë shërbejnë?
Shërbimet e punës janë struktura publike që kanë zëvendësuar zyrat e punës (uffici di collocamento). Janë kijuar për të ndihmuar takimin e kërkesës dhe ofertës për punë, për të parandaluar papunësinë dhe për të ndihmuar hyrjen në tregun e punës të personave që rrezikojnë të mbeten të pa pune.

158. Si mund të përfitoj nga këto shërbime?
Duhet të rregjistrohesh në të ashtuquajturën *"elenco anagrafico"* që ka zëvendësuar "listat e vjetra të punës". Të dhënat e tua do të përmblidhen në:
- një skedë ku do përfshihen së bashku me të dhënat e tua edhe ato të familjes, diplomat e studimit dhe gjendja jote e punësimit;
- një skedë profesionale ("libreza e punës" e mëparshme), me informacione mbi eksperiencat e tua formuese dhe profesionale, disponueshmëria jote dhe çertifikimi i kompetencave të tua profesionale.

KËRKIMI I PUNËS

159. Çfarë është "gjëndja e papunësisë"?
Është gjendja në të cilën ndodhet një person i cili nuk ka punë por që është në kërkim të saj dhe i disponueshëm për të punuar.

160. Si mund të përfitoj gjëndjen e papunësisë?
Duhet të paraqitesh në Zyrën e Punës të qytetit në të cilin banon dhe të bësh një deklaratë që vërteton:
- punët që ke bërë më parë;
- disponueshmërinë tënde të menjëhershme për të punuar.

161. Nëse humbas vendin e punës ose jap dorëheqjen, humbas edhe rregjistrimin në *"elenco anagrafico"*?

Nëse keni një lejeqëndrimi për punësim dhe humbisni vëndin e punës, edhe nëse jepni dorëheqjen, mbeteni të regjistruar në *"elenco anagrafico"* për të njëjtën periudhë kohore për të cilën është e vlefshme lejeqëndrimi.

Në bazë të Tekstit të Vetëm të Imigracionit, keni të drejtë të kërkoni punë për një periudhë prej jo më pak se 12 muajsh (edhe pas skadimit të lejeqëndrimit).

Në këtë rast, ju lëshohet një lejeqëndrimi në pritje punësimi me kohëzgjatje prej jo më pak se një viti. Kohëzgjatja gjithashtu mund të jetë më e gjate se një vit dhe e barabartë me kohëzgjatjen e dhënies së ndimes sociale (p.sh. trajtimi i papunësisë, kompensimi mobiliteti) që mund të marrë punonjësi i huaj. Punonjësi mund të marrë ripërtritje të mëtejshme të lejeqëndrimit në pritje punesimi, nëse mund të demonstrojë se disponon të ardhura sa dy herë shuma vjetore e ndimës sociale, shumë që mund të llogaritet sëbashku me të ardhurat e anëtarëve të tjere të familjes, ashtu siç parashikohet nga neni 29, paragrafi 3, shkronja b në Tekstin e Vetëm të Imigracionit.

162. Kam lejeqëndrim të rregullt dhe kërkoj punë. Kujt mund ti drejtohem në mënyrë që të vihem në kontakt me ndërmarrjet që duan të punësojnë personel?

Ligji ju garanton punëtorëve të huaj që banojnë rregullisht në Itali si edhe familjeve të tyre, të njëjtin trajtim dhe të drejta si edhe punëtorëve italianë. Ashtu si edhe italianët, të huajt mund ti drejtohen:

- shërbimeve publike për Punësim (Qëndrat e Punës, Komunat, Universitetet, Dhomat e Tregëtisë);
- shërbimeve private për Punësim (Agjensive për punë dhe operatorëve të tjerë).

163. Çfarë janë Qëndrat e Punës, ku ndodhen dhe çfarë shërbimesh ofrojnë?

Qëndrat e punës janë struktura publike dhe gjenden në gjithë Italinë. Ofrojnë shërbime të ndryshme:

- pritje, informacione dhe orientim për ata që kërkojnë punë;
- ndërmjetësim midis kërkesës dhe ofertës së punës;
- konsulencë për ndërrmarjet.

164. Ku mund ti gjej oraret dhe adresat e Qëndrave për punë në zonën time?

Mund ti drejtohesh zyrave të Provincës ku banon, ose në internet.

165. Çfarë janë agjensitë e punës?

Janë struktura private të autorizuara që merren me kërkimin dhe seleksionimin e personelit, ndërmjetësojnë midis kërkesës dhe ofertës për punë, gjejnë fuqinë punëtore, etj.

5 ZYRA E GJENDJES CIVILE

166. Çfarë është Gjendja Civile?
Gjendja civile është rregjistri në të cilin dokumentohen të dhënat personale të qytetarëve rezident në Komunë.
Zyra e gjendjes civile merret me pasqyrimin në rregjistër të ndryshimeve që ndodhin në Komunë.

167. Çfarë kuptohet me "vëndbanim", "rezidencë", "vendqëndrim"?
Banesa (banesa e thjeshtë ose banesa e rastit) është vendi ku një person vendos të qëndrojë provizorisht, për një kohë të kufizuar, në pritje të një sistemini të qëndrueshme.
Rezidenca është vendi ku një person jeton dhe ku ka aplikuar për regjistrim në gjëndjen civile. Kërkon residence kush parashikon të qëndroje për kohë të gjatë në të njejten zonë.
Vëndqëndrimi, në të kundërt, është vendi ku personi vendos qëndren kryesore të biznesit, të interesave, të aktiviteteve ekonomike, pasurore, financiare etj.

168. A mund të rregjistrohem në Gjendje Civile?
Po, nëse keni një leje qëndrimi për më shumë se tre muaj, edhe gjatë periudhës së rinovimit, duke treguar pranimin e kërkesës për rinovim, mund ti drejtoheni zyrës se regjistrit të komunës së banimit**.**
I huaj i cili ka nënshkruar në Sportelin e vetem për imigracionin kontratën e qëndrimit, në pritje të lëshimit të lejes së parë të qëndrimit për motive pune, mund të kërkojë regjistrimin në Gjendjen Civile, pasi tregon kontratën e qëndrimit që ka nënshkruar në SUI, faturën e lëshuar nga zyra e postës qe dëshmon paraqitjen e kërkesës për leje, dhe kërkesen për lëshimin e lejeqëndrimit për punësim të paraqitur në Sportel. Pokështu edhe i huaj që ka aplikuar për lejeqëndrimi për motive familjare dhe për të cilen SUI ka lëshuar leje për ribashkimin. Për këtë qëllim mjafton tregimi i vizës së hyrjes, të faturës së lëshuar nga zyra Postare që dëshmon paraqitjen e kërkesës për lejeqëndrimi, si fotokopja, dhe jo-autentifikuar, e autorizimit të lëshuar nga Sporteli i Vetem per Imigracion.

169. Kur mund të rregjistrohem në Gjendjen Civile?
- për lindje, në gjendjen civile të komunës së rezidencës së prindërve ose në komunën ku është e rregjistruar nëna, në rastin kur prindërit janë rregjistruar në komuna të ndryshme;
- kur ndërron rezidencën nga një komunë tjetër ose nga jashtë shtetit, në Gjendjen Civile të komunës ku je rezident.

Regjistrimi dhe kërkesa e ndryshimeve anagrafike mund të kërkojnë verifikime nga zyrat kompetente të bashkive, të kushteve higjeno-shëndetsore të banesës në të cilën kërkuesi ka ndërmend të fiksojë rezidencen e tij, sipas normave shëndetsore në fuqi.
Shtetasi i huaj në zotërim të një leje qëndrimi per me shume se tre muaj, ka të drejtë të rregistrohet ne zyrën pranete vendit të banimit. Regjistrimet dhe ndryshimet e të dhënave personale të rezidentëve të huaj kryhen rregullisht me të njëjtat kushte si për qytetaret italianë.

170. Çfarë është familja sipas Gjendjes Civile?
Familja sipas Gjendjes Civile është një grup personash që jetojnë në të njëjtën banesë. Ata me njëri-tjetrin kanë lidhje martesore, farefisnore, adoptimi, mbrojtjeje ose thjesht lidhje interesash.

171. Kur dhe pse mund të fshihem nga Gjendja Civile e komunës së rezidencës?
- nëse ndërron vendin e rezidencës, në një tjetër ose jashtë shtetit;
- nëse nuk rinovojë rezidencën;
- nëse një person i pastrehë transferohet në një komunë tjetër;
- në rast vdekjeje.

Vini re. Kur nuk ripërtrihet deklarata e vendbanimit të zakonshëm: qytetari i huaj paralajmërohet dhe ftohet që të veprojë brenda 30 ditësh.

172. Përse më shërben dokumenti i rezidencës?
Për të marrë lejen e qëndrimi ose për ta rinovuar nuk është nevojshme rezidenca në Itali, mjafton të tregoni në aplikimin tuaj vëndbanimin e përhershëm. Rezidenca nuk është e nevojshme as për regjistrimin në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar, mjafton vëndbanimi në territorin e shtetit.
Sidoqoftë rezidenca në Itali i jep të huajit disa të drejta shtesë; si përshëmbull të drejtën për të marrë letër njoftim, të drejtën për të marrë ose konvertuar patentën e makinës, të drejtën për lëshimin e lejes së qëndrimit afatgjatë të KE (kur plotëson edhe kërkesat e tjera të parashikuara me ligj), e drejta për të kërkuar nënshtetësisë italiane (kur plotëson kërkesat e tjera të parashikuara me ligj), të drejtën për të aplikuar për bashkim familjar.

173. Një qëndër pritjeje mund të konsiderohet si vëndbanimi im i zakonshëm?
Kur një i huaj qëndron në një qëndër pritjeje për të paktën 3 muaj, qëndra e pritjes mund të konsiderohet si vendbanimi i tij i zakonshëm.

174. Është i detyrueshëm ripërtritja e rregjistrimit në Gjendjen Civile? Kur?
Po, sa herë që ripërtrin lejeqëndrimin, brenda 60 ditësh nga lëshimi i lejeqëndrimit te ri (ose lejeqendrimit BE për banorët me afat te gjatë). Gjatë periudhës së ripëertritjes së lejeqëndrimit (ose të lejeqëndrimit BE për banorët me afat të gjatë), rregjistrimi në Gjendjen Civile nuk skadon. Nëpunësi i Gjendjes Civile ripërtrin skedën tënde duke vënë në dijeni kuestorin.
Urdhërohet fshirja e emrit nga listat e popullsisë rezidente (me ndërprerje të periudhës së kërkuar, në disa raste, për kërkesën për nënshtetësinë) në rast mungese të rinovimit të deklaratës së banimit, gjashtë muaj pas skadimit të lejes së qëndrimit, me paralajmerim nga zyra, me një ftesë për berë sa duhet brëbda 30 ditëve të ardhshme.

175. Kur duhet të komunikoj në kuesturë ndërrimin e vendbanimit?
Për të huajt rezident, ndërrimi i vendbanimit mund të komunikohet pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Kuesturës.
Të huajt që qëndrojnë rregullisht në Itali por nuk kanë rezidencë duhet të komunikojnë detyrimisht, brenda 15 ditëve, ndërrimin e vendbanimit në Kuesturën kompetente.

5.1 Rregjistrimi ne Zyrën e Gjendjes Civile

176. Çfarë është "kërkesa për rregjistrim në Gjendjen Civile" për të huajt?
Është kërkesa nëpërmjet të cilës një qytetar i huaj kërkon të rregjistrohet në rregjistrin e Gjendjes Civile. Nëse kërkesa pranohet, qytetari konsiderohet rezident në qytetin që ka zgjedhur dhe ku mund të kërkojë çertifikatat që i duhen gjatë qëndrimit të tij në Itali.

177. Çfarë është ndërrimi i rezidencës apo i vendqëndrimit?
Ndërrimi i rezidencës është transferimi i përhershëm i banimit nga një komunë në një tjetër.
Ndërrimi i vendqëndrimit është transferimi nga një banesë në një tjetër, gjithmonë brenda së njëjtës komunë.

178. Mund të bëj kërkesë për ndërrimin e rezidencës apo të vendqëndrimit?
Vetëm në rast se je i rritur dhe ke lejeqëndrim të rregullt.

179. Ku mund të paraqes kërkesën për ndërrimin e rezidencës apo të vendqëndrimit?
Kërkesa për ndryshimin e vendbanimit mund të dorëzohet në Zyrën Civile te qytetit ku keni ndërmend të merrni rezidencën, personalisht, ose me rrakomandatë, faks ose e-mail në adresat dhe në mënyrën e treguar në faqen e internetit të bashkisë/komunës.

180. Si mund të paraqes kërkesën për ndërrimin e rezidencës apo të vendqëndrimit për gjithë familjen?
Formulari për të deklaruar të dhënat personale duhet plotësuar, nëshkruar e paraqitur pranë zyrës civile të Komunës ku dëshiron të marrësh rrezidencën (mund ta dërgosh në adresat e publikuara në faqet zyrtare të internetit, me rrakomandate ose me fax). Deklaratës i duhet bashkangjitur kopia e dokumentit të identitetit të personit që bën kërkesë dhe të personave që transferojnë rezidencën sëbashku me personin që bën kërkesë. Në rast se janë në moshë madhore, duhet të firmosin formularin.
Nënshtetasi i huaj, për të rregistruar në zyrën e gjëndjes civile mardhëniet familiare me anëtarët e tjerë të familjes, duhet të bashkangjisë dokumentacionin e duhur, në bazë të rregullave që kanë të bejnë me përkthimin dhe legalizimin e dokumentave.
Personi që bën kërkese duhet të kompiloje formularin per vetveten dhe per personat mbi të cilët ushtron kujdestarinë.

181. Si duhet të veproj nëse shkoj të jetoj pranë një familjeje tjetër?
Në rast se në banesën ku dëshironi të trasferoni rezidencën, një familje tjetër është residente duhet domosdoshmërisht që një anëtar mbi 18-vjeç të japë konsensin. Në mungesë të këtij kushti, kërkesa nuk mund të pranohet.
Konsensi mund të jepet:
a) personalisht, duke shoqëruar kërkuesin pranë zyrave të komunës;
b) duke kompliuar pikën përkatëse te formularit, duke bashkangjitur një fotocopie (në dy anët e faqes) të dokumenitit të identiteti të personit që ka dhëne konsensin.

182. Sa kohë duhet për tu regjistruar ose për të ndryshuar rezidencën?
Deklarata e ndryshimit të rezidencës duhet bërë brënda 20 ditësh nga trasferimi efektiv në banesen e re. Nga data 9 maj 2012 ndryshimi i rezidencës (për ata që vinë nga një komune tjeter ose nga jashtështeti) dhe ndryshimi i banesës (për ata që janë rezidente në një komune italiane dhe trasferohen pranë një adrese tjetër në të njëjten komune) kryhet mbrënda 2 ditësh punë, nga data në të cilën është prezantuar kërkesa. Rezidenca do të rezultoje nga data në të cilën është bërë kërkesa.

Brënda 45 ditësh nga data në të cilën është bërë kërkesa e ndryshimit të rezidencës ose të baneses, zyra do të bëjë verifikimin pranë adresës së deklaruar (me anë të policisë lokale) e do të kontrollojë gjithë dokumentacionin e prezantuar ose që i është dorëzuar nga komunia e imigrimit.
Brënda ditës së 45-të zyra mund të hellë poshtë kërkesen me anë të një paralajmërimi në rast se konstaton se nuk ekzistojne kushtet e parashikuara nga ligji si rreth banesës si rreth kushteve te tjera që nevoiten për rregjistrimin në gjëndjen civile, ose në rast se ka jorregullsi në formularin e kërkesës.
Në këtë rast keni kohë 10 ditë për të paraqitur dyshimet tuaja në formë të shkruar në menyrë të tillë që të evitoni anullimin e kërkesës për residencë. Pasi kanë kaluar 45 ditë nga deklarata e bërë ose e dërguar dhe nuk keni marrë përgjigje rreth kushteve që mungonin, kërkesa për rregistrim konsiderohet e aprovuar. Në rast përgjigje negative mund ti drejtoheni prefektit të provincës së Romës brënda 30 ditësh nga komunikimi i zyrës së gjëndjes civile.

Vini re: Rregistrimi në rregistrat e popullsisë rezidente përbën një të drejtë e një detyrim për çdo shtetas italian e të huaj që jeton rregullisht në territor: qarkorja e datës 14 janar 2013 e Ministrisë së brëndëshme ka sqaruar se mungesa e kushteve higjeniko-sanitare në ndërtesën ku jetoni nuk përbën pengesë për të marrë rezidencën në atë vënd.
Qarkorja nënvizon nevojën e të tërë kryebashkiakëve të Italisë që të kenë një linjë të vetme në interpretimin e normativës mi rezidencën (liggi i dt 24 dhjetor 1954 n. 1228 e modifiche të mëtejshme) e të mos varin rregjistrimin e rezidencës në bazë të rezultatit të verifikimeve higjniko-sanitare të banesës.

183. Cilat janë dokumentat që duhen presantuar?

Qytetarët jo komunitarë, duhet ti bashkangjeesin kërkesës, përveç kopjes së pashaportës ose dokument ekuivalent të vlefshme, edhe dokumente të tjera në përputhje me situatën e lejes së qëndrimit, përkatësisht :
Për të huajt që kanë leje qëndrimi të vlefshme:
- kopje të lejes së qëndrimit të vlefshme.

Për të huajt që kanë lejen e qëndrimit në fazë rinovimi:
- kopje të lejes së qëndrimit të skaduar.
- kopje pranimi të kërkesës për rinovimin.

Për të huajt në pritje të lëshimit të lejes së parë të qëndrimit për punësim:
- kopje të kontratës së qëndrimit pranë sportelit të vetëm për emigracion
- fatura e lëshuar nga zyra e postës që dëshmon paraqitjen e kërkesës për leje qëndrimi
- aplikimi për lëshimin e lejes së qëndrimit për punësim të dorëzuar në Sportelin e vetëm.

Për të huajt në pritje të lëshimit të lejes së qëndrimit për bashkim familjar
- fatura e lëshuar nga zyra e postës që dëshmon për paraqitjen e aplikimit për leje
- fotokopje e thjeshtë e autorizimit të lëshuar nga sporteli i vetëm.

Regjistrimi i gjendjes civile (martesa, stausi i lirë, divorci, etj.) ghe marrëdhëniet familjare midis anëtarëve të familjes duhen çertifikuar vetëm me kopje të origjinalit, të përkthyera dhe të legalizuara, që dëshmojnë gjendjen civile dhe përbërjen familjare.

Vini Re: Individët që jetojnë në të njëjtën shtëpi caktohen automatikisht në të njëjtin status familjar. Nëse nuk eksistojne lidhje farefisnisë, mund të kërkoni që të regjistroheni me status familjar individual.

184. Sa kushton rregjistrimi dhe ndërrimi i rezidencës apo i vendqëndrimit?
Janë shërbime pa pagese.

5.2 Sherbimet e Gjendjes Civile

185. Çfarë shërbimesh ofron Gjendja Civile për të huajt?
Çertifikatat e (nëse ngjarjet janë rregjistruar pranë Komunës):

- lindje;
- rezidence;
- historike angagrafe;
- gjendjes familjare;
- ekzistencës në jetë;

Vini re: Për të shfrytëzuar shërbimet që ofron Gjendja Civile, duhet të paraqitesh atje me pashaportën (ose me një dokument tjetër të barasvlefshëm me të) dhe lejeqëndrimin ose lejeqëendrimin BE për banorët me afat të gjatë; të dhënat në këto dy dokumenta duhet të jenë të njëjta.

186. Çfarë është karta e identitetit?
Letërnjoftimi është dokumenti që vërteton identitetin e personit, vlen 10 vjet për shtetasit mbi 18-vjeç, ndërsa për minorenet kohëzgjatja është e diferencuar sipas moshës.
Në veçanti, letërnjoftimi që u lëshohet femijëve nën moshën tre është i vlefshme për tre vjet, ndërsa kur u lëshohet fëmijëve midis moshës tre dhe tetëmbëdhjetë vjeç ka një vlefshmëri prej pesë vjetësh.
Vlefshmëria e letërnjoftimit shtrihet, ne krahasim me skadencën në dokument, deri në ditën dhe muajin e lindjes së mbajtësit.
Letërnjoftimi duhet kërkuar në zyrat kompetente të komunës së banimit.
Qytetarët extraUe letërnjoftimit u lëshohet me frazen "nuk vlen për të udhëtuar jashtë shteti".

Vini re: Karta e identitetit e lëshuar nga komuna nuk përbën dokument që lejon qëndrimin e të huajit në territorin kombëtar.

187. Kur mund të paraqes kërkesën?
Për lëshimin: në çdo moment.
Për ripërtritje: 180 ditë përpara skadencës.

188. Ku mund të paraqes kërkesën për lëshimin/ripërtritje dhe çfarë dokumentash duhet të paraqes?
Duhet të paraqitesh personalisht pranë Zyrës së kartës së identitetit dhe duhet të paraqesësh dokumentat në vijim:

- tre fotografi në format të posaçëm, të gjitha njësoj, me kokë të zbuluar;
- qytetarët e BE-së duhet të paraqesin një dokument identifikimi të vlefshëm dhe kartën e qëndrimit;

- qytetarët e huaj duhet të paraqesin pashaportën dhe lejeqëndrimin; Nëse leja e qëndrimit është në fazë ripërtritje, mund të paraqitet leja e skaduar sëbashku me *ricevuta* e kërkesës së ripërtritjes (e lëshuar nga Kuestura ose nga Posta).
  Duhet të plotësosh një formular të cilin mund ta blesh në arkën e Komunës. Duhet me pas të paguhen të drejtat e segretarisë.

189. Mund të bëj një kopje të kartës së identitetit?
Rastet e parashikuara për lëshimin e një kopjeje të kartës së identitetit, kurkjo e fundit nuk ka skaduar, janë:
- vjedhje;
- humbje;
- dëmtim.

190. Kur mund të përdor autoçertifikimin?
Disa dokumenta të cilat paraqiten në Administratën publike apo në zyrat e shërbimeve publike (Enel, Acea, Atac, Poste, etj.) mund të zëvendësohen nga autoçertifikimi, domethënë nga një deklaratë e thjeshtë e nënshkruar nga vetë i interesuari, e pa-autentifikuar dhe pa pulla.
Një qytetar i huaj, rezident i rregullt në Itali, mund të përdor autoçertifikimin për të çertifikuar:
- gjendje dhe cilësi personale të provuara nga PA;
- fakte të çertifikuara ose të provuara nga subjekte publike italiane, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

191. Çfarë është legalizimi?
legalizimi është një akt nëpërmjet të cilit autoriteti konsullor italian njeh vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga autoritetet e huaja.

192. Çfarë është autentifikimi?
Është një përkthim, i vulosur, që duhet të vlerësohet nga Gjykata Civile dhe që duhet t'i bashkëngjitet, në rast dokumentash të shkruajtur në gjuhë të huaj, origjinalit dhe kopjes.

193. Çfarë duhet të bëj nëse martohem?
Qytetarët e huaj mund të martohen në Itali, si me ritin civil italian, ashtu edhe me ritin fetar i cili është i vlefshëm si riti civil, sipas feve të pranuara nga Shteti. Në rastin e një qytetari të huaj, ashtu si për qytetarin italian, celebrimi i martesës duhet të paraprihet nga publikimet, që kërkohen pranë Zyrës së Gjendjes Civile të komunës ku jeni rezident. Publikimet shërbejnë për të shprehur në mënyrë publike vullnetin e dy personave që dëshirojnë të martohen. Përpara publikimeve, personat që dëshirojnë të martohen, duhet të bëjnë betimin përpara një zyrtari të gjendjes civile.

194. Çfarë dokumentash duhet të paraqes?
- lejen *(nulla osta)*, të lëshuar nga Autoritetet Konsullore në Itali, në këtë rast firma e Konsullit duhet të legalizohet pranë Prefekturës italiane kompetente, ose pranë autoritetit kompetent në vendin e origjinës, në këtë rast dokumenti duhet të legalizohet nga konsullata ose ambasada italiane në atë vend;
- pashaportën ose dokumentin e identifikimit personal;
- akti i lindjes, i lëshuar nga vendi i origjinës, i përkthyer dhe i legalizuar, në rastin kur leja përmban të dhëna mbi lindjen, atësinë, mëmësinë.

Vini re: Në momentin e betimit, duhet të jenë të pranishëm dy dëshmitarë në moshë madhore me dokumenta të vlefshëm (në se të huaj, duhet të kenë me vete lejeqëndrimin).
Në se i huaji është rezident në Itali, çertifikata e rezidencës lëshohet nga zyra e komunës ku ai është resident.

ZYRA TË TJERA SHËRBIMESH NË KOMUNË

195. Çfarë janë shërbimet sociale dhe përse shërbejnë?
Në çdo komunë ndodhet zyra e Shërbimeve Sociale. Të gjithë rezidentët e komunës, italianë dhe të huaj, mund të drejtohen në këtë zyrë. Asistentët socialë ndihmojnë personat që ndodhen në vështirësi ofrojnë informacione të dobishme mbi:
- asistencën shtëpijake për pleqtë, për të miturit, për personat me të meta fizike dhe mendore;
- mbështetjen ekonomike familjes dhe vetë personit;
- asistencën për strehim;
- inserimentin e të miturve në strukturat kompetente;
- adoptimet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- librezën e parkimit falas për personat me të meta fizike;
- tarifat më të ulëta për transportin publik;
- autorizimin për mencën sociale dhe/ose strehimin gjatë natës, etj.

196. Çfarë janë shërbimet edukative?
Në çdo komunë ndodhet zyra e Shërbimeve Edukative që ofron informacione mbi shërbimet e mëposhtme:
- shërbimet e ristoracionit (menca) për shkollën;
- qëndrat verore, dimërore dhe në shkolla;
- çertifikatat mbi frekuentimin e çerdhes dhe të kopshteve komunale;
- rregjistrimin në çerdhe;
- rregjistrimin në kopësht, etj.

197. Çfarë janë shërbimet kulturore, sportive dhe të kohës së lirë?
Në çdo komunë ndodhet zyra e Shërbimeve kulturore, sportive dhe të kohës së lirë që merret me promovimin, organizimin dhe realizimin e nismave kulturore dhe sportive në komunë ofron informacione mbi shërbimet e mëposhtme:
- bilibloteka
- menaxhim i hapsirave dhe lokaleve
- qëndrat sportive të Komunave;
- qëndrat verore;
- rregjistrimet në Urdhërat dhe Shoqatat Kulturore, Sportive dhe ONLUS,

6 Strehimi

I huaji, për të qëndruar në Itali, ka nevojë për garancinë e një vendbanimi. I huaji mund të mikpritet në banesën e dikujt, të marrë me qira një banesë vetë ai apo ta blejë atë. Në raste vështirësish, i huaji mund të qëndrojë pranë një Qëndre Pritjeje që në këtë rast i shërben atij si banesë.

198. Qëndroj në banesën e familjarëve/miqve të mij, çfarë detyrimesh kam?
Jo ti, por ai që të mikpret ka detyrime. Personi, cilido qoftë ai, i cili ofron banesën apo mban në shtëpinë e tij, një të huaj, është i detyruar të njoftojë autoritetet e sigurimit publik (me një deklaratë mikpritje) në rastet kur:
- i jep me qira banesën apo një pjesë të saj;
- i kalon një të huaji pronësinë e banesës;
- i ofron edhe pjesërisht, me qëllim strehimi, një banesë e cila ndodhet në territorin e Shtetit.

199. Ky akt është i detyrueshëm për të gjithë qytetarët?
Po, me përjashtim të Kolegjit të Shenjtë dhe të Trupit diplomatik apo konsullor, çdo qytetar ose shoqatë, subjekt privat ose publik, duhet të njoftojë autoritetet e SP, edhe në rastin kur personat, të cilëve i ofron banesën, janë kushërinj apo të afërm.

200. Në çfarë mënyre duhet të bëj komunikimin?
Komunikimi duhet bërë në formë të shkruar brënda 48 orësh, me letër të shpejtë rrakomanda me letër kthimi që dëshmon marrjen e letrës nga autoritet e SP përgjegjëse.

Vini re: Ligji n. 99/2013 parashikon se komunikimi që duhet të bëj personi që pret një të huaj, e nëse se i huaji është punonjës i punësuar nga po i njejti person, kryhet me anë te komunikimit të detyrueshëm për punësim.

201. Kujt duhet t'ja dërgoj?
- kuesturës në krahinat kryesore të provincave;
- komunave në rastet e tjera;
- qendrës së punësimit përgjegjëse për zonën, sëbashku me dërgimin e komunikimit që kërkohet në rast se akomodimi është vënë në dispozicion nga punëdhënësi.

202. Çfarë të dhënash duhet të përfshijë në komunikim?
- të dhënat personale të personit që ofron banesën (emër, mbiemër, data dhe vendlindja, rezidenca);
- të dhënat personale të të huajit (emër, mbiemër, data dhe vendlindja, rezidenca, lloji i dokumentit të identifikimit, numri i dokumentit, data dhe vendi i lëshimit të dokumentit);
- adresën e saktë të banesës ku do të qëndrojnë i huaji ose të huajt.
- titullin e lëshimit të ndërtesës me qëllim strehimin, për shembull, me qera, pa qera, në pronësi, etj; ose të deklarojë thjesht mikpritjen e tij pa qëllim fitimi**.**

Vini re: Ligji 94/2009, Kushdo që ofron banim, duke marrë pagesë, për të fituar avantazh të padrejtë, ose jep me qera një banesë një të huaji pa lejeqëndrimi ose me titull të skaduar dhe të pa ripërtritur, ndëshkohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet. Pasi dënimi të jetë përfundimtar, banesa konfiskohet, me përjashtim të rastit kur pronari është një person tjetër.

6.1 Banesë me qera

203. Si duhet të veproj për të marrë një banesë me qera?
Duhet të nënshkruash një kontratë qeraje. Me këtë kontratë, pronari i shtëpisë, detyrohet t'i lëshojë qeramarrësit ndërtesën, me qëllim banimi, për një kohë të caktuar, kundrejt një pagese të caktuar. Qeramarrësi i paguan qiranë, pronarit të banesës, zakonisht një herë në muaj. Qeraja mund të ndryshojë çdo vit sipas treguesve ISTAT duke u rritur në masën 75% të këtyre të fundit.

204. Çfarë është kapari?
Kapari është shuma që qeramarrësi i jep pronarit të shtëpisë si garanci për çdo dëmtim të shtëpisë. Kapari nuk mund të jetë më i lartë se shuma e qerasë së 3 muajve. Në rast se shtëpia nuk dëmtohet kapari i kthehet plotësisht qeramarrësit në mbyllje të kontratës, duke përfshirë edhe rritjen në interesa.

205. Çfarë forme duhet të ketë kontrata e qerasë?
Sipas ligjit, kontrata e qirasë duhet të jetë në formë të shkruar sipas formës që ka dhe duhet të përcaktoje:
- sa duhet t`i paguajë çdo muaj qeramarrësi pronarit të shtëpisë;
- për sa kohë qeramarrësi mund të qëndrojë në banesë;
- në cilën ditë të muajit duhet paguar qiraja.

Dy llojet kryesore të kontratave të parashikuara nga Ligji 431/98 janë:
- kontrata e lirë, e cila përcaktohet në varësi të zhvillimit të tregut të qerave, sipas ofertës dhe kërkesës. Ka një kohëzgjatje prej 4 vjetësh dhe, në rast se nuk prishet 6 muaj përpara përfundimit të saj, ripërtrihet për 4 vjetë të tjera me të njëjtat kushte të kontratës së parë. Kontrata mund të prishet edhe në përfundim të 4 vjetëve, në rast nevoje të qeradhënësit apo të familjarëve të tij, deri në brezin e dytë, apo me qëllim mirëmbajtjen e banesës.
- kontrata e konkorduar përcaktohet në një marrëveshje midis Organizatave Sindakaliste të pronarëve me pjesëmarrjen e Bashkive. Ka një kohëzgjatje prej 3 vjetësh plus 2 vjet të tjera. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, si pronari ashtu edhe qeramarrësi, gëzojnë mundësinë e një zbritjeje prej 30% të taksës së rregjistrimit, e zbritjes së taksave mbi të ardhurat si edhe, nga Bashkia, një ulje apo heqjen e taksës bashkiake mbi ndërtesat (ICI).

206. Rregjistrimi i kontratës është i detyrueshëm?
Po. Sipas ligjit, pronari i shtëpisë duhet të rregjistrojë kontratën e qirasë, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi, pranë zyrës së rregjistrit. Taksa e rregjistrit është sa 2% e qirasë në bazë vjetore. Shpenzimet e rregjistrimit duhet të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit. Rregjistrimi duhet të ripërtrihet çdo vit. Përsa i përket kontratave shumëvjeçare, taksa e rregjistrit mund të paguhet në një herë të vetme edhe për vitet në vijim të parashikuara në kontratë. Në këtë rast, parashikohet një zbritje në shpenzimet e rregjistrimit. Përveç kësaj, kur kontrata e qirasë është e rregjistruar në mënyrë të rregullt, mund të marrësh pjesë në garat që publikon bashkia, si kontribut, në përballimin e shpenzimeve të qirasë, kundrejt personave, të cilët, kanë të ardhura vjetore të ulta.

Vini re: Në rast se kontrata nuk rregjistrohet atëherë nuk është e vlefshme për të treguar që i huaji banon në mënyrë dinjitoze me qëllim ripërtritjen e lejeqëndrimit.

6.2 Blerja e banesës

207. Mund të blej një apartament?

Të huajt, të pajisur me lejeqëndrim të rregullt për motive pune apo familjare, ose me leje qëndrimi BE per banoret me afat te gjate, mund të blejnë banesën në kushte të barabarta me qytetarët italianë. Ndërsa të tjerët mund të blejnë shtëpi vetëm nëse ekziston një marrëveshje specifike midis vendit përkates dhe Italisë. Në rastin e blerjes së shtëpisë së parë, ekzistojnë lehtësime mbi taksat e banesës (taksa e rregjistrit, e hipotekës, e kadastrës).

208. Çfarë dokumentash duhet të nënshkruaj për të blerë një banesë?

- Propozimin për blerje, me nënshkrimin e të cilit bllokohet çmimi i banesës për të cilin është rënë dakort, nënshkruhet një propozim i pakthyeshëm blerjeje si edhe derdhet një pjesë e të hollave nga çmimi i banesës;
- premtimin e shitjes apo kompromisin, një marrëveshje paraprake, nëpërmjet të cilit palët impenjohen në nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes *(rogito)*, duke caktuar datën, nëse nuk është e mundur që të nënshkruhet menjëherë. Me nënshkrimin e kompromisit, zakonisht, pasi nuk është i detyrueshëm, derdhet një pjesë e të hollave nga çmimi i banesës;
- aktin publik të shitjes, i cili ka për qëllim transferimin e pronësisë së banesës. Ky akt, i cili nënshkruhet përpara noterit *(rogito notarile)*, me pjesëmarrjen e shitësit dhe të blerësit, ka vlerën e një akti publik.

209. Çfarë është kredija?

Nëse nuk ke në dispozicion të gjithë shumën e të hollave që të nevojiten për përblerje e banesës, mund të kërkosh borxh në një bankë nëpërmjet hapjes së një kredije në bazë hipoteke. Banka, nga ana e saj, për të siguruar kredinë e dhënë, vendos hipotekën mbi banesën e blerë. Nëse të ardhurat e blerësit nuk janë të mjaftueshme për të paguar këstin e kredisë, atëherë, banka kërkon garancinë *(fideiussione)* e një personi tjetër apo të një subjekti, i cili impenjohet personalisht, me të mirat e tij materiale, në shlyerjen e borxhit në se ti nuk mundesh. Hipoteka, është një formulë e cila i lejon bankës, në rastin kur nuk paguhen këstet e kredisë, të pronësojë banesën si edhe ta shesë atë me qëllim nxjerrjen e të hollave të kredisë. Në rastin e blerjes së shtëpisë së parë mund të përfitosh nga një kredi me interesa më të ulta në krahasim me interesat që bankat kanë zakonisht.

Vini re: Nëse dëshiron të marrësh kredi bankare, verifiko me bankën, nëse i plotëson të gjitha kushtet, përpara se të nënshkruash propozimin për blerjen e banesës.

210. Çfarë kushtesh duhet të plotësosh në mënyrë që banka të të japë kredi?

Banka, për të miratuar kredinë, kërkon disa garanci si për shembull:

- deklaratën e të ardhurave;
- derdhjen çdo muaj të pagës në bankë (në disa raste nuk është e detyrueshme);
- garanci personale ose nëpërmjet të mirave të tua materiale.

211. Çfarë përcaktohet në një kontratë kredije?
Kushtet kryesore të cilat përcaktohen në një kontratë kredije janë:
- kohëzgjatja e kthimit të kredisë (nga 5 deri në 30 vjet), duke marrë parasysh gjithmonë moshën e atij që kërkon kredinë;
- taksa e interesit të kredisë (tavani i taksës së interesit përcaktohet me ligj i cili ndalon fajdet); taksat e interesave kanë skadenca të ndryshme (mujore, tremujore, etj.) dhe përcaktohen në bazë të treguesve të referimit të cilët publikohen në shtypin e përditshëm (psh. treguesit EURIBOR, EUIRS) duke i shtuar edhe një shumë tjetër të hollash që e vendos banka e cila ndryshon nga një bankë në tjetrën, quhet SPREAD;
- shuma e kështit që duhet paguar edhe plani i kthimit të të hollave (frekuenca me të cilën paguhen kështet); kësti që duhet paguar duhet të jetë i përballueshëm në bazë të të ardhurave të personit;
- shuma, në të holla, e dënimit, në se vendos t`a mbyllësh kredinë përpara afatit të caktuar.

212. Kush i përpilon kontratat e kredisë për banesën?
Si kontratën e shit-blerjes së banesës, ashtu edhe kontratën e kredisë e përpilon dhe e rregjistron një noter.

213. Çfarë shpenzimesh duhet të përballoj në momentin e blerjes së banesës?
Taksën e rregjistrit (me kushte lehtësuese për shtëpinë e parë);
- TVSH, nëse banesa blihet nga një ndërmarrje;
- taksën e hipotekës;
- taksën e kadastrës;
- shpenzimet e noterit për dy kontratat që ai ka përpiluar dhe rregjistruar.

214. Çfarë shpenzimesh duhet të përballoj si qiramarrës apo si pronar i banesës?
Duhet të paguash faturat (e gazit, elektrikut, ujit, ngrohjes, telefonit, në se ke instaluar linjën telefonike, si edhe shpenzime të tjera mbi hapsirat dhe shërbimet e përbashkëta të ndëtesës) një herë në muaj apo një herë në dy muaj, si edhe taksën e plehrave një herë ose dy herë në vit. IMU –ja e taksave të tjera reth pronësive që janë pasuri të patundshme.

6.3 Qëndrat e pritjes

215. Çfarë janë qëndrat e pritjes?
Janë struktura të cilat garantojnë, në bazë të vendëve në disposizion, një sërë shërbimesh shoqërore dhe ofrojnë strehim të përkohshëm, me qëllim favorizimin e pavarësisë dhe integrimit shoqëror të të huajve sa më shpejt që të jetë e mundur.

216. Mund të shkoj në qendrat e pritjes?
Vetëm në rast se je i huaj dhe ke një lejeqëndrimi me një kohë të gjatë ose për motive pune, familiare dhe papunësie, si edhe nuk ke mundësi të tjera.

217. Kush nuk ka të drejtë të shkoj në qendrat e pritjes?
- Të huajt pa lejeqëndrimi apo të parregullt, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme (të vendosura nga kryetari i bashkisë);
- të huajt me lejeqëndrimi për motive turizmi, studimi, biznesi, kura mjeksore dhe lloje të tjera lejeqëndrimi me kohë të shkurtër.

218. Strehimi në qendrat e pritjes është falas?
Mund të jetë falas ose me pagesë (qira).

219. Kam detyrime gjatë qëndrimit në një qendër pritjeje?
Po, duhet të respektosh rregulloren e qëndrës.

SHTËPITË POPULLORE DHE KOOPERATIVAT NDËRTIMORE

220. Çfarë janë?
Janë banesa të ndërtura me anë të financimit publik dhe janë pronë e subjekteve publike, me qëllim strehimi.

221. Kush mund të përfitojë nga shtëpitë popullore?
Të huajt me lejeqendrimi BE për residentët afat gjatë, të huajt që banojnë rregullisht me lejeqëndrimi me afat të paktën dy vjeçar dhe që ushtrojnë një punë të rregullt fitimprurëse ose vetëpunësim kanë të drejtë të aplikojne, në mënyrë të barabartë me qytetarët italianë, për shtepite popullore dhe shërbimet ndërmjetësuese, agjencitë sociale të cilat ofrojnë në çdo rajon apo organizatat lokale për të lehtësuar aplikimin për shtëpite popullore dhe kreditit të subvencionuar në fushën e ndërtimit, rehabilitimit, blerjen dhe dhënien me qira të shtëpisë. (Në bazë të nenit nr. 40. Ligji 286/1998).

222. Si mund të hyj në shtëpitë popullore?
Ata që dëshirojnë të kenë një banesë publike (të ashtuquajturat shtëpi popullore) duhet të paraqesin një kërkesë në komunën e rezidencës me anë të një formulari të veçantë, në dispozicion në komunë, përmes një letre të rakomanduar me letër kthimi. Banesat do të caktohen në bazë të një liste publike, të hartuar në përputhje me kushtet ekonomike, familiare dhe strehimore të personave/familjeve që kanë bërë kërkesë. Për më shumë informacion, kontaktoni zyrën e marrëdhënieve publike të komunës së rezidencës.

223. Çfarë është Kooperativa Ndërtimore?
Kooperativa ndërtimore është një subjekt që ka për qëllim ndërtimin apo blerjen e banesave për llogari të ortakëve që bëjnë pjesë në kooperativë. Ortakët e kooperativës duhet të kenë disa cilësi të caktuara (rezidencë në komunë, të ardhura të ulta, mos të kenë në pronësi objekte të tjera, etj). Blerja e një shtëpije nëpërmjet kooperativës ka në përgjithësi kushte të favorshme sepse kooperativat kanë lehtësira tatimore e për sa i përket kredisë.

224. Mund të jem ortak në një kooperativë ndërtimore?
Po, qytetarët e huaj mund të jenë ortakë në një kooperativë ndërtimore.

7 Shëndetsia

7.1 Rregjistrimi në Shërbimin Shëndetsor Kombëtar (SSN)

Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (SSN) përbëhet nga struktura dhe shërbime të cilat garantojnë mbrojtjen e shëndetit dhe ndihmë shëndetësore për të gjithë qytetarët, si italianë ashtu edhe të huaj. Qytetari i huaj rezident në Itali me lejeqëndrim të rregullt gëzon të drejtën e ndihmës shëndetësore, të ofruar nga SSN, në mënyrë të barabartë me qytetarin italian. Ndihma shëndetësore u garantohet jo vetëm të rregjistruarve por edhe familjarëve që ata kanë në ngarkim të cilët kanë lejeqëndrim të rregullt.

225. Ku kryhet rregjistrimi?
Rregjistrimi kryet pranë Qëndrës Shëndetësore Vendore në territorin ku je rezident ose (nëse nuk ke rezidencë) pranë Qëndrës Shëndetësore Vendore në territorin ku ke adesën që ke shënuar në lejeqëndrim ose vendbanimin.

226. Çfarë është Qëndra Shëndetësore Vendore?
Qëndra Shëndetësore Vendore (ASL) është bashkësia e spitaleve, ambulancave, konsultoreve dhe zyrave që në një territor të caktuar (për shembull një provincë), kujdeset për shëndetin e popullsisë. Pranë Qëndrës Shëndetësore Vendore kërkohet regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (SSN) dhe zgjidhet mjeku i familjes.

227. Mund të rregjistrohem në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar?
Rregjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar është i detyrueshëm për qytetarët e huaj titullarë të:
- lejeqendrimit BE për banorët me afat të gjatë;
- lejeqëndrimit për motive pune të varur;
- lejeqëndrimit për motive pune të pavartur;
- lejeqëndrimit për motive rregjistrimi në pritje e punësimit;
- lejeqëndrimit për motive familjare;
- lejeqëndrimit për motive strehimi politik;
- lejeqëndrimit për motive strehimi humanitar;
- lejeqëndrimit për motive pritje adoptimi;
- lejeqëndrimit për motive adoptimi;
- lejeqëndrimit për motive marrje Shtetësie.

Nuk humbasin të drejtën, dhe nëse nuk janë regjistruar mund të regjistrohen, të huajt në pritje të lëshimit apo rinovimit të lejeqëndrimit. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe familjarët kur janë në ngarkim të personit të rregjistruar.
Për të mësuar më shumë, rreth marrëveshjes mes Shtetit e krahinave që përmban "udhëzimet për zbatimin korrekt të legjislacionit për kujdesin shëndetësor të popullatës së huaj nga krahinat dhe Provincat Autonome.

Vini re: Të huajt që hyjnë në Itali për motive kurimi nuk mund të regjistrohen në SSN dhe duhet të paguajnë kurat e kryera. Të huajt refugjatë politik dhe pa shtetësi si dhe bashkëshortët e tyre, kanë të drejta të njëjta si qytetarët italianë në se kanë lejeqëndrim të vlefshëm për strehim politik. Për të miturit, prindërit e të cilëve janë të rregjistruar në SSN, garantohet i njëjti trajtim me të miturit e rregjistruar, që nga momenti i lindjes.

Shtetasit e huaj të cilët kanë lejeqëndrimi për arsye studimi, per motive feje dhe të huaj te tjere mund te rregjistrohen vullnetarisht ne SSN për vete dhe familjet e tyre që jetojnë me ta, ose mund të sigurohen kundër sëmundjeve lëndimeve dhe shtatezanise (siguracioni duhet të vleje në të gjithë Italinë, duke përfshirë edhe familiaret)

228. Kur nuk mund të rregjistrohesh në SSN?
Nuk mund të regjistrohen shtetasit e huaj me banim të rregullt në vend për më pak se tre muaj (viza turistike, vizita, biznes, etj...) dhe të huajt pranishëm pa rregulla në territor.

229. Çfarë dokumentash duhet të paraqes për tu rregjistruar në SSN?
Në përgjithësi, dokumentet që duhet të paraqiten janë:
- lejeqëndrim të vlefshëm; nëse lejeqëndrimit është në fazë ripërtritje, mund të paraqitet leja e skaduar sëbashku me ricevutën e kërkesës së ripërtritjes (e lëshuar nga Kuestura ose nga Posta);
- deklaratë residence dhe të gjendjes familiare (ose deklarate efektive të vëndbanimit sipas lejeqëndrimit);
- kodi fiskal;
- deklaratë ku merr përgjegjësinë e komunikimit të çdo lloj ndryshimi të gjendjes së tij.

Përveç këtyre:
Mund të kërkohen dokumentet të veçanta që ndryshojnë në varësi të llojit të lejes së mbajtur. Për një listë të detajuar të dokumenteve të nevojshme mund të kontrolloni marrëveshjen midis Shtetit dhe krahinave që përmban udhëzime për zbatimin korrekt të legjislacionit për kujdesin shëndetësor të popullatës së huaj nga rajonet dhe provinca autonome.

230. Sa kohë zgjat rregjistrimi në SSN?
Kohëzjatja e rregjistrimin ne SSN ka te njejten kohezgjatje si dhe lejeqëndrimi.

231. Kur mbaron rregjistimi pranë SSN?
Rregjistimi pranë SSN mbaron:
- në se skadon lejeqëndrimi, me përjashtim të rastit kur tregon kërkesën për rinovim ose lejeqëndrimin e rinovuar;
- në se skadon lejeqëndrimi të është anulluar ose mohuar, me përjashtim të rastit kur provon apelimin ndaj faktit;
- në rast dëbimi;
- në rastin kur i huaji nuk plotëson kushtet për të bërë pjesë në kategoritë për të cilat parashikohet rregjistrimi i detyruar në SSN (për shembull: ndërrimi i motivit të lejeqëndrimit për të cilin nuk parashikohet rregjistrimi i detyruar në SSN, përfundimi i aktivitetit të punës ose i rregjistrimit në listat e punësimit përtë huajin që nuk është titullar i një lejeqëndrimi për të cilën nuk parashikohet rregjistrimi i detyruar në SSN).

232. Cilat janë dokumentat dhe shërbimet shëndetësore që përfitojnë të regjistruarit në Shërbimin Shëndetsor Kombëtar?

- libreza shëndetësore;
- zgjedhja e mjekut të familjes dhe pediatrit për të miturit;
- vizita mjeksore të përgjithshme në ambulancë dhe vizita mjeksore të specializuara;
- vizita mjeksore në shtëpi;
- shtrim në spital;
- vaksinimi;
- analiza gjaku, radiografi, ekografi, etj
- receta për ilaçe;
- çertifikata mjeko-ligjore;
- ndihmë për riaftësim, proteza, etj.

Vini re: ekzistojnë disa shërbime që garantohen edhe nëse nuk je i rregjistruar në Shërbimin Shëndetsore Kombëtare. Janë të siguruara: mjekimet ambulatoriale e spitalore urgjente ose thelbësore, ose të vazhdueshme, për sëmundje dhe lëndimi dhe janë zgjeruar programet parandaluese të mjekësisë për të ruajtur shëndetin individual dhe kolektiv.
Në mënyrë të veçantë garantohen:
- trajtimi i shtatzënisë dhe lehonisë;
- kujdesi i fëmijës;
- vaksinat;
- programet e profilaksisë;
- parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi i sëmundjeve infektive;
- kujdesi, parandalimi dhe rehabilitimi në fushën e varësisë nga droga.

7.2 Libreza shëndesore

233. Çfarë është libreza shëndetësore?

Është dokumenti që lëshohet në Qëndrën Shëndetësore e që provon rregjistrimin në SSN. Është e domosdoshme për të përfituar shërbimet shëndetësore. Libreza shëndetësore përmban:

- të dhenat personale të personit dhe kodin fiskal;
- datën e skadencës, e vlefshme vetëm për asistencën shëndetsore;
- një hapësire të lirë për të shenuar, nëse ka, të dhena shëndetsore rajonale, e tre shkrojna "braille" për të verbërit;
- kodin fiskal në format barcode e bandë magnjetike.

234. Si të veproj në rast se humbas librezën shëndetësore?

Duhet të denoncosh humbjen pranë autoriteteve kompetente dhe të kërkosh një tjetër pranë Qëndrës Shëndetësore Vendore.

7.3 Shërbimet shëndetsore

235. Kush është mjeku i familjes?

Është profesionisti që siguron kurat e mjeksore të përgjithshme:

- viziton pacientët në studjon e tij ose në shtëpinë e të sëmurit kur kushtet e këtij të fundit nuk e lejojnë të shkojë tek mjeku;
- lëshon receta për ilaçe, analiza dhe vizita të specializuara;
- propozon shtrimin në spital nëse është i nevojshëm;
- lëshon çertifikata.

236. Kush është pediatri i bazës?
Është mjeku që ndjek fëmijët, i viziton kohë pas kohe, kontrollon rritjen e tyre, lëshon receta për ilaçe, analiza dhe vizita të specializuara, propozon shtrimin në spital në se është i nevojshëm, lëshon çertifikata.

237. Si mund të zgjedh mjekun e familjes dhe pediatrin?
I huaji i regjistruar në SSN mund të zgjedhë mjekun e familjes dhe pediatrin për fëmijët e moshës nga 0 deri në 14 vjeç të cilët gëzojnë të drejtën e të pasurit falas të mjekut specialist pediatër.
Pranë zyrës ku lëshohen librezat shëndetësore mund të konsultosh një listë mjekësh të disponueshëm. Emri i mjekut të familjes shkruhet në librezën tënde shëndetësore.

238.Çertifikatat e lëshuara nga mjeku i familjes dhe pediatri janë falas?
Janë falas:
- çertifikatat për mungesë nga puna të prindit në rast se ka fëmijën sëmurë;
- çertifikatat për ushtrimin e aktiviteteve sportive në shkollë;
- çertifikatat në rast sëmundjeje dhe dëmtimi fizik ose motive të tjera shëndetësore që nuk të lejojnë të shkosh në punë.

Nuk është falas:
- çertifikata për ushtrimin e aktiviteteve sportive profesionale;
- çertifikata me qëllim kryerjen e sigurimit;
- çertifikata për kërkesën e invaliditetit.

239. Mund të kërkoj zëvendësimin e mjekut të familjes në çdo moment?
Po, duhet të plotësosh një formular; në të njëjtën kohë duhet të tregosh mjekun e ri që ke zgjedhur.

240. Si bëhen vizitat e specializuara?
Për të kryer një vizitë të specializuar është e nevojshme kërkesa nga ana e mjekut të familjes. Me kërkesën e mjekut dhe me librezën shëndetësore duhet të shkosh të prenotosh vizitën në qëndrën shëndetësore vendore. Disa ASL kanë një sistem telefonik për prenotimin e shërbimeve shëndetsore. Këto shërbime mund të kryhen edhe pranë laburatorëve privatë të konvencionuar.

241. Vizitat e specializuara janë falas?
Për të kryer vizitat e specializuara, analizat dhe blerjen e ilaçeve, duhet paguar një kuotë e caktuar nga Shteti, fatura *(ticket)*.
Ilaçet nuk i paguajnë:
- invalidët civilë të shkallës 100%, invalidët civilë të shkallës më të lartë se 2/3, ose ata që kanë çekun e shoqërimit, të verbërit dhe shurdhët;
- viktimat e terrorizmit dhe të kriminalitetit të organizuar;
- pacientët të cilët i nënshtrohen kurave të dhimbshme;

- titullarët e pensioneve shoqërore;
- titullarët e pensioneve prej 60 vjetëve e sipër.

Shërbimet e specializuara janë falas për:
- titullarët e pensioneve shoqërore dhe familjarët që kanë në ngarkim;
- të papunët, titullarët e pensioneve prej 60 vjetëve e sipër;
- invalidët civilë të shkallës më të lartë se 2/3, ose ata që kanë çekun e shoqërimit;
- të dëmtuarit në punë dhe të gjitha kategoritë e qytetarëve të parashikuara

Disa shërbime mjeksore, janë falas, edhe nëse qytetari nuk bën pjesë në asnjërën prej kategorive të mësipërme. Ato janë:
- shërbimet për diagnostikimin e parakohshëm të tumoreve (mamografitë, papteste, etj);
- shërbimet e parashikuara për mbrojtjen e gruas gjatë shtatzanisë, për shembull analiza të ndryshme, ekografi, etj;
- shërbimet e parashikuara në kuadrin e dhurimin e gjakut, të organeve, vaksinave jo të detyrueshme për fëmijët deri në moshë 14 vjeç.

242. Si të veproj për të përfituar shërbimet falas?

Duhet të paraqesësh kërkesën në Qëndrën Shëndetësore Vendore të bashkëngjitur me çertifikatën e mjekut specialist ose spitalor, librezën shëndetësore dhe kodin fiskal. Qëndra Shëndetësore Vendore lëshon një librezë që lejon një maksimun prej 6 recetash për ilaçet që duhen për një sëmundje të caktuar. Kohezgjatja e perjashtimit mund të jetë e përhershme ose e përkohshme, sipas llojit të sëmundjes dhe rregullares rajonale. Skadenca e ketyrë librezave që lejojnë marrjen e ilaçeve pa pagese është e shënuar mbi çertifikatë.

Vini re: Ligji mbi shërbimet falas mund të pësojë ndryshime. Për informacione më të hollësishme mbi shërbimet falas në fuqi si edhe mbi dokumentat që duhen paraqitur, mund të drejtohesh tek mjeku i familjes apo pediatri që ke zgjedhur.

243. Cilat janë shërbimet e urgjencës?

Në rastet e urgjecës (aksidente, dëmtime dhe çdo lloj situate e rrezikshme për jetën) mund të shkosh në Urgjencën e Spitalit *(Pronto Soccorso)* ose të kërkosh ndërhyrjen e mjekut duke telefonuar falas në numrin 118 i cili funksionon 24 orë pa pushim.

244. Ndihma spitalore është falas?

Shërbimet spitalore janë falas për të gjithë qytetarët të cilët janë rregjistruar në SSN. Ligji financiar 2006 ka parashikuar që duke filluar nga 1 janari i 2007 një pagesë në ndihmën e shpejtë të spitaleve për ndërhyrjet e klasifikuara si jo urgjente (kodi i bardhë).

245. Çfarë është mjeku i rojes?

Është një shërbim, krejtësisht të lire, i ndihmës së menjëhershme mjekësore në shtëpi, për banorët e rajonit, ndima mund të kerkohet në çdo kohë në raste të nevojës rëndë.
Qytetarët që jetojnë në rajonet e tjera duhet, të paguajne tarifën për vizita të rastit.

246. Ndihma e infermieres parashikohet në shërbimet e SSN?

Aktualisht ky shërbim nuk parashikohet nga SSN. Në rastet e nevojshme mund të ofrohet, në shtëpi, nëse shërbimi social i komunës e sinjalizon rastin tek organet shëndetësore.

247. Mund të detyrohet pacienti të kryejë vizitat dhe shërbimet shëndetësore?

Vetëm në rastet e parashikuara nga ligji (Trajtime Shëndetësore të Detyruara) por gjithmonë duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat civile të njeriut. Këto ndërhyje parashikohen nga Kryetari i Bashkisë, me propozim të mjekut, dhe me konvalidimin e mjekut të strukturës shëndetësore kompetente. Pas 48 orësh nga shtrimi, nisma duhet t'i komunikohet Gjykatësit kompetent.

248. Mund të kundështosh një trajtim shëndetësor të detyruar?
Personi që është detyruar t'i nënshtrohet trajtimit shëndetësor, ose kush është i interesuar, mund të paraqesë apelin pranë Gjykatës kundër vendimit të Gjykatësit, i cili ka konvaliduar vendimin mbi trajtimin mjeksor.

249. Çfarë ndodh nëse qytetari që i nënshtrohet një ndërhyrjeje shëndetsore të detyrueshme është i huaj ose pa shtetësi?
Vendimi duhet t'i komunikohet Ministrisë së Brendëshme dhe Konsullatës së vendit të origjinës së personit. Komunikimin e kryen Prefekti.

250. Çfarë janë konsultoret familjare?
Janë shërbime, shoqërore-shëndetësore të territorit, që mbrojnë shëndetin fizik dhe psiqik të gruas, fëmijës, çiftit dhe familjes. Shërbimet janë falas dhe për t'i kryer ato duhet të prenotohen më parë. Është një shërbim që u ofrohet edhe qytetarëve të huaj.
Në këshillimore gjinden figura profesionale si me kompetenca psikologjike dhe shoqërore: psikologë, asistentë shoqëror, sociologë, ndërmjetës kulturor, ashtu edhe me kompetenca shëndetësore: pediatër, gjinekologë, mami, infermierë, asistentë shëndetësor.

Mund të drejtohesh në konsultoret familjare për shërbimet e mëposhtme:
- këshilla dhe vizita mbi kontraceptimin;
- për t`u ndjekur gjatë shtatzanisë;
- kurse parapërgatitjeje për lindje;
- kontrolle periodike gjinekologjike;
- parandalimin e tumoreve tek femrat;
- këshilla dhe asistencë gjatë periudhës së menopauzës;
- ndihmë pediatrike;
- vaksinimi i detyruar (dhe i rekomanduar);
- këshilla mbi probleme shoqërore dhe psikologjike.

251. Ku ta gjej adresën e kosultores familjare?
Në numratorin telefonik, në zërin "*Aziende sanitarie locali"* për sa u përket Konsultoreve publike dhe më pas në zërin *"Consultori"* për jo publiket ose në faqet web istituzionale e jo të specializuara.

252. Ekzistojnë shërbime të tjera sociale - shëndetësore?
Po, njësitë territoriale të riaaftësimit (UTR) dhe Qëndrat e higjenës mendore (CIM).

253. Cilat vaksina janë të detyrueshme?
Vaksinimet e detyrueshme ndryshojnë nga rajoni në rajon. Në përgjithsi fëmijët, në Itali, janë të detyrueshme vaksinat kundër titanozit, difteritit, poliomolitit dhe hepatitit B. Këshillohen, por nuk janë të detyrueshme, vaksinat kundër lisë së dhenve, kollës së mirë, dhe vetëm për vajzat, kundër rubeolës. Për të rriturit këshillohen vaksinat kundër titanozit dhe hepatitit B viral.

254. Vaksinat e detyrueshme janë falas?
Po.

255. Ku mund ta kërkojnë çertifikatën e vaksinave?
• Për rregjistrim në shkollën fillore;
• për rregjistrim në kopësht;
• për rregjistrim në çerdhe;
• për rregjistrim në qëndrat verore;
• për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të nivelit amatorial, etj.

256. Kush mund të rregjistriohet vullnetarisht në SSN?
Qytetarët e huaj për të cilët nuk është i detyruar rregjistrimi në SSN, duhet të sigurohen kundër rrezikut të sëmundjeve, të dëmtimeve dhe për shtatzaninë. Mund të sigurohen:
- nëpërmjet një sigurimi privat me një institut sigurimesh italjan ose të huaj, i vlefshëm në teritorin kombëtar;
- nëpërmjet rregjistrimit vullnetar në SSN;
- Kanë te drejtë të sigurohen vullnetarisht në SSN (duke paguar një kontribut vjetor):
- studentët;
- personat sipas Marëveshjes së Strasburgut të 24 nëntorit 1969 (e ratifikuar me ligjin e 18 majit 1973 nr. 304);
- titullarët e lejeqëndrimit për ezidencë të zgjedhur që nuk punojnë;
- punonjësit e Ambasadave;
- kategori të tjera që mund të mbeten.

257. Çfarë dokumentash duhet të paraqes për t`u rregjistruar vullnetarisht në SSN?
- Lejeqëndrim të vlefshëm; Nëse lejeqëndrimi është në fazë ripërtritje, mund të paraqitet leja e skaduar sëbashku me ricevutën e kërkesës së ripërtritjes (e lëshuar nga Kuestura ose nga Posta);
- çertifikatë rezidence dhe çertifikatë të gjëndjes familiare (ose deklaratë mbi vendqëndrimin siç e ke të shkruajtur në lejeqëndrim);
- kodin fiskal;
- faturën e pagesës së kryer.

Duhet të plotësojnë praktikën me dokumenta të tjera:
- studentët (autoçertifikatë regjistrimi në kursin e studimeve);
- të huajt të cilët konsiderohen *“collocati alla pari”* (deklaratë).

258. Nëse nuk kam lejeqëndrim të vlefshëm, çfarë të drejtash kam?
Qytetarëve të huaj, të cilët kanë hyrë dhe/ose qëndrojnë në mënyrë të parregullt në Itali pasi nuk kanë lejëqëndrim ose i ka skaduar prej më shumë se 60 ditësh, u sigurohen, pranë strukturave publike dhe të akredituara, kurat urgjente dhe të domosdoshme ambulatoriale dhe spitalore për sëmundje dhe dëmtime, si edhe ndërhyrje me qëllim parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit personal dhe kolektiv, si më poshtë:
- ndërhyrje me qëllim mbrojtjen e shtatzanisë dhe të mëmësisë;
- vaksinime;
- ndërhyrje të profilaksisë ndërkombëtare;
- profilaksi, diagnozë, dhe kurim i sëmundjeve infektive;
- aktivitete me qëllim mbrojtjen e shëndetit mendor.

7.4 I huaji përkohsisht në territorin italian (STP)

Qytetarëve të huaj, të cilët ndodhen në mënyrë të parregullt në territorin italian, u lëshohet një kod identifikimi, i quajtur STP (*Straniero Temporaneamente Presente*), i vlefshëm për 6 muaj dhe i rinovueshëm.
Kur qytetari i huaj ka nevojë për shërbimet mjeksore dhe shkon pranë strukturave ku ofrohen këto lloje shërbimesh, strukturat nuk mund të denoncojnë faktin pranë autoriteteve policore, me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ligji.

259. Mund të përfitoj shërbime shëndetësore edhe në rast se nuk mund t'i paguaj?

Nëse qytetari i huaj nuk mund të paguaj të gjithë sherbimin, mund të paguaj vetëm një pjesë të tij (*quota di partecipazione*).
Qytetari i huaj i cili nuk mund të paguaj shumën e parashikuar (*situazione di indigenza*) mund të mos e paguajë, duke nënshkruar një deklaratë *"dichiarazione di indigenza"*, e vlefshme për 6 muaj.

260. Cilat janë shërbimet që mund të përfitoj, edhe nëse nuk kam mundësi për të paguar?

Ashtu si edhe për qytetarët italianë, edhe i huaji, i cili është i parregullt në territorin italian, në kushte pamundësie për të paguar, mund të përfitojë këto shërbime:
- shërbime shëndetësore të nivelit të parë;
- urgjenca;
- shtatzani;
- patologji të përcaktuara;
- në bazë të moshës ose në gjëndje të rëndë invaliditeti.

8 Arsimi

Në Itali ekziston e drejta-detyra e shkollimit dhe e formimit, e cila fillon në moshën 6 vjeçare. Sistemi kombëtar i arsimit përbëhet nga shkollat publike dhe private. Arsimi i detyruar është ndërtuar në dy cikle shkollimi: i pari, përbëhet nga shkolla fillore dhe nga cikli i dytë i nivelit të parë. Cikli i dytë, përbëhet nga sistemi i shkollave të mesme dhe cikli i shkollimit e formimit profesional. Të gjitha drejtimet e ciklit të dytë të lejojnë të vazhdosh studimet në Universitet.

8.1 Çerdhja

261. Në çfarë moshe mund të rregjistroj fëmijët në çerdhe?
Të gjithe femijet mund te rregjistrohen në çerdhe kur mbushin tre muaj deri në tre vjeç.

262. Sa kohe zgjat çerdhja?
Tre vjet.

263. Kush e administron çerdhen?
Komunat ose subjektet private.

264. Si të veproj për rregjistrimin e fëmijës në çerdhen e komunës?
Duhet të bësh kërkesën në periudhat e caktuara nga Komuna. Në kërkesë mund të përcaktosh deri në 4 çerdhe në rradhë sipas pëlqimit, pavarësisht nga zona ku ti banon. Kërkesa do të konsiderohet sipas pikëve që do të fitojë gjithmonë duke patur parasysh kushtet e punës së prindërve, në se ka apo jo fëmijë të tjerë në ngarkim si dhe probleme të tjera shoqërore dhe shëndetësore. Në këtë mënyrë, sipas prioriteteve përcaktohet rradha e hyrjes. Sipas rradhës (*graduatoria*): ka pak vende dhe shumë kërkesa. Për t`u informuar më mirë mund të drejtohesh pranë komunës së rezidencës meqë kushtet e pranimit ndryshojnë në funksion të rregullave të komunës së referimit.

265. Sa kushton rregjistrimi në çerdhe?
Pagesa është e ndryshme në bazë të të ardhurave; pagesa në çerdhe private përcaktohet nga vetë struktura. Duke u nisur nga viti shkollor 2007-2008 është krijuar një shërbim i ri që i kushtohet fëmijëve 2 vjecarë: Seksionet Pranvera. Janë seksione cerdheje që lidhen me shkollat e foshnjërisë private ekuivalente dhe që i drejtohen fëmijëve nga **24 ne 36 muaj**, të autorizuara për funksionim. Për të përfituar duhet t'i drejtoheni direkt administratorit të shkollës.

8.2 Kopshti

266. Në çfarë moshe mund të rregjistroj fëmijët në kopësht?
Të miturit mund të rregjistrohen në kopësht kur mbushin 3 vjeç brenda datës 30 prill të vitit në vijim.

267. Sa vjet mund të çoj fëmijët në kopësht?
Tre vjet.

268. Kush e administron kopshtin?
Komunat, Shteti ose privatët.

269. Ku duhet të drejtohem për t`u informuar më mirë?
Pranë Departamentit të Shërbimeve Shkollore të Komunës tënde për rregjistrimin në kopësht; pranë sekretarisë të shkollës që të intereson, në rastet e tjera. Për të hyrë në kopshtin publik, duhet respektuar rradha.

270. Sa kushton rregjistrimi në kopësht?
Pagesa është e ndryshme në bazë të të ardhurave. Pagesa në kopshtet private përcaktohet nga vetë struktura.

8.3 Cikli i parë

SHKOLLA FILLORE

271. Në çfarë moshe mund të rregjistroj fëmijët në shkollën fillore?
Për klasën e parë, rregjistrimi është i detyrueshëm në moshën 6 vjeçare, fakoltativ në moshën 5 vjeç e gjysëm (mund të rregjistrohen në kopësht të miturit të cilët mbushin 6 vjeç brenda datës 30 prill të vitit në vijim).

Vini re: Ligji, në lidhje me rregjistrimin fakoltativ në shkollën fillore në moshën 5 vjeç e gjysëm, mund të pësojë ndryshime në të ardhmen. Për informacione më të hollësishme drejtohu në shkollën qe ke zgjedhur.

272. Sa vjet zgjat shkolla fillore?
Pesë vjet.

273. Ku duhet të drejtohem për t'u informuar më mirë?
Pranë Drejtorisë së shkollës përgjegjëse për territorin ose prane Komunes se rresidences, ne rast se behet fjale per nje shkolle shteterore, ose prane shkollave private.

CIKLI I DYTË I NIVELIT TË PARË

274. Çfarë është?
Është një fazë formimi e menjëhershme pas shkollës fillore.

275. Sa zgjat?
Tre vjet.

276. Ku duhet të drejtohem për t`u informuar më mirë?
Pranë Drejtorisë shkollore të shkollës përgjegjëse për territorin ose pranë komunës së rezidencës, në rast se bëhet fjalë për një shkollë shtetërore, ose pranë shkollave private.

8.4 Cikli i dytë

277. Çfarë është cikli i dytë?
Cikli i dytë përbëhet nga sistemi i shkollave të mesme si edhe nga sistemi i shkollim-formimit profesional. Të gjitha drejtimet e ciklit të dytë të lejojnë të vazhdosh studimet në Universitet.

Vini re: duke filluar nga viti shkollor 2010/2011, ka hyrë në fuqi riforma e ciklit të dyte. Bëhet fjalë për një vendim që redukton fragmentimin e adresave në shkollat e ciklit të dytë dhe rimodulon arsimim teknik dhe professional. Bëhet fjalë për një reforme të rëndësishme të karakterizuar nga rirregullimi i ciklit të dytë që sjell edhe rregulla të reja për sa i përket zgjedhjes së adresës së studimit. Gjeni të gjitha informacionet në faqen web www.pubblica.istruzione.it.

278. Mund të kaloj nga njëri drejtim tek tjetri?
Po, madje mund të ndërrosh edhe degën brenda llojit që ke zgjedhur, duke ndjekur nismat didaktike që shkolla të vë në dispozicion; duke filluar nga mosha 15 vjeç, parashikohen mundësi të ndryshme shkollimi:
- studim me kohë të plotë;
- shkollë-punë nëpërmjet praktikës pranë vendeve kulturore, shoqërore dhe prodhuese edhe jashtë Shtetit;
- praktika.

SHKOLLAT E MESME

279. Cilët janë llojet e shkollave të mesme ku mund të studjoj në Itali?
Artistike (perfshin 6 adresa studimi të ndryshme), Klasike, të Shkencave Shoqërore e ekonomike-sociale, i Gjuhëve të huaja, Musikë dhe koreografi, Shkencor e shkenca të aplikuara. Shkolla e mesme është e ndarë në dy periudha per 2 vjetesh, plus një vit i pestë për thellimin dhe orientim disiplinor për arsimin e lartë.

280. Sa zgjat?
Pesë vjet.

281. Në fund të shkollës së mesme, duhet të jap provime?
Po, në fund të vitit të pestë, provimin e Shtetit. Shërben për rregjistrimin në Universitet si edhe për formimin e lartë artistik, muzikor dhe koreografike.

282. Shkollimi teknik dhe shkollimi profesional
Shkollimi teknik zgjat 5 vjet dhe i përgjigjet nevojave të caktuara të realitetit produktiv italian, në mënyrë të vecantë në fushën e tregtisë, të turizmit, të industrisë, të transportit, të ndërtimeve, të bujqësisë dhe të aktiviteteve me karakter social (drejtuar personave). Ekzistojnë shumë drejtime dhe nivele specializimi. Kryesorët janë: llogaritar, teknik tregu, teknik industrial, teknik bujqësor, gjeometer, teknik për turizëm.
Shkollimi profesional zgjat 5 vjet, por parashikon mundësinë e marrjes së kualifikimit profesional pas tre vjeçarit të parë.

Të dy adresat profesionale përfundojnë me një provim shteti dhe lejojnë pjesëmarrjen në tërë shkollat e ciklit të tretë (univeritete, formim i larte artistik, muzikor dhe koreografik – AFAM,

arsim i larte teknik - IFTS).

SHKOLLIM DHE FORMIMI PROFESIONAL (IFP)

283. Çfarë është?
Është një shkollim prej 3 e 4 vjetësh pas të cilëve mund të marrësh çertifikatë kualifikimi profesional, të njohur në nivel kombëtar dhe europian e që mund të shfrytëzohen menjëherë për t`u punësuar.

284. Më pas, mund të rregjistrohem në Universitet?
Po, por vetem nëse ke një diplomë të pakten 4 vjeçare dhe të kesh frekuentuar vitin e pestë të përgatitjes në provimin e Shtetit, i nevojshëm për rregjistrimin në Universitet si edhe në formimin e larte në fushën artistike, muzikore dhe koreografike. Diploma 4 vjecare e marrë në përfundim të shkollimit dhe formimit profesional të jep edhe të drejtën për të vazhduar shkollimin dhe formimin teknik të lartë.

8.5 Universiteti

285. Çfarë është Universiteti?
Është një sistem shkollimi, i ndarë në dy nivele, i cili parashikon për çdo
- nivelin e parë të shkollimit prej tre vjetësh (Diploma);
- nivelin e dytë të shkollimit prej dy vjetësh (Diploma sipas specialitetit).

286. Kush mund të rregjistrohet në Universitet?
Personat që janë të pajisur me Diplomën e Pjekurisë të lëshuar nga një shkollë e mesme mund të rregjistrohen në Universitet.

287. Si të veproj për t`u rregjistruar në Universitet?
Rregjistrimi në Universitetet italjane ndryshon sipas llojit të të huajit:
- qytetarët komunitarë kudo që janë rezidentë ose qytetarët jokomunitarë rezidentë në Itali trajtohen në mënyrë të barabartë me qytetarët italiani në rregjistrim;
- qytetarët e huaj që jetojnë në Itali të pajisur me lejeqëndrim të vlefshëm;
- qytetarët e huaj rezidentë jashtë Shtetit të pajisur me vizë për studime.

288. Çfarë titulli studimi duhet të kem për t`u rregjistruar në Universitet?
Një diplomë të cilën e ke marrë për një periudhë shkollore prej 12 vjetësh. Nëse periudha e studimeve është më e ulët se 12 vjet, studentët duhet të paraqesin, përveç diplomës originale të shkollës së mesme, edhe një çertifikatë shkollore që dëshmon kalimin e të gjitha provimeve të parashikuara:
- për vitin e parë të universitetit, në rast se sistemi shkollor i vendit zgjat 11 vjet;
- për dy vjetët e para të Universitetit, në rast se sistemi shkollor i vendit zgjat 10 vjet.

289. Ku dhe kur duhet të paraqes kërkesën për rregjistrim?
Kërkesa për rregjistrim duhet të paraqitet pranë sportelit të Sekretarisë për Studentët me diplomë të huaj, në afate të njëjta me ato të parashikuara për studentët italjanë: zakonisht, ndërmjet korrikut dhe shtatorit.

290. Çfarë dokumentash duhet të paraqes për t`u rregjistruar?
Diplomën, të përkthyer dhe noterizuar nga përfaqësia diplomatike italjane në vëndin e origjinës.

291. Sa është numri i vendeve në Universitet, të caktuara për studentët e huaj rezidentë jashtë Italisë?
Ligji Dekreti nr. 145 i datës 23 dhjetor 2013 ka eliminuar kuotat për studentë të huaj në Universitet, përjashtuar procedurat për hyrje në fakultete me numër të kufizuar.

292. Nëse kam një diplomë të gjuhës italjane, ky fakt më ndihmon në rradhën e studentëve të huaj për të hyrë në Universitetet italjane?
Po, sipas Universiteteve, mund të të ndihmojë:
- diploma e gjuhës dhe kulturës italjane marrë pranë Univeriteteve për të huajt të Perugia-as e Siena-ës;
- çertifikata e njohjes së gjuhës italjane e lëshuar nga Universiti i III-të i Studimeve në Romë, ose nga Universiteti për të huajt i Perugia-as dhe Siena-ës;
- çertifikata e njohjes së gjuhës italjane e lëshuar jashtë Shtetit.

293. Jam një student universitar. Mund të rinovoj lejeqëndrimin pë motive studimi?
Vizat dhe lejeqëndrimet për motive studimi u ripërtrihet studentëve të cilët:
- në vitin e parë të studimeve kanë kaluar një provim dhe në vitet në vijim të paktën dy provime;
- në rast se studenti ka probleme të rënda shëndetësore, të dokumentuara,
- lejeqëndrimi mund të rinovohet edhe kur ka kaluar vetëm një provim.

Lejeqëndrimi nuk mund të ripërtrihet për më shumë se 3 vjet nga data e përfundimit të kursit të studimeve.

Vini Re: Ligji n. 128 i datës 28 nëntor 2013 ka ndryshuar kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit për studim, duke deklaruar se do të jetë shumë vjeçare, e barabartë me kohën e kursit të studimit ose trajnimit, përveç nëse një auditim të fitimit vjetor. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi sapo rregullorja për zbatimin e Teksitit të vetëm do të rregullohen me rregullat e reja.

294. Kam ardhur në Itali për të frekuentuar Universitetin. Mund të ndërroj degë?
Po, vetëm me autorizim të Universitetit.

295. Mund të kërkoj ripërtritjen e lejeqëndrimit për të kryer specializimin apo doktoraturën?
Po.

296. Sa kushton rregjistrimi në Universitet?
Varet nga Universiteti dhe nga fakulteti që zgjedh. Në çdo rast, shpenzimet e arsimit universitar mund të jenë të larta.

297. Mund të përfitoj një bursë studimi apo ndihma të tjera ekonomike?
Po, studentët e huaj mund të përfitojnë, ashtu si edhe studentët italjanë, shërbime të ndryshme për të ndihmuar studimet: bursa studimi, ndihma ekonomike dhe strehim. Krahinat, mund të lejojnë edhe ndjekjen falas të Universitetit nga studentët e huaj të cilët ndodhen në kushte të

rënda ekonomike, të dokumentuara. Për hollësira të mëtejshme mund të drejtohesh në Sekretarinë e Studentëve të Huaj në Universitetin që dëshiron të frekuentosh.

8.6 Shkollimi dhe formimi teknik i lartë

298. Për çfarë shërben?
Janë shkollime të nje specializimi të lartë teknik e profesional me kohëzgjatje të ndryshme nga një deri në dy vjet, që përfshijnë edhe praktika prodhuese me afate të gjata. Përgatisin teknikë të nivelit të lartë shumë të kërkuar nga tregu i punës.

299. Kush e administron?
Formimi IFTS bën pjesë në programin e planit formues të Rajoneve, sipas një plani 3 vjecar.
Për të njojtur të gjitha llojet formimeve, shiko faqen web *http://www.indire.it/ifts/nuovo* , ose http://www.bdp.it/ifts/2003/home.php .

300. Sa kushton ndjekja e një kursi?
Zakonisht është falas; në disa raste, parashikohet edhe një rimbursim në bazë të orevë.

301. Çfarë kërkesash duhet të plotësoj për tu pranuar në një kurs formimi profesional?
Mund të marrin pjesë në këto kurse të rijtë dhe të rriturit që kanë një diplomë të shkollës së mesme, dilpome profesionale teknike, të mbrojtur në përfundim të një kursi formimi profesional katërvjeçar.
Pjesmarrja u lejohet edhe atyre që janë pranuar në vitin e pestë të shkollës së mesme e atyre që nuk kanë diplomën e shkollës së mesme. Për këta të fundit aktivizohen procedura për të verifikuar kompetencat që kanë marrë gjatë formimit në punë pasi kanë kryer arismin e detyrueshëm.

8.7 Njohja e titujve të studimeve

302. Dëshiroj të vazhdoj studimet në Itali. Si duhet të veproj?
Duhet të paraqesësh kërkesën pranë Universitetit ose Institutit që të intereson. Në kuadrin e autonomisë dhe të marrëveshjeve dypalëshe si edhe të konventave ndërkombëtare në këtë fushë, janë ato që vendosin për njohjen e titujve të huaja të studimeve.
Kërkesës i bashkëngjiten dokumentat e mëposhtëm:
- fotokopje e diplomës së pjekurisë e përkthyer, legalizuar dhe e autentifikuar nga përfaqësia diplomatike italjane e vendit;
- fotokopje e diplomës universitare, e përkthyer, legalizuar dhe e autentifikuar nga përfaqësia diplomatike italjane e vendit;
- çertifikatë e provimeve universitare, e përkthyer dhe e legalizuar;
- programi i studimeve që ke kryer;
- fotokopje e dokumentit të identitetit apo të lejëqëndrimit.

303. Çfarë ndodh më pas?
Autoritetet e shkollës marrin në shqyrtim titullin tënd të studimeve, duke e

konsideruar të barasvlefshëm të gjithin ose një pjesë të tij me diplomën universitare italjane: në rastin e parë, të njihen të gjitha provimet; në rastin e dytë, vetëm disa prej tyre. Universiteti duhet të vendosë brenda 90 ditësh nga dorëzimi i kërkesës.

8.8 Njohja e titujve profesionalë

304. Kam kryer shkollën ku kam marrë një titull profesional. Ku duhet të drejtohem, në Itali, për njohjen e titullit të studimeve?
Duhet të bësh kërkesë pranë autoriteteve përgjegjëse. (vizito faqen web http://www.integrazionemigranti.gov.it/archiviodocumenti/lavoro/Documents/elenco.pdf)

305. Sa kohë zgjat njohja e titujve të studimeve?
Brenda tridhjetë ditësh nga data e marrjes së kërkesës, autoriteti përkatëse merr në shqyrtim dokumentacionin. Brënda katër muajsh nga paraqitja e kërkesës si edhe plotësimi i saj, autoriteti përkatëse nxjerr një dekret mbi njohjen e titullit tënd të studimeve.

306. Jam mjek/infermier. Ku duhet të drejtohem?
Për titujt në fushën e infermierisë dhe mjeksisë, duhet t'i drejtohesh Ministrisë së Shëndetësisë.

307. Jam avokat / llogaritar / biolog / kimist / agronom / gjeolog / inxhinjer / psikolog / konsulent pune / gjeometër / gazetar / punonjës i kuaifikuar në bujqësi dhe industri. Ku duhet të drejtohem, në Itali, për njohjen e titullit të studimeve?
Ministria kompetente për njohjen e titujve profesional të mësipërm është Ministria e Drejtësisë.

308. Jam konsulent për pronësinë industriale/ndërmjetës tregëtar. Ku duhet të drejtohem?
Ministria kompetente është Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

309. Jam mësues. Ku duhet të drejtohem?
Ministria kompetente për njohjen e titujve profesional të mësipërm është Ministria e Arsimit, e Universitetit dhe e Punës Shkencore.

9 Mbrojtja e të drejtave dhe diskriminimi

9.1 Mbrojtja e të drejtave

310. A është e mundur për një qytetar të huaj të mbrojë me gjygj të drejtat e tij?
Po, në të njëjtën mënyre si edhe qytetaret italianë. Po të jesh në pozitë të paligjshme, të veprosh me gjygj për tutelimin e të drejtave tua, nuk e pengon Shtetin të aplikojë largimin tënd nga territori i Shtetit, me përjashtim të rasteve të vecanta.

311. Në cilat organe mund të mbroj të drejtat e mia?
Në Gjykatat e sistemit italian nëpërmjet një avokati mbrojtës.

312. Si është i strukturuar sistemi gjygjësor italian?
Mund të ekzistojnë më shumë se një gjykates para të cilëve të mund të mbrosh të drejtat e tua: gjykatesi civil, penal dhe administrativ, kompetencat e të cilëve janë të përcaktuara nga ligjet e Shtetit italian.

313. Kush është gjykatësi i paqes?
Eshtë një gjykatës nderi të cilit mund t'i drejtohesh për të zgjidhur mosmarrveshje të vogla administrative që nuk kapërcejnë një vlerë të caktuar (p.sh grindje midis banorëve të pallatit), vendos mbi mosmarrveshjet qe lidhen me kodin rrugor, ka kompetenca penale të kufizuara dhe konfirmon vendimet e prefektit në fushën e dëbimit nga territori i shtetit dhe vendimet e shoqërimit në kufi ose të mbajtjes së detyruar në një qendër pritjeje të përkohshme, të nxjerra nga Kuestori.

314. Cilit gjykatës duhet t'i drejtohem për çështjet lidhur me titullin tim të qëndrimit?
Gjykatës administrative rajonale dhe po të jetë e nevojshme, mund të çosh në gjygjin e apelit vendimet e këtij gjygjtari në Këshillin e Shtetit që i ka zyrat ne Romë. Gjykatës civile në fushën e unitetit familjar (psh. bashkimi familjar).

315. Sa kushton proçesi gjygjësor?
Ekzistojnë kosto fikse që lidhen me tipin e mosmarrveshjes që diskutohet dhe që i shtohen kostos së mbrojtjes të parapërgatitur nga avokati yt. Në cdo rast shteti italian i garanton të gjithëve të drejtën për t'u mbrojtur të drejtat e veta, prandaj, në mungesë të mjeteve ekonomike të nevojshme, mund të përfitohet nga patronazhi falas, me shpenzimet e shtetit, me kushtet e vendosura nga ligjet shtetërore.

316. Nëse nuk mund të paguaj një avokat, mund të kem një avokat zyre?
Jo, Shteti të garanton mundësine për t'u përfaqsuar nga një avokat i besuar i zgjedhur nga ti vetë, duke përfituar nga patronazhi falas me shpenzimet e shtetit, nëse je present në mënyrë të rregullt dhe nuk i kalon kufijtë e të ardhurave të parashikuara nga ligji; është e nevojshme që të ardhurat vjetore që rezultojnë nga deklarimi i fundit të ardhurave, të mos jetë më shumë se 10.766,33 € (korrik 2012).

317. Me kanë denoncuar dhe nuk njoh një avokat: çfarë mund të bëj?
Në këtë rast mund të caktohet një avokat zyre, i zgjedhur nga një listë e posacme. Po të kalosh kufijtë e të ardhurave dhe nuk mund të përfitosh nga patronazhi falas, duhet të bësh pagesën e duhur në bazë të tarifave të parashikuara.

318. Cfarë ndodh nëse nuk arrij të kuptoj vendimet gjygjësore?
Ke të drejtë të caktosh një përkthyes që të përkthejë vendimet gjyqsore në gjuhën time. Kostoja e përkthyesit mund të vihet në ngarkim të shtetit nëse gjendja ime ekonomike më lejon të përfitoj nga patronazhi falas, me shpenzimet e Shtetit italian.

9.2 Diskriminimi

319. Kam dëgjuar që ekziston një ligj që të mbron nga diskriminimi. Po çfarë nënkuptohet me saktë në ligj me akt diskriminimi?
Përbën diskriminim çdo sjellje që direkt ose indirekt, sjell një dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë bazuar në razën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinen kombëtare ose etnike, bindjet ose praktikat fetare dhe që ka si qëllim ose efekt të shkatërroje ose të kompromentojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin, në kushte të barabarta të të drejtave njerëzore dhe të lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale e kulturale dhe në çdo sektor tjetër të jetës shoqërore.

320. Si mund të mbrohem përballë akteve diskriminuese të kryera nga një privat ose nga Administrata Publike?
Mund t'i drejtohesh gjykatës civile, nëpërmjet një avokati, duke kërkuar që gjykatësi të urdhërojë ndalimin e sjelljes me paragjykim dhe të adoptojë çdo vendim tjetër të përshtatshëm, sipas rrethanave, për të eleminuar efektet e diskriminimit.

321. Jam viktimë e diskriminimit por kam frikë të denoncoj. Çfarë mund të bëj?
Shoqatat e regjistruara në një regjister të posaçëm pranë Dipartimentit të Shanceve të Barabarta, nën Presidencen e Këshillit të Ministrave, janë të lejuara me ligj të veprojnë me gjygj në emër, për llogari ose në mbështetje të subjektit pasiv të diskriminimit, të bazuar në motive raziale ose etnike.

322. Jam viktimë e diskriminimit në punë. Cfarë mund të bëj?
Organizatat sindakale mund të veprojnë juridikisht për të mbrojtur viktimat e diskriminimit kur punëdhënësi kryen një diskriminim.

10 Banka

323. Cilat janë shërbimet bankare që mund të më shërbejnë?
Zakonisht shërbimet më të kërkuara janë libreza e kursimit, llogaria bankare (e nevojshme në se dëshiron të kesh librezë çeqesh, kartën bancomat, kartën e kredisë), dërgimi i parave, borxhe dhe kredi bankare për blerjen e banesës.

324. Çfarë është libreza e kursimit?
Libreza e kursimit është një mekanizëm i thjeshtë dhe me kosto të ulët i cili i vlen më shumë personave që nuk kryejnë lëvizje të shumta të hollash. Mund të jetë *"nominativo"* dmth në emër të personit fizik apo juridik ose në emër të personit i cili, kur paraqitet në sportel, ka të drejtë të depozitojë apo të tërheq të hollat. Interesat llogariten dhe ngarkohen një herë në vit**.**

325. Duhet të hap një librezë kursimi, si të veproj?
Zgjidh bankën ku dëshiron të hapësh librezën e kursimit, shko duke marrë me vete:
- kodin fiskal;
- lejeqëndrimin.

Disa banka mund të të kërkojnë edhe:
- busta pagën;
- çertifikatën e rezidencës.

326. Çfarë është llogaria bankare?
Ë htë një llogari ku mund të depozitosh paratë e tua, e cila të jep edhe interesa, për paratë e derdhura, të caktuara nga banka. Për të tërhequr paratë duhet të plotësosh një formular pranë sportelit të bankës, mund të lëshosh një çek në emrin tënd *"Me medesimo"* ose të përdorësh Bankomatin. Paratë e çeqeve të tua ose të çeqeve që të kanë lëshuar, mund t`i tërheqësh pranë bankës tënde.
Disa banka kërkojnë të paguash librezën e çeqeve dhe/ose çeqet e lëshuara.

327. Duhet të hap një llogari bankare, si të veproj?
Zgjidh bankën ku dëshiron të hapësh llogarinë bankare, shko duke marrë
- kodin fiskal;
- lejeqëndrimin.

Disa banka mund të të kërkojnë edhe:
- çertifikatën e rezidencës (por nuk është më e detyruar me ligj);
- garancinë e një klienti tjetër, të huaj ose italian, të njohur nga banka;
- deklaratën e të ardhurave;
- derdhjen e një shume të caktuar parash;
- në ndonjë rast, përpara se të hapi llogarinë bankare, banka i kërkon punëdhënësit një deklaratë që klienti është vartës apo bashkëpuntor i tij.

328. Çfarë është Bankomati?
Bankomati është një kartë manjetike që mund t`a kërkosh pasi ke hapur një llogari bankare. Bankomati është karta kombëtare e kredisë dhe mund të përdoret në të gjitha sportelet

automatike bankomat të vendit (në disa raste edhe jashtë Italisë) për të tërhequr të holla (ATM). Mund të paguash me Bancomat edhe në supermerkatot apo dyqanet që ofrojnë këtë shërbim (POS).

329. Çfarë është Karta e kredisë?
Edhe Karta e kredisë është një kartë manjetike që mund t`a kërkosh pasi ke hapur një llogari bankare. Përveç përparësive që të lejon Bankomati, karta ekredisë të lejon të paguash edhe jashtë Italisë (apo të blesh nëpërmjet internetit); pranohet në shumë dyqane, hotele, restorante, shpërndarës benzine, posta, etj. Disa banka kërkojnë garanci të tjera, si për shembull vjetërsinë e raportit të punës dhe derdhjen automatike të rrogës në llogarinë tënde bankare apo derdhjen automatike të një të ardhure tjetër (p.sh. pensionin).

330. Çfarë është dërgimi i të hollave nëpërmjet bankës?
Është sistemi i dërgimit të parave nga njëra bankë në tjetrën. Kostoja e transaksionit është e ndryshme nga njëra bankë në tjetrën.

331. Mund të dërgoj të holla në vendin tim?
Po, ky është njëri prej shërbimeve që mund t`a kërkosh pranë bankës tënde. Shpenzimet e këtij shërbimi ndryshojnë nga njëra bankë në tjetrën.
Ndryshon edhe shuma fikse që kërkon ajo, të cilës, disa banka i shtojnë edhe komisionin: një përqindje e parave që dërgon.

332. Çfarë dokumentash kërkon banka?
Ndryshojnë nga banka në bankë por zakonisht janë:
- lejeqëndrimi;
- kodi fiskal;
- plotësimin i një formulari në të cilin duhet të përcaktosh të dhënat e tua personale, shumën e parave, emrin e personit që do t`i tërheqë dhe vendin.

11 Shoqatat

Liria e shoqërizimit është e mbrojtur me ligj në Itali. Krijimi i grupeve dhe shoqatave është i mundur të bëhet për ato raste që nuk ndalohen nga ligji, dhe në mënyrë të veçantë mundet:
• të krijohet një grupim;
• të merret pjesë në një grupim;
• mos të merret pjesë në një grupim.

11.1. SI TË THEMELOSH NJË SHOQATE

333. Cfarë aktivitetesh mund të zhvillojë një shoqatë?
Çdo lloj aktiviteti që nuk ndalohet nga ligji.

334. A promovohen shoqatat?
Shoqatat promovohen kur favorizojnë integrimin e të huajve në jetën e komunitetit lokal: për këtë është krijuar edhe Rregjistri Kombëtar i Shoqatave në Ministrinë e Punës dhe të Politikave Sociale – Drejtoria e Përgjithshme e Imigracionit.

335. Cilat janë kushtet që duhen plotësuar për regjistrimin në këtë regjistër?
Mund të regjistrohen të gjitha shoqatat që veprojnë në territorin kombëtar: ato që zhvillojnë aktivitet në të paktën 5 rajone dhe 20 provinca italiane.

336. Nga kush përbëhet një shoqatë?
Përbëhet nga një grup personash që mblidhen sëbashku për qëllime sociale, kulturore, mirqënie, kujdesit për mjedisin etj.

Vini re: nuk eksiston një limit personash që mund të formojnë një shoqatë, mund të jenë dhe vetëm dy. Aktivitet e biznesit janë të disiplinuara.

337. Cilët janë elementët e nevojshëm për të krijuar një shoqatë?
Çdo grup vendos rregulla të caktuara për të disiplinuar aktivitetin. Një shoqatë mund të krijohet në formën e saj me shkrim ose gojore. Marrëveshja gojore nuk mund të regjistrohet në Regjistrin e Shoqatave, nuk mund të kryejë aktivitete me pagesë, nuk mund të përfitojë nga fondet publike ose private, nuk mund të rregjistrohet në rregjistrat e Organizatave Vullnetare, etj. Në të kundërt, në rast se Shoqata themelohet mbi bazën e një akti të shkruar, mund të përfitojë nga lehtësime fiskale.

338. Si mund të krijohet një shoqatë në formë të shkruar?
Duhet shkruar nje Kontratë për Grupim. Kontrata ndahet në 2 dokumenta që konsiderohen akti i themelimit dhe Statuti.

339. Çfarë është Statuti?
Është dokumenti që rregullon jetën shoqates, duke përcaktuar arse shoqërore, rregullat për formimin e organeve kolegjiale, zgjedhjen e presidentit, funksionimin e asemblesë së anëtarve, përpilimin e buxhetit.

340. Çfarë eshte akti i themelimit?
Është dokumenti që dëshmon lindje e një shoqate dhe përcakton të "dhënat personale", duke shënuar: adresën, anëtarët themelues, datën e krijimit të saj.
Duhet të firmoset nga anëtarët themelues, që deklarojnë se bashkohen per të ndjekur një qellim të ligjshëm.

341. Çfarë duhet të shkruhet në Statut?
• Emri dhe adresa e shoqatës;
• të shënohet në se ka ose jo qëllime fitimi;
• objekti social (natyrë e ndihmës reciproke apo solidariteti);
• kushtet për pranimin e ortakëve;
• rregullat e sjelljes së ortakëve;
• pasuria dhe të ardhurat;
• organet e shoqatës (keshilli drejtues, asemblea);
• normat e funksionimit të organeve të shoqatës (në veçanti ato të këshillit drejtues dhe asamblesë, modalitetet e thirrjes së mbledhjeve, vendim-marrje;
• kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit dhe raportet financiare të tyre;
• modalitetet e prishjes së shoqatës.

342. Kur bëhet fjalë për akt publik dhe kur për akt privat?
Në se dokumenti bëhet nën mbikqyrjen e një noteri dhe nga ky rregjistrohet në Zyrën e Rregjistrimit, quhet akt publik; në se formulohet nga ortakët quhet akt privat, i cili mund të rregjistrohet nga noteri ose jo.

343. Cila është diferenca midis rregjistrimit publik dhe krijimit privat të shoqatës?
Diferenca qëndron në faktin se vetem nëpërmjet një akti publik mund të kërkohet njohja e shoqatës dhe ajo të kthehet në një person juridik.

344. Çfarë janë shoqatat e njohura?
Ato që kanë një "dekret" njohjeje, i cili është një akt i Shtetit me anë të të së cilit shoqatës i jepet autonomia ekonomike dhe pasurore. Kjo do të thotë që shoqata përgjigjet dhe merr vetë përsipër përgjegjësitë ndaj ligjit e për pasojë kthehet në një person juridik.

345. Çfarë janë shoqatat e pa njohura?
Janë ato që nuk gëzojnë autonomi të pasurisë para ligjit; do të thotë që në se pasuria e shoqatës nuk është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e m arra, diferencën e paguajnë me pasurinë e tyre, ortakët që bëjnë pjesë në shoqatë.

346. Cila është procedura për njohjen e shoqatës?
Të interesuarit duhet të paraqesin në prefekturën e provincës ku ndodhet shoqata, një kërkesë nga themeluesi i saj së bashku me aktin themelues të shoqates. Konsistenca e pasurisë duhet të tregohet nga dokumentat që i bashkëlidhen kërkesës.

347. Sa kohë duhet për të bërë njohjen e një shoqate?
Autoriteti qeveritar ka një kohë të caktuar prej 120 ditësh për të vendosur nëse një shoqatë do të jetë ose jo e shkruar në zyrën e rregjistrit. Kjo kohë mund të shkojë deri në 180 ditë nëse Prefektura kërkon dokumenta të tjerë ose kur mungojnë dokumentat që duhen.

348. Çfarë mund të bëhet në se një shoqatë nuk njihet?
Në se nuk pranohet rregjistrimi i një shoqate atëherë mund të bëhet apel administrativ.

349. Shoqata a mund të ketë një kod fiskal?
Po, lindja e ketij subjekti të ri i duhet komunikur Agjencisë së të ardhurave përgjegjësë për territorin. Zyra do ju lëshojë një kod fiskal.

350. Për cfarë shërben kodi fiskal?
Kodi fiskal shërben për:
• të blerë mallra me faturë;
• të vënë në emër të shoqates pasuri të patundshme;
• të bërë kontrata qeraje;
• të kërkuar kontribute ose shpenzime pranë institucioneve;
• të paguar shpërblime
• për të marrë 5 per 1000

11.2. DISA LLOJE SHOQATASH

351. Cfarë janë shoqatat për promocion social?
Janë shoqata që ndërmarrin aktivitete të vlefshme shoqërore në favor të anëtareve të saj ose të komunitetit.

352. Cilat aktivitete konsiderohen "të vlefshme shoqërisht"?
Bamirësia, promovimi i kulturës, artit, mbrojtja dhe vlerësimi i ambjentit, shkollimi dhe formimi, sporti amator, mbrojtja e të drejtave civile etj. Këto shoqata rregullohen sipas ligjit nr. 383/00.

353. Cfarë janë organizatat vullnetariatit?
Ligji përcakton si aktivitet vullnetariati ato që nuk kanë qellime fitimi por që i shërbejnë solidaritetit. Organizatat e vullnetariatit mund të marrin çfarëdo forme juridike në puthje me qëllimin e tyre shoqëror. Bazohen tek puna vullnetare megjithëse mund të mbajnë edhe ndonjë punonjës me rrogë në se kanë nevojë. Këto organizata rregullohen sipas ligjit nr. 266/91.

354. Cfarë janë Organizatat jo Qeveritare (OJQ)?
Veprojnë në fushën e bashkëpunimit me vendet në zhvillim. OJQ-të, sipas ligjit, mund të marrin çdo lloj forme juridike (shoqatë ose fondacion) porse duhet të kërkojnë njohjen nga ana e Ministrisë së Jashtme për të vepruar në projekte zhvillimi të financuar nga fonde publike.
Këto organizata rregullohen sipas ligjit nr. 49/87.

355. Çfarë do të thotë Organizatë jo fitim prurëse më rëndësi shoqërore (Onlus)?
ONLUS ka një status fiskal të caktuar. Rregjimi Onlus i aplikohet organizatave vullnetare të rregjistruara pranë rregjistrave krahinorë ose kooperativave sociale.

356. Çfarë do të thotë Organizatë NO Profit?
No profit (ose pa fitim) është një organizatë në brendësi të së cilës fitimet nuk mund të ndahen me ortakët por duhet të investohen në aktivitet ose t`u dhurohen atyre që kanë nevojë dhe që janë shënuar ne Statutin e organizatës.

11.3. REGJISTRI I SHOQATAVE DHE ORGANIZATAVE NË SHËRBIM TË EMIGRANTEVE

357. Çfarë është rregjistri i shoqatave dhe enteve që punojnë në favor të imigrantëve?

Rregistri i shoqatave dhe i enteve që punojnë në favor të imigrantëve është i përbërë nga dy seksione. Në seksionin e parë mund të rregjistrohen ato shoqata e ente që merren me aktivitete ne favor të integrimit social të të huajve, ashtu siç parashikohet nga neni nr. 42 i Teksit të Vetëm për imigracion (Dekreti Legjilativ i dt. 25.07.1998 nr. 286).
Në seksionin e dytë mund të rregjistrohen entet dhe shoqatat që merren me asistencën dhe mbrojtjen sociale te viktimave të trafikut (ex neni nr. 18 i Teksit të Vetëm për imigracion - Dekreti Legjilativ i dt. 25.07.1998 nr. 286). Ky rregjistër ju drejtohet organizmave private, shoqatave dhe enteve që plotesojnë kushtet e nenit nr.53 të D.P.R. 31 gushtit të 1999, nr. 394, siç është modifikuar nga D.P.R. 18 tetor 2004, nr. 334. Rregjistrimi mundëson përfitimin e financimit publik, nëse kërkohet si kusht i domosdoshëm.

NËNSHKRIMI NË SEKSIONIN E PARË

358. Kush mund të paraqesë kërkesë për rregjistrim?

Shoqatat, ente tdhe organizata private. Përjashtohen të gjitha organat publike dhe organet të ndërkombëtare.

359. Cilat kërkesa duhen plotësuar?

- qellime socile e solidale
- mungesë qellimesh fitimi
- zyrë legale në Itali
- regullore të brëndëshme demokratike
- drejtuesit duhet të zgjidhen me anë të votimeve
- kritere të qarta për pranimin e anëtarve
- përgatitje të pasqyrës financiare ose të raportit vjetor dhe përcaktimin e procedurave për miratim
- të paktën dy vjet përvojë në fushën e integrimit social të të huajve
- mungesë kushtesh qe skualifikojne përfaqësuesin ligjor dhe të gjithë anëtarët e bordeve të menaxhimit dhe kontrollit.

360. Cili është afati vjetor për dorëzimin e aplikimeve?

Nuk ka asnjë afat. Kërkesa mund të paraqitet në çdo kohë të vitit.

361. Si duhet plotësuar formulari?

Ndiqni udhezimet per plotesimin e formularëve në faqen e internetit të Ministrisë http://www.lavoro.gov.it/AreaSociale/Immigrazione/associazioni/Pages/default.aspx

362. Aplikimi duhet të përfshijë të gjitha të dokument që kërkohen?

Të gjitha dokumentet e kërkuara per aplikimit, janë thelbësore për vlerësimin për tu regjistruar.

363. Duhet përdorur modeli që shkarkohet nga faqja e internetit?

Po, duhet të përdorur ekskluzivisht modeli i përgatitur, e cili nuk duhet ndryshuar, duhen plotësuar, datuar dhe nënshkruar.

364. Duhet dërguar akti kostitutiv i shoqatës ose thjesht statutin aktualisht në fuqi?
Duhen derguar akti konstituiv i plotë me të gjithë dokumentat e kërkuar dhe statuti aktualisht në fuqi sëbashku me dokumentat që e miratojnë.

365. Si duhen provuar dy vite përvojë e nevojshme në fushën e integrimit?
Duhet dëshmuar përvojë specifike dhe të qëndrueshme në dy vitet e fundit në fushën e integrimit social të të huajve. Efekti i veprimtarisë llogaritet 24 muaj përpara datës së dorëzimit të aplikimit.

366. Cilat aktivitete duhet të jenë të ndërlidhura?
Vetëm aktivitetet e kryera në Itali në lidhje me shtetasit e huaj që banojnë ligjërisht në Be. Në rastin aktivitetesh jo-specifike, duhet të theksohen ndërhyrjet drejtuar te huajve.

367. Si duhet shkruar raporti?
Raporti i detajuar, i dokumentuar e me referenca, duhet të përshkruajë aktivitetet e kryera në dy vitet e fundit (që nga muaji i aplikimit) për të nxitur integrimin social të të huajve, duhet evidenciuar çdo iniciativë të realizuar, me datat e fillimit e mabrimit, objektivat, veprimet specifike të zbatuara, rezultatet e arritura, financimet, marrësit, operatorët dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përshkrimin e përvojës së vazhdueshme në fushën specifike të integrimit social të të huajve.

368. Si duhet dokumentuar veprimtaria e qëndrueshme dyvjeçare e përshkruar në raport?
Duke bashkengjitur marrëveshjet ose certifikatat e lëshuara nga organet publike të referencës, kopje të projekteve të përfunduara dhe raporteve periodike dhe/ose përpunimit të fundit të të dhënave, biografitë e ndërmjetësuesve kulturore, publikimet dhe materialet e informacionit, etj. Ky dokumentacion duhet të identifikohet në mënyrë të qartë për të lejuar një lidhje të saktë me projektin përkatës (nëpërmjet një numërimi te dokumentave te bashkengjitur.).

369. Nëse në dy vitet e fundit nuk janë nënshkruar marrveshje, si mund të dëshmohet eskperienca e krijuar?
Eksperienca duhet të demonstrohet me dorëzimin e certifikatave të lëshuara nga organet publike (autoritetet lokale, shkollat, qëndrat e shëndsisë) me të cilat institucioni ka punuar, pa perfituar financime. Certifikatat që nuk janë lëshuar nga organet publike rreth aktivitetit por nuk zëvendësojnë dokumentet e institucionale.

370. Cilat janë kërkesat buxhetore për një vit?
Pasqyrat financiare duhet të mbulojnë dy vitet të fundit të miratuar nga asamblea. Periudha për këtë arsye nuk mund të korrespondojnë me atë që konsiderohet nga raporti për aktivitetet. Duhen bashkangjitur rezolutat për miratim nga asemblea dhe raporte te tjera.

371. Degët mund të përdorin regjistrimin e entit kombëtar?
Regjistrimi i një strukture kombëtare perfshin edhe degët rajonale, sipas statutit të institucionit, i cili, në fund të 30 janarit të çdo viti, duhet të raportojnë për aktivitetet e ndërmarra nga degët rajonale.

372. Kush duhet ta plotesojë deklaratën zëvëndesuese 1?
Çdo anëtar i bordit të administratës dhe të njësivë ekonomike duhet të plotësojë deklaratën e vet (duke përdorur kopjen e duhur). Deklarata duhet të nënshkruhet, datohet dhe të shoqërohet me nga një kopie të leternjoftimit (të vlefshme).

373. Kush duhet ti plotësoje deklaratat zevendesuese 2 e 3?
Përfaqësuesi i vetëm ligjor, duke përdorur kopien e përgatitur, duke e plotesuar me të gjitha të dhënat e kërkuara.

NËNSHKRIMI NË SEKSIONIN E DYTË

374. Çfarë dokumentash duhen presantuar sëbashku me kërkesën per rregjistrim?
Për sa u përket dokumentave që shoqërojnë kërkesën për regjistrim, përfshirë edhe nënshkrimin e partneritetit, është e nevojshme për ti referoheni kopjes së aplikimit në seksionin e dytë ne faqen e internetit të Ministrisë:
http://www.lavoro.gov.it/AreaSociale/Immigrazione/associazioni/Pages/default.aspx

375. A është e nevojshme paraqitja e dokumentit që dëshmon krijimin e një partneriteti me një institucion anëtar?
Po, krijimi i partneritetit me një ent të regjistruar edhe në seksionin e dytë të regjistrit është një kusht i nevojshëm për regjistrim.

376. Ku nodhet lista e përditësuar e anëtarve të rregjistruar në seksionin e dytë të regjistrit me qëllim identifikimin e një enti për një partneritet të mundshme?
Lista duhet ti kërkohet kësaj zyre, edhe me anë të e-mail-it, duke specifikuar Krahinën të cilës i perkitni. Lista nuk është e botuar, sepse, duke qenë një sektor delikat, të dhënat jepen vetëm pas nje kërkese të motivuar dhe ekskluzivisht për përdorim specifik.

377. Si duhet shkruar raporti i partneritetit?
Palët e interesuara mund të tregojnë objektivat, përmbajtjen, metodat dhe kohëzgjatjen që plotësojnë nevojat e tyre operative, në veçanti për sa i përket projektit të propozuar.

Shënim: për të parë dokumentacion shtesë që duhet bashkangjitur, mund ti referoheni FAQ të pjesës së parë.